RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI PËRPUTHSHMËRIE

NË
FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT

Projekti "Zhvillimi i Integruar Urban dhe Turizmi"

Dhjetor 2021

Nr.	Përmbajtja	Faqe
I.	**PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**	3-6
II.	**HYRJA**	**6**
	a. Objektivat dhe qëllimi.....	6
	b. Identifikimi i çështjes.....	7
	c. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.....	7
	d. Përgjegjësitë e audituesve.....	7
	e. Kriteret e vlerësimit.....	7
	f. Standardet e auditimit.....	8
	g. Përmbledhje e punës së kryer.....	8
III.	**PËRSHRIMI I AUDITIMIT.....**	8-9
	Pika A. Marrëveshjet e financimit të projektit me huadhënësit, ndryshimet, shkaqet dhe argumentimi i ndryshimeve.....	9-17
	Pika B. Mbi shkallën e realizimit të objektivave dhe të komponentëve të projektit në krahasim me ato të përcaktuara në marrëveshjet me huadhënësit.....	17-20
	Pika C. Mbi menaxhimin financiar të projektit, shkallën e realizimit të disbursimeve financiare të fondeve kundrejt nivelit të programuar. Raportimi i tyre në Ministrinë e Financave.....	20-29
	Pika D. Mbi zbatimin e kritereve dhe procedurave të përcaktuara sipas rastit në marrëveshje me huadhënësit ose legjislacionin shqiptar, për realizimin e prokurimeve për ndërtime, mallra e shërbime deri në lidhjen e kontratës.....	29-39
	Pika E. Mbi zbatimin e kontratave për punime civile, mallra e shërbime.....	39-53
	Pika F. Mbi administrimin e veprave të përfunduara.....	53-56
IV	**Gjetjet dhe Rekomandimet**	57-62

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

I.a. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.

Është audituar aktiviteti i Projektit ñZhvillimi i Integruar Urban dhe Turizmiò, për periudhën e auditimit referuar fillimit deri me datë 30.04.2020. Auditimi është fokusuar në marrëveshjet e financimit, realizimin e komponentëve dhe objektivave, menaxhimin financiar të projektit, realizimin e procedurave të prokurimit për shërbime dhe punime civile, zbatimin e kontratave të shërbimeve konsulentë dhe atyre të punimeve civile.

I.b. Disa nga gjetjet më kryesore paraqiten më poshtë:

GJETJA NR.	PËRMBLEDHËSE E GJETJES	REFERENCA NË RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
1.	Realizimi i projektit sipas zërave të marrëveshjes paraqitet në nivelet e 11% praktikisht shumë të ulëta krahsimisht me afatin e përfundimit të projektit.Edhe pse në këto kushte nisur nga zvarritjet dhe kalimi i më shumë se ½ e kohës së projektit ecuria e tij është në nivelet e 11% qe sjell dhe dyshimin e arsyeshëm për mos përfundimin në afat, kjo e mbështetur dhe në realizmin e kostove operative që paraqiten në nivelet e 45%.	Pika B (Mbi shkallën e realizimit të objektivave dhe të komponentëve të projektit në krahasim me ato të përcaktuara në marrëveshjet me huadhënësit)	E lartë	*Njesia e menaxhimit të projekti Fondi Shqiptar i zhvillimit të marrin masat për përfundimin sa më shpejt të fazës së projektim me qëllim respektimin e afateve dhe realizimin e procedurave për punë civile në cilësi dhe afat, gjithashtu monitorimin dhe ndjekjen në vijimsë të çdo kontrate në proces që mënjanimin e pengesave dhe zvarritjeve të tjera.*
2.	Disbursimet në nivele të ulta (deri tani në masën 18.3%) e ekspozon huamarrësin në pagimin e tarifave të angazhimit tejet të larta krahsimisht me ato që mund të aplikohen nëse kemi një ecuri normale në disbursimeve.	Pika C (Mbi menaxhimin financiar të projektit, shkallën e realizimit të disbursimeve financiare të fondeve kundrejt nivelit të programuar.	E lartë	*Entit Zbatues i Projektit (FSHZH), të marrë masa të menjëhershme për ecurin në fazat e projektimit dhe zbatimit të projektit në përfundimin e procedurave të prokurimit dhe realizimin e punimeve të ndërtimit me qëllim respektimin e afateve dhe kosatove të miratuara.*

		Raportimi i tyre në Ministrinë e Financave)		
3.	Në auditimin e zbatimit të kontratës së konsulentit *"Projektim dhe supervizim i kontratës së konsulencës Rehabilitimi I qytetit të Gjirokastrës*ò u konstatua se kjo kontratë ka dështuar; por njoftimi për prishje kontrate është kryer pas 8 muajsh dhe prishja e kontratës pas 10 muajsh, duke sjellë vonesa në realizimin e procedures projektim dhe supervizim e më tej dhe zbatimin e projekteve që do miratohen.	Pika D (Mbi zbatimin e kritereve dhe procedurave të përcaktuara sipas rastit në marrëveshje me huadhënësit ose legjislacionin shqiptar, për realizimin e prokurimeve për ndërtime, mallra e shërbime deri në lidhjen e kontratës).	E mesme	*Menaxherii projektit në të ardhmen të informoj për situata të ngjashme huadhënësin për dhënien e një zgjidhje sa më të shpejt në kohë me qëllim eleminimin e vonesave të tjera.*
4.	Nga auditimi i dokumentacionit teknik me objekt ñRikonstruksioni dhe zgjerimi i rrugës ñMuzak Topiaò konstatohet se Leja e Infrastrukturës me nr. 6268, datë 20.12.2019, lëshuar nga Bashkia Berat është lëshuar në mënyrë të pjesshme për shkak të problematikave mbi shpronsimet e pronarëve të ligjshëm të cilët preken nga zbatimi i kontratës. Mos lëshimi i lejes së infratrsukturës, për të gjithë objektin ka diktuar shtyrjen e afatit të punimeve me 12 muaj.	Pika E (Mbi zbatimin e kontratave për punime civile, mallra e shërbime).	E Mesme	*FSHZH në cilësinë e Autoriteti Kontraktor, në bashkëpunim me Bashkinë Berat si përfituese direkte e këtij investimi, të intensifikojnë veprimet për të mundësuar shpronsimin e pronarëve të ligjshëm të cilët u cënohet prona private për shkak të zbatimit të punimeve të kontratës dhe të realizohet dhënia e lejes së infrastrukturës për të gjithë objektin, për të mundësuar përfundimin e punimeve të kontratës në përputhje me kushtet e lejes së infrastrukturës dhe grafikut të punimeve.*

Konkluzioni dhe opinioni i auditimit.
Nga auditimi arrihet në konkluzionin se:

-Ecuria e ketij projekti paraqitet me ritme shume të ngadalta duke vën në rrezik realizimin e projektit në afatin e miratuar. Këto vonesa vijnë si rezultat i mos realizimit të procedurave prokurimit sipas planit fillestare por që pengesë kryesore kanë qenë, lejet përkatëse për ruajtjen e trashëgimisë kulturore pasi 2 qytete kryesore ku zbatohet ky projekt janë pjesë e trashëgimisë kulturore botërore të cilat mbrohen nga UNESCO.
-Gjithashtu vonesa ka dhe në procesin e shpronësimeve për ato pjesë pronash ku kalon projekti siç është rruga ñMuzak Topiaò për në kalan e Beratit edhe pse shkresa me listën e shpronësimeve ka vajtur në Ministrinë e Ekonomisë, nuk është proceduar ende si dhe vonesat në procedurat me Bankën Botërore, miratimet marrjen e NO Objection etj.
Ecja me ritme të ngadalta e ekspozon Huamarrësin në rritjen e kostove të projektit, rritjne e kësteve të tarifës së angazhimit krahasimisht me atë të parashikuar, si dhe mos realizimin dhe arrtijne e objektivave.

Opinion i pakualifikuar mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së**Projektit "Zhvillimi i Integruar Urban dhe Turizmi"** të Fondit Shqiptar të Zhvillimit me kuadrin ligjor dhe rregullator.
Në opinionin tonë, përveç çështjeve të trajtuara në bazën për opinionin e pakualifikuar u evidentuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të cilat nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur nuk janë materiale dhe të përhapura, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e një opinioni të pakualifikuar.

Baza për opinionin e pakualifikuar.
Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit, si dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik ***ISSAI 4100*** *– Objektivi i audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse informacioni i mbledhur sa i takon një çështjeje të veçantë është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, kur auditimi bëhet lidhur me çështje të veçanta* dhe ***ISSAI 4200 -*** *Objektivi i audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse informacioni i mbledhur sa i takon një çështjeje të veçantë është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, kur auditimi behet lidhur me auditimin e pasqyrave financiare.*
Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit. Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se, subjekti i audituar përgjithësisht ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, me përjashtim të disa çështjeve (jo materiale dhe të përhapura).
<u>Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të Njësis së Zbatimit të Projektit:</u>
Strukturat ekzekutive dhe drejtuese të NJZP pran^{y} FSHZH, janë përgjegjëse për përdorimin e fondeve publike (burimeve financiare) në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara (kriteret e vlerësimit), kryesisht dhe veçanërisht ato për zbatimin e gjithë kuadrit ligjor, nënligjor dhe rregullator në prokurimin e fondeve publike.

Strukturat drejtuese të NJZP pran^{y} FSHZH janë përgjegjëse funksionimin e sistemit të prokurimit në përputhje me kriteret përkatëse të një organi qendror blerës.
Gjithashtu, është përgjegjësi e drejtuesve të njësisë publike të përgjigjen dhe të jenë transparentë për veprimtarinë e tyre, si edhe të sigurojnë se i administrojnë këto fonde dhe procedura prokurimi në pajtim me kriteret ligjore, nënligjore e rregullatore.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH mbi Auditimin e Përputhshmërisë:

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme , nëse veprimtaria e subjektit të audituar është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin arritjen e konkluzioneve dhe dhënien e një opinioni të arsyeshëm. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin e tij profesional në punën audituese.
Auditimi ka identifikuar çështjet më të rëndësishme lidhur me zbatueshmërinë e kritereve të vlerësimit, kuadrin ligjor dhe rregullator nga ana e subjektit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.
Audituesit e KLSH kanë respektuar në vijimësi kërkesat Kodit të Etikës të KLSH, në lidhje organike më të gjithë kërkesat e kuadrit ligjor rregullator të veprimtarisë menaxheriale audituese institucionale.
Audituesit e KLSH janë përgjegjës për të siguruar cilësinë e auditimit, duke zbatuar procedurat e kontrollit të cilësisë gjatë gjithë procesit të auditimit, me synim marrjen e sigurisë, se auditimi është në përputhje me standardet e aplikueshme dhe se raporti i auditimit, konkluzionet dhe opinioni i auditimit janë të përshtatshme.
Ky auditim përputhshmërie promovon përgjegjshmërinë ndaj devijimeve të raportimit dhe ndaj shkeljeve të kuadrit ligjor, nënligjor dhe rregullator, në mënyrë që të mund të merren veprime korrigjuese dhe personat përgjegjës të përgjigjen për veprimet e tyre.

I. HYRJA

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 ñPër organizimin dhe funksionimin e KLSHò, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 325/2, datë 30.04.2020, miratuar nga Kryetari i KLSH, ndryshuar me njoftimin për ndryshim në programin e auditimit nr. 325/3 datë 19.06.2020me afat auditiminga data 04.05.2020 deri me datë 30.06.2020, në subjektin Fondi Shqiptar i Zhvillimit në projektin ñZhvillimi i Integruar Urban dhe Turizmiò, për periudhën nga data fillimi i projektit deri me datë 30.04.2020, u krye auditimi ñMbi zbatimin e përputhshmërisëò nga grupi i auditimit me përbërje:

1. S.H, përgjegjës grupi
3. J. Zh, anëtare

Titulli: Projektraport mbi auditimin e përputhshmërisë nëFSHZH,Projekti ñZhvillimi i Integruar Urban dhe Turizmiò.

Marrësi: Fondi Shiptar i Zhvillimit, me Drejtor Ekzekutiv z. D.A, Njësia e Menaxhimit të Projektit.

a. Objektivat dhe qëllimi: Objektivi kryesor i grupit të auditimit të KLSH është dhënia e opinionit për përdorimin ligjor të fondeve dhe rregullshmëria financiare e paraqitjes së dokumentacionit, që Njësia e menaxhimit të Projektit, u ka bërë fondeve në dispozicion, në bazë të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, udhëzuesve të donatorëve, duke audituar rregullshmërinë, ligjshmërinë e transaksioneve si dhe argumentimin e shpenzimeve të kryera në funksion të veprimtarisë së Projektit. Auditimi ka për qëllim ***promovimin etransparencës***dukeofruarraportetëbesueshmepër fondetnësejanë administruar siç kërkohet në aktet ligjore dhe udhëzuesit e donatorëve si dhenëse projekti arrin qëllimin dhe objektivat e përcaktuara në marrëveshjet përkatëse të financimit. Gjithashtu, projekti i auditimit ka për qëllim ***promovimin epërgjegjshmërisë***ndajdevijimeve të raportimitdhe ndaj shkeljeve tëkuadritligjor,në mënyrëqë tëmundtëmerrenveprime korrigjuese dhepersonat përgjegjës të përgjigjen për veprimetetyre.
Auditimi i përputhshmërisë i ndërmarrë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ka për qëllim promovimin e qeverisjessëmirënësektorinpublikdukemarrëparasyshrrezikunemashtrimitnë lidhje mepërputhshmërinë*(sipas ISSAI 400, p 18).*

b. Identifikimi i çështjes: Njësia eMenaxhimit të Projektit duhet të ketë organizimin e duhur, duhet të funksionojnë duke respektuar aktet ligjore e nënligjore në fuqi dhe udhëzuesit e donatorëve, për menaxhimin e projektit me ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet, me synim arritjen e objektivave të projektit, për rritjen e numrit të turistëve në katër Bashkitë Berat, Përmet, Gjirokastër dhe Sarandë ku aplikohet ky projekt dhe rritjen e mirëqenies së banorëve të zonës etj.

c. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjen nën auditim: Njësia e Menaxhimit të Projektit dhe FSHZH, kanë detyrimin të menaxhojnë siç duhet fondet në dispozicion për realizimin e projektit të ndërtimit të rrugës në përputhje me aktet ligjore e nënligjore dhe udhëzuesit e donatorëve.

d. Përgjegjësitë e audituesve: Audituesit janë përgjegjës për shprehjen e konkluzioneve dhe dhënien e opinionit për auditimin. Auditimi është bërë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit INTOSAI. Janë respektuar kërkesat etike, është planifikuar dhe kryer auditimin sipas të cilit është arritur niveli i sigurisë së kërkuar.

e. Kriteret e vlerësimit:

Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI) të INTOSAI-t, Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) IFAC; Kushtetuta dhe Baza Ligjore:

Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 ñPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitò;

Ligji nr. 19/2017 ñPër ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Financimin e ProjektitñZhvillimin e Integruar Urban dhe të Turizmitò.

VKM nr. 116, datë 24.02.1997 ñPër kompetencat, procedurat, nënshkrimin, lëvrimin, regjistrimin, zbatimin, shlyerjen dhe raportimin e huave, kredive dhe ndihmave të huaja që i jepen Qeverisë së Republikës së Shqipërisëò;

VKM nr. 452, datë 01.07.1998 ñPër disa masa në përmirësimin e punës për financimin e projekteve që financohen nga donatorë të huajò;

Udhëzim i Ministrisë së Financave nr. 8, datë 17.02.2003 ñPër evidentimin, regjistrimin, përdorimin dhe raportimin e financimeve të huaja, në kuadrin e projekteve dhe marrëveshjeve me donatorët e huajò;

Udhëzim i Ministrisë së Financave nr. 20, datë 24.12.2003 ñPër përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore të njësive të menaxhimit/zbatimit të projekteve dhe marrëveshjeve me donatorë të huajò;

Udhëzuesit e prokurimit të Huadhënësit për prokurimet e fondeve për mallra, punime dhe shërbime.

Akte të tjera ligjore apo nënligjore që do të jenë të nevojshme gjatë auditimit.

f. Standardet e auditimit:

- ISSAI100–(*Parimetthemeloretëauditimittësektoritpublik)*
- ISSAI400-(*Parimetthemeloretëauditimittëpërputhshmërisë).*
- ISSAI 4000 *(Standarded e auditimit të Perputhshmërisë.*
- Kodi etik i KLSH.

g. Përmbledhje e punës së kryer.

Auditimi është zbatuar sipas drejtimeve në programin përkatës. Janë konstatuar mangësi të cilat në mënyrë të përmbledhur paraqiten si më poshtë:

-Dëmet ekonomike të konstatuara janë në vlerën 383,656 lekëtë cilat kanë ardhur si rezultat i diferencave në volumet e punimeve për kontratat e punimeve civile.

11 masa organizative për përmirësimin e situatës deri në këtë fazë që është projekti i cili paraqitet në ecuri shumë të ngadaltë vetëm 11.3% i zbatuar në një kohë që kanë kaluar 3 vite nga 5 vjet që është Afati i këtij projekti.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

Projekti ñZhvillimi i Integruar Urban dhe Turizmiò, është një financim i Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim nëpërmjet kredisë **LOAN NUMBER 8656-AL,** nënshkruar më 13

Dhjetor 2016 miratuar me Ligjin Nr.19/2017 ñPër Ratifikimin e Marrëveshjes së Huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për Financimin e Projektit për Zhvillimin e Integruar Urban dhe të Turizmitò në shumën prej gjashtëdhjetë e tre milion e tetë qind mijë euro (63,800,000 euro)

Në kuadër të Zbatimit të Ligjit nr.19/2017 ñPër Ratifikimin e Marrëveshjes së Huasë Ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për Financimin e Projektit për Zhvillimin e Integruar Urban dhe të Turizmitò, referuar nenit 2 të kësaj marrëveshje, Banka bie dakord që t'i japë Huamarrësit, me kushtet dhe afatet që parashikohen apo përmenden në këtë Marrëveshje, (Huaja), për të dhënë asistencë në financimin e projektit, me objektivat e mëposhtme.
Objektivat e Projektit janë: (a) përmirësimi i infrastrukturës urbane; (b) shtimi i aseteve për turizmin; dhe (c) fuqizimi i kapaciteteve institucionale për të mbështetur turizmin në lidhje me zhvillimin ekonomik vendas të zonave të përzgjedhura në jug të Shqipërisë.

Ai shtrihet në qendrat urbane të Sarandës,Gjirokastrës, Beratit, Përmetit dhe përgjatë korridorit turistik që kalon në këtë rajon. Nga ky projekt parashikohet të përfitojnë 84 mijë banorë dhe rreth 300 mijë turistë.

Deri në këtë periudhë marrëveshja nuk ka pasur amendime apo ndryshime të afatit, por për çdo investim të kryer në kuadër të projektit janë lidhur ñMarrëveshjeve të Investimitñ, të nënshkruara me Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore duke i bashkëlidhur Marrëveshjen e Investimit.

Objekti, qëllimi dhe fushëveprimi i auditimit është rregullshmëria e operacioneve financiare të të zbatimit të projektit për periudhën nga fillimi i projektit deri më datë 30.04.2020.

Qëllimi i auditimit është hartimi i Projektraportit të auditimit mbi bazën e vlerësimit të gjetjeve, si dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësimin e aktivitetit të projektit.

Është audituar aktiviteti i zbatimit të projektit për periudhën e auditimit, fokusuar kryesisht në realizimin e procedurave të prokurimit nga 14 procedura të realizuara nga të cilat 6 prej tyre punime civile dhe 8 konsulencë janë audituar6 procedura nga të cilat 4 punime civile dhe 2 konsulece ose në në vlerë 65% të procedurave të realizuara, në zbatimin e kontratave të punimeve civile janë audituar të 5-ta kontrata nga të cilat 4 të përfunduara dhe 1 vetëm situacionit i parë kontrata tjetër sa[po ka filluar. Janë audituar shpenzime të realizuara nga Njësia e Menaxhimit të projektit. Në zbatimin e kontratave është audituar vendimmarrja e FSHZH në lidhje me ndryshimet në projekt dhe kontratat përkatëse, amendimet e kontratave si për ato të shërbimeve konsulentë, ashtu edhe për ato të zbatimit të punimeve civile. Është audituar me zgjedhje dokumentacioni i shpenzimeve kontraktore për zbatimin e shërbimeve të mbikëqyrjes së punimeve, certifikatat e pagesave, kryesisht ato progresive, janë verifikuar punimet e zbatuara në objekt sipas kontratave përkatëse. Është audituar dokumentacioni i afateve kohore të parashikuara dhe të realizuara në zbatimin e kontratave, pretendimet e ndërsjella si të Njësive të Menaxhimit të Projektit, ashtu edhe të kontraktorëve, etj.

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

IV. A.Marrëveshjet e financimit të projektit me huadhënësit, ndryshimet, shkaqet dhe argumentimi i ndryshimeve.

1.Titulli i Gjetjes: Mungesë raportimi periodik i Njësisë së Zbatimit të Projektit në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjetikës dhe mbledhje e Komitetit Drejtues të Projektit, jo në përputhje me përcaktimet e marrëveshjes.
Situata: Nga auditimi konstatohet se referuar zbatimit të marrëveshjes Ligji nr.19/2017 ñPër Ratifikimin e Marrëveshjes së Huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për Financimin e Projektit për Zhvillimin e Integruar Urban dhe të Turizmitò konstatohet se Komiteti Drejtues i Projektit është mbledhur vetëm dy herë jo në përputhje me përcaktimet e marrëveshjes në të cilën citohet se : ñKomiteti Drejtues i Projektit: (i) të mblidhet të paktën çdo gjashtë (6) muaj; (ii) të mbështesë Ministrinë e Zhvillimit Urban për të mbikëqyrur në mënyrë tërësore menaxhimin e Projektit, përfshirë, mes të tjerash, duke mbështetur bashkërendimin e palëve të interesuara dhe duke zgjidhur çështje ose probleme të rëndësishme ndërrajonale apo bllokimet që shkaktohen gjatë zbatimit të Projektitò, ndërsa referuar mbledhjes së parë të Komitetit Drejtues i Projektit, Enti Zbatues i Projektit (FSHZH), nuk ka qenë prezent në këtë mbledhje për të referuar problematikat mbi pengesat në implementimin e këtij projekti, në kundërshtim me përcaktimet në marrëveshjen ñLigji Nr.19/2017 ñPër Ratifikimin e Marrëveshjes së Huasë Ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për Financimin e Projektit për Zhvillimin e Integruar Urban dhe të Turizmitò,po ashtu nuk konstatohen raportime nga Enti Zbatues i Projektit (FSHZH), pranë Ministrisë së Infrastrukurës dhe Energjisë brenda datës 10 të çdo muaji, të informacionit të detajuar në lidhje me ecurinë e aktiviteteve të projektit siç ishtekërkuar në mbledhjen e parë të KDP, zhvilluar në qershor të vitit 2018, përsa më sipër këto veprime ngarkojnë me përgjegjësi Entin Zbatues të Projektit (FSHZH).
Kriteri: Ligji nr.19/2017 ñPër Ratifikimin e Marrëveshjes së Huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për Financimin e Projektit për Zhvillimin e Integruar Urban dhe të Turizmitò
Ndikimi/Efekti: Risku i efekteve në lidhje me zgjatjen e afateve të zbatimit të projektit të miratuara në marrëveshjet e financimit, shoqëruar potencialisht edhe me kosto ekonomike në varësi të zgjatjes së afateve të përfundimit të projektit.
Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Njësia e Menaxhimit të Projektit të marrë masa për përmbushjen e detyrimeve dhe respektimin e përcaktimeve të parashikuara në marrëveshje për sa i përket raportimeve kjo në frymën e mirmenaxhimit dhe mbarëvajtjes së projektit.

2.Titulli i Gjetjes: Mungesë auditimi i projektit nga Entit Zbatues i Projektit (FSHZH)
Situata: Nga auditimi u konstatua se referuar seksionit 2, pika B ñAdministrimitfinanciar, raportet financiare dhe auditimetò të marrëveshjes, projekti është audituar nga kompania

audituese ñG. Th.ò për pasqyrat financiare pas çdo viti ushtrimor financiar, por nga ana e Entit Zbatues i Projektit (FSHZH) ky projekt nuk është audituar duke e lënë titullarin e Institucionit dhe Ministrinë e linjës, pa informacion në lidhje me ecurinë e këtij projekti, zhvillimin e procedurave dhe zbatimin në terren, i cili ka rëndësi të veçantë për turizmin në zonat ku aplikohet. Këto veprime janë nëkundërshtim me seksionin II, pika BñAdministrimit financiar, raportet financiare dhe auditimetò, pika 2, të marrëveshjes ku përcaktohet se ñHuamarrësi, nëpërmjet Ministrisë së Zhvillimit Urban, nxit Entin Zbatues të Projektit që të përgatisë, dhe t'i dorëzojë Bankës jo më vonë se 45 ditë pas mbarimit të çdo tremujori kalendarik, raporte të ndërmjetme financiare të paaudituara për Projektin që përmbledhin tremujorin, në formë dhe me përmbajtje të pranueshme për Bankënò. **Kriteri:**Ligji nr.19/2017 ñPër Ratifikimin e Marrëveshjes së Huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për Financimin e Projektit për Zhvillimin e Integruar Urban dhe të Turizmitò **Ndikimi/Efekti**: Nga ana e Entit Zbatues i Projektit (FSHZH) ky projekt nuk është audituar duke e lënë titullarin e Institucionit dhe Ministrinë e linjës, pa informacion në lidhje me ecurinë e këtij projekti i cili ka rëndësi të veçantë për turizmin në zonat ku aplikohet, në kundërshtim me seksionin 2, pika B ñAdministrimitfinanciar, raportet financiare dhe auditimetò të marrëveshjes së huasë. **Rëndësia:** E lartë. **Rekomandimi:** Entit Zbatues i Projektit (FSHZH), të marrë masa që të përgatisë, dhe t'i dorëzojëBankës jo më vonë se 45 ditë pas mbarimit të çdo tremujori kalendarik, raporte të ndërmjetme financiare të paaudituara për Projektin që përmbledhin tremujorin, në formë dhe me përmbajtje të pranueshme për Bankënò,për ecurinë e ktij projekti i cili ka rëndësi të veçantë për turizmin në zonat ku aplikohet.

Më hollësisht rezultatet e auditimit paraqiten si më poshtë:

Në kuadër të Zbatimit të Ligjit nr.19/2017 ñPër Ratifikimin e Marrëveshjes së Huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për Financimin e Projektit për Zhvillimin e Integruar Urban dhe të Turizmitò, referuar nenit 2 të kësaj marrëveshje, Banka bie dakord që t'i japë Huamarrësit, me kushtet dhe afatet që parashikohen apo përmenden në këtë Marrëveshje, shumën prej gjashtëdhjetë e tre milion e tetë qind mijë euro (63,800,000 euro) (Huaja), për të dhënë asistencë në financimin e projektit, një përshkrim i të cilit jepet në shtojcën 1 Marrëveshjes (Projekti).Ai shtrihet në qendrat urbane të Sarandës,Gjirokastrës, Beratit, Përmetit dhe përgjatë korridorit turistik që kalon në këtë rajon. Nga ky projekt parashikohet të përfitojnë 84 mijë banorë dhe rreth 300 mijë turistë.
Marrëveshja e ndarë sipas kategorive dhe shumave të alokuara dhe përqindjes së shpenzimeve që do të financojë paraqitet si më poshtë :

Nr.	Kategoria	Shuma e marrëveshjes së alokuar e shprehur në Euro	Përqindja e shpenzimeve që do të financojë (bashkë me taksat)

1	Punët	49,816,500	100%
2	Mallra	2,530,000	100%
3	Shërbime Konsulence	8,710,000	100%
4	Kosto operative	2,530,000	100%
5	Trajnime	54,000	100%
6	Tarifa e përparme	159,500	Shuma e pagueshme në përputhje me nenin 2.03 të kësaj Marrëveshjeje në përputhje me Seksionin 2.07 (b) të Kushteve të Përgjithshme
7	**Totali**	**63,800,000**	

Dokumenti i Vlerësimit të Projektit (PAD), është bërë efektiv nga Banka Botërore në datën 15 Shtator 2016, ndërkohë marrëveshja e huamarrjes midis Bankës Botërore dhe Republikës së Shqipërisë me kodin **LOAN NUMBER 8656-AL,** u nënshkrua në 13 Dhjetor 2016, ndërsa manuali operacional i projektit është bërë efektiv nga FSHZH më 24 Prill 2017. Marrëveshja Ligji Nr.19/2017 ñPër Ratifikimin e Marrëveshjes së Huasë Ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për Financimin e Projektit për Zhvillimin e Integruar Urban dhe të Turizmitò,është miratuar në parlament në datën 23.2.2017.
Projekti është bërë zyrtarisht efektiv në fund të prillit 2017 dhe ka një kohëzgjatje 5 vjeçare deri në Korrik të vitit 2022.
Raportimi i të dhënave të disbursimeve dhe shpenzimeve për projektin është dërguar në Ministrinë e Financave, Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit periodikisht për çdo vit dhe konkretisht për vitin 2018 me shkresën nr.28, date 10.01.2018, për vitin 2019 me shkresën nr.43, date 11.01.2019, për vitin 2020 me shkresat nr.69, date 13.01.2020 dhe nr.69/4, datë 05.05.2020.

PIUTD- "Projektipër Zhvillimin e Integruar Urban dhe Turizmin(BB)"					
				Numri i krediseë **8656-AL**	
Disbursimet 2017- Maj 2020					
					(Euro)
Vitet	**2017**	**2018**	**2019**	**Maj 2020**	**Total**
Disbursuar	1,500,000	2,418,102	7,080,416	716,857	11,715,375

Nga fillimi i projektit deri aktualisht, marrëveshja nuk ka pasur amendime apo ndryshime të afatit, por për çdo investim të kryer në kuadër të projektit janë lidhur marrëveshje kuadër dhe marrëveshje investimi në raport me kontratat e punëve civile sipas zërave të investimeve që janë pjesë integrale e projektit. FSHZH ka lidhur ñMarrëveshjeve të Investimit ñ, të nënshkruara me Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore të projekteve dhe nënprojekteve të cilat janë përfunduar ose janë në proces zbatimi/realizimi, duke i bashkëlidhur Marrëveshjen e Investimit sipas tabelës së mëposhtme :

Nr	Njësia Administrative	Projekti	Tipi i Marrëveshjes
1	Përmet	Ndriçimi i zonës së hyrjes së qytetit (Fastrack)	Marrëveshje Funksionim & Mirëmbajtje, datë 25.06.2018
2	Përmet	Ndricimi i zonës së hyrjes së qytetit	Marrëveshje Investimi 25.06.2018

		(Fastrack)	
3	Përmet	Marrëveshje Kuadër PZHIUT	Marrëveshje Kuadër 12.06.2017
4	Sarandë	Shëtitorja Naim Frashëri	Marrëveshje Funksionim & Mirëmbajtje, datë 29.03.2019
5	Sarandë	Rehabilitimi i Shkallareve të Sarandës	Marrëveshje Investimi 16.08.2017
6	Sarandë	Marrëveshje Kuadër PZHIUT	Marrëveshje Kuadër 12.06.2017
7	Gjirokastër	Rehabilitimi i infrastrukturës dhe Restaurimi i Kalldrëmeve në Pazarin e Gjirokastrës	Marrëveshje Funksionim & Mirëmbajtje 12.11.2018
8	Gjirokastër	Marrëveshje Kuadër PZHIUT	Marrëveshje Kuadër 23.06.2017
9	Berat	Rehabilitimi i rrugës hyrëse Mihal Komeno në Kala	Marrëveshje Investimi, date 10.07.2017
10	Berat	Marrëveshje Kuadër PZHIUT	Marrëveshje Kuadër 16.06.2017
11	Berat	Marreveshje e FSHZH me Bashkine Berat	Marreveshje per zbatimin e projektit date 05.06.2017
12	Berat	Marreveshje investimi me Bashkine Berat per rikonstruksionin dhe zgjerimin e rruges Muzak Topiae rrethrrotullimit deri tek kisha e Shen Ilias	Marreveshje Investimi date 27.04.2018

Referuar shtojcës 2, seksioni I, pika B ñKomiteti Drejtues i Projektitò të marrëveshjes përcaktohet se Huamarrësi:
a) jo më vonë se dy muaj pas datës së hyrjes në Fuqi, krijon dhe, në vijim mban, gjatë gjithë kohës së zbatimit të Projektit, një Komitet Drejtues të Projektit (KDP) që ka në përbërje përfaqësues nga Ministria e Zhvillimit Urban, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Ministria e Kulturës, Ministria e Mjedisit, Ministria e Financave, Departamenti i Programimit të Zhvillimit, Financimeve dhe Ndihmës së Huaj, Enti Zbatues i Projektit dhe Bashkitë e Përzgjedhura; dhe,
b) siguron që KDP-ja: (i) të mblidhet të paktën çdo gjashtë (6) muaj; (ii) të mbështesë Ministrinë e Zhvillimit Urban për të mbikëqyrur në mënyrë tërësore menaxhimin e Projektit, përfshirë, mes të tjerash, duke mbështetur bashkërendimin e palëve të interesuara dhe duke zgjidhur çështje ose probleme të rëndësishme ndërrajonale apo bllokimet që shkaktohen gjatë zbatimit të Projektit.
Nga auditimi dhe nga dokumentacioni i vënë në dispozicion grupit të auditimit u konstatua se:
Komiteti Drejtues të Projektit është mbledhur vetëm dy herë dhe konkretisht si më poshtë :
-*Ditën e hënë më datë 11 Qershor 2018,* në ambientet e Kryeministrisë është zhvilluar Takimi i Parë i Komitetit Drejtues të PIUTD-së. Takimi u drejtua nga Zëvendës Kryeministrja në rolin e Kryetares së këtij Komiteti, dhe në të morën pjesë përfaqësues nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Instituti i Monumenteve të Kulturës/Ministria e Kulturës, Bashkia Sarandë dhe Berat, si dhe Njësia e Koordinimit të Projektit (PCU).*Nuk morën pjesë në takim përfaqësuesit nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit (FSHZH), i cili është edhe Enti Zbatues i Projektit, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe nga Bashkia Gjirokastër dhe Përmet.*
-*Ditën e mërkurë më datë 11 Shtator 2019,* në ambientet e Kryeministrisë u zhvillua Takimi i Dytë i Komitetit Drejtues të projektit ñPIUTDò. Takimi u drejtua nga ZëvendësKryeministri në

rolin e Kryetarit të këtij Komiteti, dhe në të morën pjesë përfaqësues nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm), Ministria e Financës dhe Ekonomisë (përfaqësuar nga Përgjegjësja e Sektorit për Ndihmën e Huaj), Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (përfaqësuar nga ZëvendësMinistri dhe njëkohësisht Zyrtar i Autorizuar i Projektit PIUTD), Ministria e Kulturës (përfaqësuar nga Ministri), Bashkia Sarandë (përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë), Bashkia Berat (përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë), Bashkia Përmet (përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë), Bashkia Gjirokastër (përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë), Banka Botërore (përfaqësuar nga Specialiste e Lartë e Menaxhimit të Burimeve Natyrore), Njësia e Koordinimit të Projektit (PCU) si dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit (FSHZH ï përfaqësuar nga Drejtori Ekzekutiv), në cilësinë e Anëtarit të Komitetit dheEntit Zbatues të Projektit.

<u>Përsa më sipër problematikat që kanë rezultuar në mbledhjen e Komitetit Drejtues të Projektit për vitin 2018 kanë qenë:</u>

- përcjellja e informacioneve të nevojshme nga Bashkitë që përfitojnë nga financimi i PIUTD-së, të cilave pavarësisht se i është dërguar një kërkesë lidhur me identifikimin e nevojave që konsiderohen prej tyre si më të rëndësishme për mbarëvajtjen e punës, kryesisht për nënkomponentin 3A, ende nuk kanë dërguar asnjë përgjigje, megjithëse afati i përcaktuar në kërkesë ishte data 15 Maj 2018. Ndërkohë që për të vazhduar më tej me termat e referencës dhe procedurat e prokurimit në kuadër të Projektit PIUTD, është kërkuar dërgimi sa më shpejt i informacionit nga bashkitë.

-Përsëritja e kërkesës zyrtare, drejtuar FSHZH-së, ku është kërkuar sërish, dërgimi pranë Ministrisë së Infrastrukurës dhe Energjisë brenda datës 10 të çdo muaji i informacionit të detajuar në lidhje me ecurinë e aktiviteteve të projektit.

<u>Ndërsa problematikat dhe ndërhyrjet që kanë rezultuar në mbledhjen e Komitetit Drejtues të Projektit për vitin 2019 referuar realizimit të projektit kanë qenë:</u>

Nga Komiteti Drejtues së Projektit i është kërkuarKryetarëve të Bashkive që të kuptojnë rëndësinë dhe impaktin e këtij projekti për zhvillimin e këtyre bashkive, dhe ka kërkuar që ata të jenë pjesëmarrës gjatë gjithë harkut kohor të implementimit, jo vetëm si anëtarë bordi, por edhe si përfituesit e Produktit të Projektit PIUTD.

Pas prezantimit referuar faktit se pothuajse të gjithë Anëtarët e Komitetit Drejtues të Projektit janë mbledhur për herë të parë, në prezantimin e koordinatorit të projektit u bë një përshkrim të detajuar të përmbajtjes së projektit duke i informuar të pranishmit mbi:

Å Hapat kryesore nëpër të cilat ka kaluar dhe do kalojë në vazhdim Projekti PIUTD

Å Dokumentet udhëzuese për implementimin e PIUTD (POM dhe PAD)

Å Njësitë Institucionale dhe Zbatuese të Projektit dhe roli i tyre (organigrama e Komitetit Drejtues si dhe implementimi i tij)

Å Katër komponentët përbërës të Projektit duke shpjeguar në detaj projektet që kanë përfunduar për secilin komponent, projektet aktive dhe ato që po planifikohen për implementim gjatë dy viteve të ardhshëm. (sipas prezantimit bashkëlidhur me MoM) dhe dolën konkluzionet dhe problematikat si më poshtë:

1. Problematika e Syrit të Kaltër

- të vihen në dispozicion dosjet e plota të vendimit, së bashku me vendimin e Gjykatës për të dy çështjet e hapura.

- pavarësisht qëndrimit apo jo të këtij projekti në listën e financimeve të projektit PIUTD, është e nevojshme që ti kthehet përgjigje zyrtare BB mbi qëndrimin që Qeveria do të mbajë mbi kompensimin e personave të prekur.

2. Qyteti antik i Orikut

- Nevojitet të gjendet një projekt-propozim potencial për të zëvendësuar këtë fishë në listën e investimeve.
- Nëse duhet hapur diskutimi sërish mbi përfshirjen e Orikut, nevojitet marrëveshja midis Ministrisë së Kulturës dhe Ministrisë së Brendshme e spostimit të postobllokut të bazës ushtarake të Pashalimanit, që do të mundësojë përfundimisht hyrjen lirshëm të vizitorëve në Parkun Arkeologjik të Orikut dhe vazhdimin e financimit nga projekti PIUTD

3. Porto Palermo

- Nevojitet të dërgohet një shkresë zyrtare nga FSHZH drejtuar BB lidhur me qëndrimin apo jo të Porto Palermos në listën e investimeve të projektit PIUTD.Në rast të heqjes nga lista e investimeve, duhet bërë një propozim me site potenciale turistike që përmbushin 6 kriteret e përzgjedhjes.

4. Financime Shtesë (Additional Financing)

- Është e nevojshme që Ministria e Financave (me asistencën e FSHZHôsë) të dërgojë një kërkesë zyrtare tek Banka Botërore, qoftë edhe pa vlerat përfundimtare të investimeve në mënyrë që Bordi i BB të fillojë procedurën e marrjes në shqyrtim.

5. Shpronësimet për projektin e rrugës ñMuzak Topiaò

- Nevojitet gjetja e zgjidhjes në mënyrë emergjente për shpronësimet dhe marrjen e një vendimi brenda këtij muaji, referuar faktit që ky projekt do shërbejë si shembull edhe për projektet në vijim.

6. Restaurimi dhe ripërdorimi me anë të adaptimit funksional të ish-Selamllëkut të Vrionasve dhe zonës rrotull, duke përfshirë qendrën Mesjetare. ñParashikohet prishja e shkollës 9-vjeçare Llambi Goxhomaniò

- FSHZH të bëjë një shkresë për Bankën Botërore, duke konfirmuar dakordësinë midis palëve të interesit (MK, MA, Bashkia Berat etj.)dhe vazhdimin e projektit të propozuar nga konsulenti.

7. Komponenti 3A- vijimi me hartimin e Termave të References për konsulentët që do të angazhohen me ketë komponent nga ana e FSHZH-së.

- Nevojitet që FSHZH të dërgojë tek BB një shkresë/email e cila sqaron rikonceptimin e këtij komponentit sipas vizionit të FSHZH.
- Në rast se ky komponent do qëndrojë siç ka qenë parashikuar, duhet që FSHZH së bashku me PCU-në të hartojnë termat e referencës për marrjen e ekspertëve që do vijojnë me këto konsulenca (Asset Management, GIS, Financial Management etc.).

8. Rritja e kapaciteteve brenda Bashkive.

- Nevojitet krijimi i zyrave/personave të koordinimit (preferohen ekspertë të trajnuar në fushën e turizmit) nga 4 Bashkitë (Gjirokastër, Sarandë, Përmet, Berat) të cilët të koordinojnë dhe asistojnë projektin gjatë implementimit të tij por edhe të vijojnë me menaxhimin e destinacioneve dhe produkteve më pas.

- Nga ana e grupit të auditimit u konstatua se referuar shtojcës 2, seksioni I, pika B ñKomiteti Drejtues i Projektitò të marrëveshjes, bërjes efektive të projektit në fund të vitit 2017 me afat përfundimi në Korrik 2022 dhe shkallës së implementimit të tij deri në fund të muajit Maj 2020

me **8 %** , konstatohet se Komiteti Drejtues i Projektit është mbledhur vetëm dy herë jo në përputhje me përcaktimet e marrëveshjes në të cilën citohet se : ñKomiteti Drejtues i Projektit: (i) të mblidhet të paktën çdo gjashtë (6) muaj; (ii) të mbështesë Ministrinë e Zhvillimit Urban për të mbikëqyrur në mënyrë tërësore menaxhimin e Projektit, përfshirë, mes të tjerash, duke mbështetur bashkërendimin e palëve të interesuara dhe duke zgjidhur çështje ose probleme të rëndësishme ndërrajonale apo bllokimet që shkaktohen gjatë zbatimit të Projektitò, ndërsa referuar mbledhjes së parë të Komitetit Drejtues i Projektit, Enti Zbatues i Projektit (FSHZH), nuk ka qenë prezent në këtë mbledhje për të referuar problematikat mbi pengesat në implementimin e këtij projekti, në kundërshtim me përcaktimet në marrëveshjen ñLigji Nr.19/2017 ñPër Ratifikimin e Marrëveshjes së Huasë Ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për Financimin e Projektit për Zhvillimin e Integruar Urban dhe të Turizmitò,po ashtu nuk konstatohen raportime nga Enti Zbatues i Projektit (FSHZH), pranë Ministrisë së Infrastrukurës dhe Energjisë brenda datës 10 të çdo muaji, të informacionit të detajuar në lidhje me ecurinë e aktiviteteve të projektit siç ishtekërkuar në mbledhjen e parë të KDP, zhvilluar në qershor të vitit 2018, përsa më sipër këto veprime ngarkojnë me përgjegjësi Entin Zbatues të Projektit (FSHZH).
-Nga ana e grupit të auditimit u konstatua se referuar seksionit 2, pika B ñAdministrimit financiar, raportet financiare dhe auditimetò, projekti është audituar nga kompania audituese ñG. Th.ò për pasqyrat financiare pas çdo viti ushtrimor financiar, por nga ana e Entit Zbatues i Projektit (FSHZH) ky projekt nuk është audituar duke e lënë titullarin e Institucionit dhe Ministrinë e linjës, pa informacion në lidhje me ecurinë e ktij projekti i cili ka rëndësi të veçantë për turizmin në zonat ku aplikohet. Këto veprime janë nëkundërshtim me seksionin II, pika B ñAdministrimit financiar, raportet financiare dhe auditimetò, pika 2, të marrëveshjes ku përcaktohet se ñHuamarrësi, nëpërmjet Ministrisë së Zhvillimit Urban, nxit Entin Zbatues të Projektit që të përgatisë, dhe t'i dorëzojë Bankës jo më vonë se 45 ditë pas mbarimit të çdo tremujori kalendarik, raporte të ndërmjetme financiare të paauduituara për Projektin që përmbledhin tremujorin, në formë dhe me përmbajtje të pranueshme për Bankënò.Veprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi Drejtoreshën e Auditit të Brendshëm znj.S.K.

-Njësia e menaxhimit të projektit
Në zbatim të ñLigji Nr.19/2017 ñPër Ratifikimin e Marrëveshjes së Huasë Ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për Financimin e Projektit për Zhvillimin e Integruar Urban dhe të Turizmitò shtojca 2 pika 2 shprehet se: Enti zbatues i projektit në këtë rast FSHZH të ñGjatë gjithë kohës së zbatimit të zbatimit të projektit të mbajë stafin e tij kryesorë që ka në përbërje një menaxher projekti, një arkitekt, një inxhinier, një specialist për administrimin financiar, një specialist prokurimi, një specialist për angazhimin qytetarë, një specialist mjedisi dhe një specialist për problemet sociale, të gjithë këtome kualifikime, përvojë, përgjegjësi dhe iniciativë të pranueshme për bankënò pra një strukturë me 11 vetë kjo e konfirmuar dhe në organigramën e menxhimit të projektit, ku njësia e menaxhimit të projektit menaxhon punën duke e koordinuar atë me Entin zbatues FSHZH dhe PCU njësinë kordinuese të projektit.
Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion dhe nga auditimi në terren njësia e menazhimit të projektit nuk operon në bazë të marrëveshjes së miratuar por koordinohet puna me stafin e FSHZH sipas zonave ku implementohet projekti, pra de fakto njësia e menaxhimit të projektit

nuk është krijuar me një staf prej 11 vetash siç parashikohet por duke bashkëpunuar me stafin e FSHZH, por që në vetvete pavarësisht disponibilitetit për këtë projekt janë të angazhuar dhe në projekte të tjera në varësi të institucionit.

3. Titulli i Gjetjes: Mos ngritja e njësisë së projektit sipas parashikimeve të marrëveshjes

Situata: Nga auditimi u konstatua se referuar shojca 2 pika 2 shprehet Enti i zbatimit të projektit duhet të krijoj njësinë e menaxhimit të projektit me 11 punonjës sipas specifikave të miratuara në marrëveshje dhe në organigramat përkatëse të konfirmuara dhe nga Ministria e Infrastrukturës dhe energjisë, Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe Banka Botërore, si më poshtë; menaxher projekti , një arkitekt, një inxhinier, një specialist për administrimin financiar, një specialist prokurimi, një specialist për angazhimin qytetarë, një specialist mjedisi dhe një specialist për problemet sociale. Edhe pse e parashikuar në marrëveshje dhe konfirmuar dhe në skemat apo organigramat e konfirmuara nga palët e interesit kjo strukturë nuk operon e plotë duke sjllë një mos efiçincë në organizimin e punës dhe vonesa në organizimin, zhvillimin dhe realizimin e procedurave dhe projekteve.

Kriteri:ñLigjin nr.19/2017 ñPër Ratifikimin e Marrëveshjes së Huasë Ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për Financimin e Projektit për Zhvillimin e Integruar Urban dhe të Turizmitò shojca 2 pika 2, si dhe organigramat e funksionimit të projektit.

Ndikimi/Efekti: Nga ana e Entit Zbatues i Projektit (FSHZH) njësia e menaxhimit të projektit nuk është e plotë duke ulur mundësinë e mirë menaxhimit të tij pasi struktura menaxherin e projektit nuk e ka në funksionin e plotë drejtues pasi stafi që ai menaxhon varet nga eprorët e tyre direkt dhe jo nga menaxheri i projektit, duke sjellë dhe zvarritje të punës.

Rëndësia: E mesme.

Rekomandimi: Entit Zbatues i Projektit (FSHZH), të marrë masa në krijimin e strukturës së plotë të njësisë së projektit, me qëllim implementimin në kohë dhe cilësi të këtij projektit si dhe për realizimin e objektivave dhe mos shtyrjen e afatit për arritjen e efiçencës së parashikuar.

Në përgjigje të observacionit të datës 19.08.2020 protokolluar në KLSH me nr. 325/7 datë 20.08.2020, për projektraportin e auditimit, në lidhje me marrëveshjen e financimit të projektit me huadhënësin, ndryshimet, shkaqet dhe argumentimi i ndryshimeveju sqarojmë si më poshtë vijon :

-Grupi i auditimit e ka të qartë faktin se roli i FSHZH si agjenci zbatuese e projektit ,është të sigurojë që planifikimi , zbatimi dhe monitorimi i aktiviteteve të investimeve të projektit të bëhen në përputhje me marrëveshjen e huasë , nisur nga kjo FSHZH nuk e ka përmbushur rolin e saj në dy aspekte të cilat i ka evidentuar grupi i auditimit dhe konkretisht referuar mbledhjes së parë të Komitetit Drejtues i Projektit, Enti Zbatues i Projektit (FSHZH), nuk ka qenë prezent në këtë mbledhje për të referuar problematikat mbi pengesat në implementimin e këtij projekti, në kundërshtim me përcaktimet në marrëveshjen "Ligji Nr.19/2017 "Për Ratifikimin e Marrëveshjes së Huasë Ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për Financimin e Projektit për Zhvillimin e Integruar Urban dhe të Turizmit",po ashtu nuk konstatohen raportime nga Enti Zbatues i Projektit (FSHZH), pranë Ministrisë së Infrastrukurës dhe Energjisë brenda datës 10 të çdo muaji, të informacionit të detajuar në lidhje me ecurinë e aktiviteteve të projektit siç ishtekërkuar në mbledhjen e parë të

KDP, zhvilluar në qershor të vitit 2018, përsa më sipër këto veprime ngarkojnë me përgjegjësi Entin Zbatues të Projektit (FSHZH), për rrjedhojë observacioni juaj për këtë pikë nuk merret parasysh.
-Në lidhje me observacionin nga Drejtoresha e Auditit të Brendshëm të FSHZH-së, mbi mungesën e auditimit të këtij projekti për pasqyrat financiare, ju sqarojmë se në asnjë rast grupi i auditimit nuk është shprehur që ky projekt duhet të auditohej për pasqyrat financiare nga Njësia e Auditimit të Brendshëm por duhet të auditohej nga ana e Entit Zbatues i Projektit (FSHZH), për rrjedhojë nga Njësia e Auditit të Brendshëm, dhe meqe jeni shprehur për detyrat që ka njësia zbatuese (FSHZH) referuar marrëveshjes së huasë, për raporte auditimi të tjera drejtuar Ministrisë dhe Bankës Botërore ,këto nuk janë kryer duke e lënë titullarin e Institucionit dhe Ministrinë e linjës, pa informacion në lidhje me ecurinë e këtij projekti i cili ka rëndësi të veçantë për turizmin në zonat ku aplikohet,për rrjedhojë observacioni juaj në këtë pikë nuk merret parasysh.

IV. B. Mbi shkallën e realizimit të objektivave dhe të komponentëve të projektit në krahasim me ato të përcaktuara në marrëveshjet me huadhënësit

Projekti u bë zyrtarisht efektiv në fund të prillit 2017 dhe ka një kohëzgjatje 5 vjeçare deri në Korrik 2022. Ai shtrihet në qendrat urbane të Sarandës, Gjirokastrës, Beratit, Përmetit dhe përgjatë korridorit turistik që kalon në këtë rajon.
Nga ky projekt parashikohet të përfitojnë 84 mijë banorë dhe rreth 300 mijë turistë. Objektivi i projektit është përmirësimi i infrastrukturës urbane, nxitja e turizmit dhe forcimi i kapaciteteve institucionale për të mbështetur turizmin dhe zhvillimin e ekonomisë lokale në zonat e përzgjedhura në jug të Shqipërisë.
Puna për zbatimin e projektit është e organizuar sipas katër komponentëve kryesorë.
Komponenti 1. Projektimi urban dhe përmirësimi i infrastrukturës (44.3 milionë Euro) i cili financon hartimin e projekteve për zbatimin e projektimit urban dhe investime për përmirësime të infrastrukturës bashkiake në katër qendrat urbane: Saranda, Gjirokastra, Berati dhe Përmeti.
Investimet në këto bashki të përzgjedhura përfshijnë rehabilitimin e hapësirave publike (psh, parqe, sheshe, pedonale), rrjet rrugor, nyje inter-modale dhe infrastrukturë shoqëruese (p.sh, trotuaret, kryqëzimet rrugore, ndriçimet rrugore, korsitë e biçikletave, stacionet e autobusëve); restaurimin e ndërtesave të përzgjedhura të trashëgimisë dhe përmirësimin e fasadave të ndërtesave të zgjedhura dhe përmirësimin e zonave turistike (p.sh. rrugët hyrëse, qendrat e vizitorëve, vendparkimet, sinjalistikë turistike).
Ky komponent do të financojë gjithashtu përgatitjen e projekteve urbane, studimeve të fizibilitetit, projekteve inxhinierike dhe supervizimin e projekteve ndërtimore. Infrastruktura nëntokësore do të përfshihet si pjesë e përmirësimit të rrjetit rrugor, kur të jetë e nevojshme.
Komponenti 2. Përmirësimi i siteve turistike (8.4 milionë Euro), financon investime që kanë për qëllim përmirësimin e siteve turistike të përzgjidhura përgjatë korridorit turistik në Shqipërinë e Jugut. Investimet përfshijnë restaurimin e objekteve të trashëgimisë dhe aseteve kulturore, përmirësimin e infrastrukturës mbështetëse. Ky komponent do të financojë gjithashtu përgatitjen e studimeve të fizibilitetit, planet e menaxhimit të siteve, projektet inxhinierike dhe supervizimin e projekteve ndërtimore.
Komponenti 3: Tregu i turizmit dhe zhvillimi i produkteve (7.7 milionë Euro), financon aktivitetet për përmirësimin e menaxhimit bashkiak dhe ofrimin e shërbimeve, si dhe zhvillimin

e zinxhirit të vlerës. Ky komponent është i ndarë në dy komponentë plotësues: a) Mbështetja në ofrimin e shërbimeve bashkiake. Ky nënkomponent financon: (i) aktivitetet që synojnë përmirësimin e ofrimit të shërbimeve dhe menaxhimin bashkiak në bashkitë në zonën e projektit. Aktivitetet përfshijnë asistencë teknike dhe mjete për menaxhimin e përmirësuar bashkiak (për shembull, sistemet e menaxhimit të aseteve dhe GIS). (ii) asistencën teknike që synon përmirësimin e ofrimit të shërbimeve (për shembull: studimet e menaxhimit të trafikut) dhe rritjen e funksionimit të aseteve të rehabilituara në kuadër të projektit dhe pajisjeve të zgjedhura (p.sh. grumbullimin e mbetjeve të ngurta). b) Zhvillimi i produkteve turistike dhe zinxhirit të vlerës. Ky nënkomponent financon: (i) kërkimin e tregut për të udhëhequr aktivitetet e zhvillimit të produktit; (ii) aktivitetet që mbështesin krijimin e partneriteteve për menaxhimin e destinacionit në nivel bashkiak dhe rajonal; (iii) zhvillimin e së paku 20 produkteve të reja turistike në zonën e projektit dhe, (iv) krijimin e një sistemi të statistikave kombëtare të turizmit;
Komponenti 4: Mbështetja e Implementimit. FSHZH/PCU dhe Konsulentë të përzgjedhur (3.2 M. Euro)

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion grupit të auditimit u konstatua se përsa më sipër referuar kategorive të marrëveshjes, përdorimi i kredisë së projektit dhe shkalla e realizimit paraqitet si më poshtë :

PIUTD- "Projekti për Zhvillimin e Integruar Urban dhe Turizmin "			
Marrëveshja sipas kategorive		**(Euro)**	
Kategori	**Marrëveshja**	**Perdorur deri me 30.11.2021**	**%**
Punime	49,816,500	11,395,251	23
Shërbime Konsulence	8,710,000	2,564,132	29
Mallra/Investime	2,530,000	561,533	22
Trajnime	54,000	13,079	24
Kosto operacionale	2,530,000	1,905,147	75
Tarifa e përparme	159,500	159,500	100
Total	**63,800,000**	**16,598,642**	26

-*Për qytetin e Sarandës* janë parashikuar 3 kontrata për punime civile nga të cilat kanë përfunduar Kontrata ñPër përmirësimin e shkallareve të qytetit të Sarandësò, ndërsa Kontrata e punimeve ñPër përmirësimin e shëtitores ñNaim Frashëriò të qytetit të Sarandësò ka përfunduar punimet civile dhe është ne periudhën e garancisë se defekteve; ndërkohë punimet për kontratën ñPërmirësimi i integruar urban në qytetin e Sarandësò nuk kanë filluar akoma, referuar planit fillestar të prokurimit.
-*Për qytetin e Gjirokastrës,* janë parashikuar 5 kontrata për punime civile nga të cilat vetëm kontrata (i)ñPër rehabilitimin e kalldrëmit të pazarit të Gjirokastrës dhe punimet nëntokësoreò kanë përfunduar ndërsa kontrata për (ii)ñPërmirësimin e Muzeut Historik të Gjirokastrësò është në perfundim te punimeve civile, dhe (iii)Zbatimi i masave paraprake per adresimin e shqetesimeve urgjente per sigurine dhe parandalimin e humbjes se strukturave te trashegimise ne Kalane e Gjirokastres ka filluar ne Tetor 2021. Nderkohe, FSHZH po vijon punën për përgatitjen

e projekteve teknike dhe dokumentacionit të tenderimit për 2 paketat e tjera/konkretisht projektet : òPërmirësimi i integruar urban i infrastrukturës dhe mobilitetit në qytetin e Gjirokastrës;
-*Për qytetin e Beratit*, janë parashikuar 5 kontrata për punime civile nga të cilat ka përfunduar (i) ñRehabilitimi i kalldrëmit të rrugës Mihal Komeno për në kalaò , (ii) ñPërmirësimi i rrugës së makinave ñMuzak Topiaò për në kalaò e cila aktualisht eshte ne periudhen e garancise se defekteve dhe kane filluar punimet per kontraten (iii)ñPermiresimi i Integruar Urban i Qytetit te Beratit / paketa 1 (Punime Civile ne Gorice)ò. Nderkohe ka perfunduar procedura e prokurimit dhe priten te fillojne punimet brenda muajit Dhjetor 2021 per 2 kontratat e tjera: (iv) Berat Town of Integrated Urban Upgrading - Package 02 (Antipatrea + I.V &Zvernec Benja) (v) Berat Town of Integrated Urban Upgrading -Ethnographic Museum and Mihal Komneno Package 03 (Selamlleku+Mangalemi)

-*Për qytetin e Përmetit,* janë parashikuar 4 kontrata për punime civile nga të cilat ka përfunduar vetëm një kontratë ñNdriçimi i hyrjes së qytetit të Përmetitò, ndërkohë që tre kontratat e tjera janë bashkuar ne nje procedure per te cilen ka filluar zbatimi i punimeve civile ñZhvillimi i Integruar Urban i Qytetit te Permetitò.
-Përsa i përket arritjes së objektivave të projektit të ndara sipas qyteteve, për kontrata punimesh që janë realizuar deri tani, paraqitet si më e suksesshmja kontrata për ñPërmirësimi i infrastrukturës nëntokësore dhe kalldrëmit të pazarit të Gjirokastrësò duke i dhënë një zgjidhje si rrjetit të KUZ dhe rrjetit të UK Gjirokastër, gjithashtu është përmirësuar kalldrëmi i qafës së pazarit të qytetit të Gjirokastrës duke e përshtatur me historikun e qytetit ku për mbrojtjen e kësaj infrastrukture në çdo rrugë hyrëse janë vendosur pengesa për mjetet e tonazhit të rëndë, për të konservuar trashëgiminë kulturore me efekt shtimin e turistëve vendas dhe të huaj. Gjithashtu edhe kontrata p^y r ñPër përmirësimin e shëtitores ñNaim Frashëriò të qytetit të Sarandës i ka dh^y në nj^y tjet^y r pamje qytetit, duke e p^y rshtatur me koh^y n dhe rritjen e turizmit.
-*Nga auditimi është konstatuar se referuar bërjes efektive të projektit në fund të vitit 2017 me afat përfundimi në Korrik 2022, për periudhën 2017-2021, në kuadër të programeve me financim të huaj për projektin "Për Zhvillimin e Integruar Urban dhe Turizmin", janë disbursuar nga Banka Botërore rreth 20,190,367 Euro, pra kredia është realizuar me* ***32%****, ndërsa projekti sipas zërave të marrëveshjes është implementuar vetëm****26 %.***
Të dhënat e disbursimit të kredisë paraqiten si më poshtë në mënyrë progresive nga fillimi i projektit deri më 30.11.2021.

Vitet	Kredia	2017	2018	2019	2020	2021	Total	%
Disbursuar	**63,800,000**	1,500,000	2,418,102	7,080,416	1,218,250	7,973,600	**20,190,367**	32

1. Titulli i gjetjes: Ecuria e ulët e projektit
Situata:Përsa i përket realizimit të projektit sipas zërave të marrëveshjes ato paraqiten në nivele shumë të ulta krahsimisht me afatin kohor të kalauar: punimenë masën 23%, konsulencë në masën 29 %, Mallra në masën 22 %, Trajnime në masën 24%, kosto operative në masën 75 % ,ndërsa tarifa e angazhimit në masën 100%.
Projekti nuk ka përfunduar akoma dhe është në fazën e implementimit dhe të përdorimit të shumës së mbetur të kredisë.Përveç sa më lart, nuk mund të shprehemi 100 % për realizimin e

objektivave të tij, impakti i realizimit të të cilave, do të mund të vlerësohet në një periudhë të mëvonshme. Edhe pse në këto kushte nisur nga zvarritjet dhe kalimi i më shumë se 3/4 e kohës së projektit ecuria e tij është në nivelet e 26% që sjell dhe dyshimin e arsyeshëm për mos përfundimin në afat të këij projekti.
Ndikimi/Efekti: Shtimi i kohës dhe kostove pë këtë projekt minimalisht kostot operative të cilat janë në nivelin 75% praktikisht në këto nivele duhet të ishte dhe ecuria e projektit.
Rëndësia: E mesme

Rekomandimi: Njësia e menaxhimit të projekti Fondi Shqiptar i zhvillimit të marrin masat për përfundimin sa më shpejt të fazës së projektim me qëllim respektimin e afateve dhe realizimin e procedurave për punë civile në cilësi dhe afat, gjithashtu monitorimin dhe ndjekjen në vijimësi të çdo kontrate në proces për mënjanimin e pengesave dhe zvarritjeve të tjera.

IV. C. ***Mbi menaxhimin finaciarë të projektit, shkallën e realizimit të disbursimeve financiarë të fondeve kundrejt nivelit të programuar. Raportimi i tyre në Ministrinë e Finacave dhe Ekonomisë.*****, ku u konstatua*:***

Realizimi i disbursimeve per kete projekt deri ne muajin Nentor 2021 paraqitet në masë 32% të totalit të disbursimeve nderkohe që të perdorura janë vetëm 26% të tyre 6 % janë gjendje në llogarin e projektit te cilat janë terhequr nga kredia e bankës botrore ñIBRD Loan 8656-AL sipas kushteve te marveshjes ñDisbursmet Arrangementsò paragrafi 3.5 ku minimumi i tërheqjes nga llogaria e BB në atë të projektit, është 750,000 euro një here në 2 muaj.

Kategori	Marreveshja	Perdorur deri me 30.11.2021	%
Punime	49,816,500	11,395,251	23
Konsulence	8,710,000	2,564,132	29
Mallra	2,530,000	561,533	22
Trainime	54,000	13,079	24
Kosto operative	2,530,000	1,905,147	75
Tarife	159,500	159,500	100
Total	**63,800,000**	**16,598,642**	26

Perdorimi i fondeve per punime për këtë projekt paraqitet në masë 23% ose 11,395,251 euro nga 49,816,500 euro të parashikuara në marrëveshje.
Perdorimi i fondeve per Konsulence paraqitet në masë 29% ose 2,564,132 euro nga 8,710,000 euro.
Perdorimi i fondeve per Mallra paraqitet në masë 22% ose 561,533 euro nga 2,530,000 euro.
Perdorimi i fondeve per Trainim stafi paraqitet në masë 24% ose 13,079 euro nga 54,000 euro.
Perdorimi i fondeve per Kosto operative paraqitet në masë 75% ose 1,905,147 euro nga 2,530,000 euro.
Si dhe tarife fillestare prej 159,500 euro e realizuar 100%.
Gjendje në llogarin e projektit sipas pasqyrës së bankës më 30.11.2021 në bankën CREDINS ne llogarin në euro paraqitet në vlerën 437,488.35 euro ndërsa gjendja e llogarisë në lek paraqitet në vlerën 93,814,561.15 lekë.

Ndërsa disbursimeve në vite paraqitet si më poshtë.

Vitet	Kredia	2017	2018	2019	2020	2021	Total	%
Disbursuar	**63,800,000**	1,500,000	2,418,102	7,080,416	1,218,250	7,973,600	**20,190,367**	32
Tarifa e angazhimi 0.25% llogaritur nga KLSH			149,704	132,003	128,958	**109,024**	**519,689**	

Edhe pse disbursimet praqiten në vlerën prej20,190,367 euro ose 32 % përdorimi i tyre është vetëm 16,598,642 euro ose 26%, vonesa këto kryesisht nga mos realizimi i procedurave të prokurimit sipas planit fillestare por që pengesë kryesore kanë qenë, lejet përkatëse për ruajtjen e trashëgimisë kulturore pasi 2 qytete kryesore ku zbatohet ky projekt janë pjesë e trashëgimisë kulturore botërore të cilat mbrohen nga UNESCO, shpronësimet për ato pjesë pronash ku kalon projekti siç është rruga ñMuzak Topiaò për në kalan e Beratit e zvarritur për këtë arsye edhe se shkresa me listën e shpronësimeve ka vajtur në Ministrinë e Ekonomisë, nuk është proceduar ende si dhe vonesat në procedurat me Bankën Botërore, miratimet marrjen e NO Objection etj.
Projekti paraqitet në nivele shumë të ulta përdorimi fondesh si dhe disbursimi nisur nga fakti që duhet të përfundojë më 31.07.2022 ose pas 8muajsh ndërkohë që efektiv është bërë në prill të vitit 2017.
Në zbatim të Ligjit nr.19/2017 ñPër Ratifikimin e Marrëveshjes së Huasë Ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për Financimin e Projektit për Zhvillimin e Integruar Urban dhe të Turizmitò neni II pika 2.04 óTarifa e angazhimit që paguan huamarrësi është e barabartë me një të katërtën e një përqind (0.25%) në vittë shumës së pa tërhequr.
Në zbatim të sa më sipër dhe zvarritjes së realizimit të projektit krahasuar me afatin e përfundimit të tij 31.07.2022 praktikisht dhe 8 muaj nga 5 vite në total, shuma e disbursuar e projektit krahasimisht me kohën që ka kaluar është tejet e ulë ose 32 % disbursim nga 85% kohë. Nëse projekti do ecte me ritmin e duhur praktikisht niveli i disbursimeve do ishte i përafërt me atë të afatit të zbatimit të projektit.
Ecja me ritme të ngadalta e ekspozon Huamarrësin në këste pagese të tarifës së angazhimit tejet të larta krahasimisht me atë të parashikuar sic vihet re dhe në tabelën e mësipërme.
Raportimi I tyre pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë është kryer sipas marrëveshjes.

1.Titulli i gjetjes: Ecuria e ulët në realizimin e projektit
Situata: Nga auditimi i pagesave dhe disbursimeve u konstatua se, realizimi i tyre paraqitet në nivele tejet të ulta kjo reflektohet dhe në gjendjen e llogarive financiare të projektit dhe sasisë së disbursuar e cila paraqitet në nivelet e 32% krahasimisht me atë të përdorur apo realizuar e cila është 26%. Edhe pse ka kaluar 3/4 e kohës nga fillimi i implementimit të këtij projekti realizimi i procedurave të projektimit dhe konsulencës paraqitet në nivelet e 29 % tejet të ulta krahasimisht me kohë ndërkohëqë punimet civile të cilat janë të lidhur ngushtë me fazën e projektimit janë në nivelet e 23% realizim. Gjithashtu proceset e shpronësimeve nuk kanë marrë akoma zgjidhje nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë edhe pse kërkesa është dërguar që në vitin 2018.
Kriteri: Ligji nr.19/2017 ñPër Ratifikimin e Marrëveshjes së Huasë Ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për Financimin e Projektit për Zhvillimin e Integruar Urban dhe të Turizmitò shtojca II seksioni IV pika B.2 data e mbylljes 31.07.2022.

Ndikimi/Efekti:Vonesa në ecurinë e projektit duke ngritur dyshimin e arsyeshëm për pa mundësinë e realizimit në kohë të projektit si rezultat edhe i kohës fizike që secili projekt i pa nisur tenderuar apo filluar kërkon, me pasojë shtimin e kostove të projektit.
Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Entit Zbatues i Projektit (FSHZH), të marrë masa të menjëhershme për përfundimin e procedurave të prokurimit për projektim dhe konsulencë në kohë dhe cilësi me qëllim të hapjes së rrugës për procedurat e punimeve civile që praktikisht paraqiten në nivele tejet të ulta.

2.Titulli i gjetjes: **Rritja e kostove si rezultat i tarifës së angazhimit**
Situata: Nga auditimi i pagesave dhe disbursimeve në zbatim të marrëveshjes u konstatua se përtë gjithë vlerën e pa disbursuar për huamarrësin për çdo vit aplikohet tarifa e angazhimit e barabartë me një të katërtën e një përqind (0.25%) në vit të shumës së pa tërhequr.
Nga aplikimi i tarifës së angazhimit dhe disbursimet në nivelet kaq të ulëta huamarrësi detyrohet të paguaëj një shumë të përafërt me 519,689euro nëse kjo tarifë do aplikohej nga huadhënësi. Disbursimet në nivele të ulta e ekspozon huamarrësin në detyrimin e tarifave të angazhimit tejet të larta krahsimisht me ato që mund të aplikohen nëse kemi një ecuri normale në disbursime.
Kriteri:ñLigjin nr.19/2017 ñPër Ratifikimin e Marrëveshjes së Huasë Ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për Financimin e Projektit për Zhvillimin e Integruar Urban dhe të Turizmitò neni II pika 2.04.
Ndikimi/Efekti:Shtimi i kostove të projektit me detyrime të tjera përtej nivelit të parashikuar.
Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Entit Zbatues i Projektit (FSHZH), të marrë masa të menjëhershme për ecurinë në fazat e projektimit dhe zbatimit të projektit në përfundimin e procedurave të prokurimit dhe realizimin e punimeve të ndërtimit me qëllim respektimin e afateve dhe kostove të miratuara.

Janë audituar urdhër pagesat e punimeve si më poshtë vijon:
Për periudhën objekt auditimit janë audituar pagesat për 5 kontrata punimesh civile dhe 1 kontratë konsulece, ose në vlerë 4,001,182 euro nga 5,759,324 euro të likuiduara ose 69%.
-Nga 24 IPC apo fatura të audituara për pagesë në 6 prej tyre u konstatua një problematik në mbajtjen e garancisë bankare prej 10% sipas kushteve të kontratës, ose në 25% të faturave të likuiduara por kjo e konstatuar vetëm në situacione e hartuara nga mbikëqyrësi i punimeve ñT.ò shpk.
-Ndriçimi i rrugës hyrëse Përmet
Formular për urdhër transfertën nga C....Bank datë 19.11.2018 me vlerë 4,141,500 lekë, kërkesa për pagesë situacioni nr. 1 datë 16.11.2018 me vlerë kontrate me tvsh 4,601,667 lekë, shkresa e dorëzimit të situacionit nr. 1 nga supervizori ñT....ò shpk datë 24.10.2018 nr. prot 324, fatura tatimore nr. 13 datë 30.10.2018 me vlerë 4,601,667 lekë me tvsh, situacioni përfundimtar datë 1.08.2018-29.09.2018 me vlerë 4,141,500lekë duke zbritur 460,166 lekë garanci punimesh prej 10%.

Formular për urdhër transfertën nga C.....Bank datë 10.12.2019 me vlerë 460,167lekë , kërkesa për garancinë, shkresa e dorëzimit të ñCertifikatës së marrjes përfundimtare në dorëzim të punimeve, si dhe kërkesa e sipërmarrësit për likujdimin e garancisëò likujduar.
Për kontratën e punimeve ñNdricimi i rrugës hyrëse Përmetò me operator fitues JV ñH...,ò &òB.....ò shpk është miratuar dhe urdhër ndryshimi nr. 02 ku janë miratuar zbritaj e volumeve të punimeve me vlerë 219,373 lekë dhe rritja e vlerës së mallrave me vlerë 332,400lekë, me një shtesë në vlerën e kontratës prej 113,027 lekë brenda fondit rezervë të miratuar.
Sic vihet re edhe pse është kontrata me vlerë më të vogël pagesa e faturës është kryer me 33 ditë vonesë krahasimisht me likujdimet e faturave të operatorëve të tjerë.

-Rehabilitimit I infrastrukturës dhe restaurimi I kalldrëmeve në pazarin e Gjirokastrës
-Formular për urdhër transferten ngaC..... Bank datë 20.12.2018 me vlerë 25,031,760 lekë, kërkesa për pagesë situacioni nr. 1 datë 20.12.2018 me vlerë kontrate me tvsh 137,778,274 lekë, shkresa e dorëzimit të situacionit nr. 1 nga mbikëqyësi i punimeve ñA....ò shpk datë 20.12.2018 nr. Prot 354, fatura tatimore nr. 71 datë 20.12.2018 me vlerë 27,813,065 lekë me tvsh, situacioni pjesor datë 24.09.2018-20.12.2018 me vlerë 25,031,759lekë duke zbritur 2,781,306 lekë garanci punimesh prej 10%.
-Formular për urdhër trasfertën nga C..... Bank datë 24.05.2019 me vlerë 25,142,382 lekë, kërkesa për pagesë situacioni nr. 2 datë 22.05.2019 me vlerë kontrate me tvsh 137,778,274 lekë, shkresa e dorëzimit të situacionit nr. 2 nga mbikqyrësi I punimeve ñA....ò shpk datë 20.05.2019 nr. Prot 110, fatura tatimore nr. 78 datë 20.05.2018 me vlerë 27,935,980 lekë me tvsh, situacioni pjesor nr. 2 date 21.12.2018-30.04.2019 me vlerë 25,142,382lekë duke zbritur 2,793,598 lekë garanci punimesh prej 10%.
-Formular për urdhër trasfertën nga C..... Bank datë 19.07.2019 me vlerë 28,351,754 lekë, kërkesa për pagesë situacioni nr. 3 datë 18.7.2019 me vlerë kontrate me tvsh 137,778,274 lekë, shkresa e dorëzimit të situacionit nr. 3 nga mbikqyrësi I punimeve ñA...ò shpk datë 17.07.2019 nr. Prot 169, fatura tatimore nr. 82 datë 17.07.2019 me vlerë 31,501,949 lekë me tvsh, situacioni pjesor nr. 3 date 01.05.2019-15.07.2019 me vlerë 28,351,754lekë duke zbritur 3,150,194 lekë garanci punimesh prej 10%.
-Formular për urdhër trasfertën nga C..... Bank date 25.10.2019 me vlerë 15,511,957 lekë, kërkesa për pagesë situacioni nr. 4 datë 23.10.2019 me vlerë kontrate me tvsh 137,778,274 lekë, shkresa e dorëzimit të situacionit nr. 4 nga mbikqyësi i punimeve ñA....ò shpk datë 11.09.2019 nr. Prot 218, fatura tatimore nr. 87 datë 02.09.2019 me vlerë 17,235,508 lekë me tvsh, situacioni pjesor nr. 4 date 15.07.2019-31.08.2019 me vlerë 15,511,957lekë duke zbritur 1,723,550 lekë garanci punimesh prej 10%.
-Formular për urdhër trasfertën nga C..... Bank datë 19.11.2019 me vlerë 29,959,135 lekë, kërkesa për pagesë situacioni nr. 5 datë 19.11.2019 me vlerë kontrate me tvsh 137,778,274 lekë, shkresa e dorëzimit të situacionit nr. 5 nga mbikqyrësi i punimeve ñA....ò shpk, datë 24.10.2019 nr. Prot 267, fatura tatimore nr. 99 datë 11.11.2019 me vlerë 33,287,928 lekë me tvsh, situacioni pjesor nr. 5 date 01.09.2019-24.09.2019 me vlerë 33,287,928lekë duke zbritur 3,328,792 lekë garanci punimesh prej 10%.
Formular për urdhër transferten nga C..... Bank, datë 22.04.2020 me vlerë 6,888,721 lekë, kërkesa për pagesë pjesës së para të garancis së mbajtur (5%), shkresa e dorëzimit të ñCertifikatës së marrjes në dorëzim të punimeve, datë 07.02.2020ò likujduar.

-Rehabilitimit I rrugës hyrëse "Mihal Komneno" për në kala dhe Tabja

-Formular për urdhër transfertën nga C..... Bank datë 28.06.2018 me vlerë 36,349,997 lekë, kërkesa për pagesë situacioni nr. 1 datë 28.06.2018 me vlerë kontrate me tvsh 148,120,404 lekë, shkresa e dorëzimit të situacionit nr. 1 nga mbikqyësi I punimeve ñT....ò shpk, datë 18.06.2018 nr. Prot 142, fatura tatimore nr. 94 datë 12.06.2018 me vlerë 39,654,542 lekë me tvsh, situacioni pjesor datë 19.02.2018-19.05.2018 me vlerë 36,349,997lekë duke zbritur 3,304,545 lekë garanci punimesh prej 10% të vlerës së situacionit pa TVSH , ***ndryshe nga specifikmet e kontratës në Kushtet e Pergjithshme të Kontratës 50.1 "Garancia bankare 10% e çmimit të kontratës", në rastin konkret vlera që duhet ti mbahej operatorit është 3,965,454lekë ose 660,909 lek më tepër.***

-Formular për urdhër transferten nga C..... Bank datë 12.09.2018 me vlerë 33,135,848 lekë , kërkesa për pagesë situacioni nr. 2 datë 12.09.2018 me vlerë kontrate me tvsh 148,120,404 lekë, shkresa e dorëzimit të situacionit nr. 2 nga mbikqyrësi I punimeve ñT....ò shpk, datë 10.09.2018 nr. Prot 253, fatura tatimore nr. 150 datë 10.09.2018 me vlerë 36,148,198 lekë me tvsh, situacioni pjesorë datë 20.05.2018-10.09.2018 me vlerë 33,135,848lekë duke zbritur 3,012,349 lekë garanci punimesh prej 10% të vlerës së situacionit pa TVSH , ***ndryshe nga specifikmet e kontratës në Kushtet e Pergjithshme të Kontratës 50.1 "Garancia bankare 10% e çmimit të kontratës", në rastin konkret vlera që duhet ti mbahej operatorit është 3,614,819lekë ose 602,470 lekë më tepër.***

-Formular për urdhër trasfertën nga C..... Bank datë 11.10.2018 me vlerë 28,376,935 lekë, kërkesa për pagesë situacioni nr. 3 datë 10.10.2018 me vlerë kontrate me tvsh 148,120,404 lekë, shkresa e dorëzimit të situacionit nr. 3 nga mbikqyrësi I punimeve ñT.ò shpk, datë 27.09.2018 nr. Prot 286/1, fatura tatimore nr. 770 datë 01.10.2018 me vlerë 30,956,656 lekë me tvsh, situacioni pjesorë nr. 3 date 11.09.2018-27.09.2018 me vlerë 28,376,935lekë duke zbritur 2,579,721 lekë garanci punimesh prej 10% të vlerës së situacionit pa TVSH , ***ndryshe nga specifikmet e kontratës në Kushtet e Pergjithshme të Kontratës 50.1 "Garancia bankare 10% e çmimit të kontratës", në rastin konkret vlera që duhet ti mbahej operatorit është 3,095,665lekë ose 515,944 lekë më tepër.***

*Në zërin e punimeve **4.2 Pika Panoramike Jugore e Kalasë së Beratit, Tabja** nën pika **4.2.2 çmontim antene konstruksion metalik H=15ml** me sasi të preventivuar prej 72ton dhe realizuar sipas dokumentacionit të përgatitur nga kompania "S..." shpk dhe konfirmuar nga mbikqyrësi "T...." shpk me peshë 69.5 ton.*

Për justifikimin e kësaj peshe kontraktori si dokument justifikues për pagesë ka sjellë :

Procesverbal heqjen e antenës në prezencë të përfaqësuesve të RTSH date 23.05.2018 ku nëasnjë rresht nuk flet për peshën e konstruksionit metalik.

Procesverbal I peshimit në 4 kamion ku në total sipas këtij procesverbali I hartuar, pranuar dhe nënshkruar nga A. M.përfaqësues i "S." shpk dhe D. Q.për "T." shpk me peshë 69.5 ton, por në asnjë moment nënshkruar nga përfaqësuesit e RTSH si pronarë të konstruksionit.

Në paragrafin e katërt citohet: Materiali pasi u peshua, në bashkëpunim me përfaqësuesit e RTSh u dërgua për magazinim në Radio Stacionin Shijak.

Pra në interpretim të drejtë dhe të saktë të fjalisë cituar dhe nga kontraktori (Pasi u peshua,) dmth RTSH nuk ka qenë prezent këtë e konfirmon dhe vazhdimi I fjalisë I cili thotë (në bashkëpunim me përfaqësuesit e RTSh u dërgua…)

Pra e gjithë përgjegjësia për peshën e antenës mbetet mes A. M.përfaqësues I "S." shpk dhe D.Q. për "T." shpk, element që do konfirmohet në institucionin pritës (RTSH) dhe do përcillet për vendimmarrje të mëtejshme në organet përkatëse.

-Formular për urdhër transfertën nga C.... Bank, datë 23.11.2018 me vlerë 35,445,582 lekë, kërkesa për pagesë situacioni nr. 4 (përfundimtar) datë 23.11.2018 me vlerë kontrate me tvsh 148,120,404 lekë, shkresa e dorëzimit të situacionit nr. 4 nga mbikqyrësi i punimeve ñT.ò shpk date 25.10.2018 nr. Prot 293, fatura tatimore nr. 186 datë 26.10.2018 me vlerë 41,361,006 lekë me tvsh, situacioni pjesorë nr. 4 date 28.09.2018-03.10.2018 me vlerë 35,445,582lekë duke zbritur 5,915,423 lekë garanci punimesh, në këtë situacion janë mbajtur dhe diferencat e krijuar në situacionet e mëparshme prej 1,779,323 lekë.
Formular për urdhër transfertën nga C.... Bank, datë 09.04.2019 me vlerë 7,406,020 lekë, kërkesa për pagesë pjesës së para të garancisë së mbajtur (5%), shkresa e dorëzimit të ñCertifikatës së marrjes në dorëzim të punimeve, datë 08.11.2018ò likujduar më 12.04.2019.
Formular për urdhër trasfertën nga C.... Bank datë 26.02.2020 me vlerë 7,406,020lekë , kërkesa për pagesë pjesës së dytë të garancisë së mbajtur, shkresa e dorëzimit të ñCertifikatës së marrjes përfundimtare në dorëzim të nënprojektitrikonstruksioni i rrugës ñMihal Komenoò për në kala dhe Tabja, datë 27.11.2019ò likujduar më 28.02.2020.

3.Titulli i Gjetjes: Pasaktësi në mbajtjen e garancisë së punimeve
Situata: Nga auditimi i IPC për secilën urdhër shpenzim në 3 IPC e para u konstatua se mbajtja egarancisë së punimeve prej 10% nuk është kryer konform parashikimeve në kontratë duke sjellë diferenca prej 1,779,323 lekë të cilat janë sistemuar në IPC e mëvonshme, pavarësisht se pregatitja e situacionit kryhet nga Kontraktori, mbikëqyrësi i punimeve dhe nga Menaxheri i kontratës nga ana e departamentit të financës nuk është trajtuar me vëmendjen e duhur kjo situatë,pasi vetëm në kontratat e tij ka ndodhur kjo problematikë duke sjellë përdorimin e dy standardeve në mbajtjen e garancisë së punimeve.
Kriteri:*Kushtet e Pergjithshme të Kontratës 50.1 "Garancia bankare 10% e çmimit të kontratës"*i cili është me TVSH.
Ndikimi/Efekti:përdorimi i diferencës së pa mbajtur të fondeve prej 1,779,323 lekë të projektit nga kontraktori, duke mos respektuar kushtet e kontratës.
Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Entit Zbatues i Projektit (FSHZH), Menaxherët e kontratave dheDepartamenti Ekonomik në çdo rast të verifikojë detyrimin për pagesë duke respektuar kushtet e kontratës dhe mirëmenaxhuar fondet në dispozicion.

-Rehabilitimi I shkallarëve të Sarandës
-Formular për urdhër transfertën nga C.... Bank datë 26.12.2017 me vlerë 9,539,057 lekë, kërkesa për pagesë paradhënie sipas Kushteve të përgjithshme të kontratës 49.1 me vlerë kontrate me tvsh 95,390,574 lekë, shkresa e dorëzimit të kërkesës për paradhënie nga mbikëqyrësi i punimeve ñA....ò shpk, datë 22.12.2017 nr. Prot 425, fatura tatimore nr. 71 datë 21.12.2017 me vlerë 9,539,057 lekë me tvsh, garancia e pagesës së paradhënies nga banka Credins nr. 4797 datë 21.12.2017.

-Formular për urdhër transfertën nga C.... Bank, datë 03.04.2018 me vlerë 11,881,370 lekë, kërkesa për pagesë situacioni nr. 1 datë 30.03.2018 me vlerë kontrate me tvsh 95,390,574 lekë, shkresa e dorëzimit të situacionit nr. 1 nga mbikqyrësi i punimeve ñA....ò shpk, datë 29.03.2018 nr. Prot 78, fatura tatimore nr. 10 datë 30.03.2018 me vlerë 13,093,755 lekë me tvsh, situacioni pjesorë datë 08.01.2018-20.03.2018 me vlerë 11,881,370lekë duke zbritur 2,579,721 lekë garanci punimesh prej 10% të vlerës së situacionit pa TVSH , duke zbritur 10% paradhënie ose 1,212,384 lekë dhe 10% të garanci kontrate ose 1,212,384 lekë pa tvsh ***ndryshe nga specifikmet e kontratës në Kushtet e Përgjithshme të Kontratës 50.1 "Garancia bankare 10% e çmimit të kontratës", në rastin konkret vlera që duhet ti mbahej operatorit është 1,454,861 lekë ose 242,477 lek më tepër.***

-Formular për urdhër transfertën nga C....Bank, datë 11.05.2018 me vlerë 14,151,463 lekë, kërkesa për pagesë situacioni nr. 2 datë 11.05.2018 me vlerë kontrate me tvsh 95,390,574 lekë, shkresa e dorëzimit të situacionit nr. 2 nga mbikqyrësi i punimeve ñA...ò shpk datë 10.05.2018 nr. Prot 120, fatura tatimore nr. 18 datë 18.05.2018 me vlerë 15,595,490 lekë me tvsh, situacioni pjesorë datë 21.03.2018-03.05.2018 me vlerë 14,151,462lekë duke zbritur 10% paradhënie ose 1,444,026 lekë dhe 10% të garanci kontrate ose 1,444,026 lekë n***dryshe nga specifikimet e kontratës në Kushtet e Pergjithshme të Kontratës 50.1 "Garancia bankare 10% e çmimit të kontratës", në rastin konkret vlera që duhet ti mbahej operatorit është 1,732,832 lekë ose 288,806 lekë më tepër.***

-Formular për urdhër transfertën nga C.... Bank, datë 11.07.2018 me vlerë 6,789,916 lekë, kërkesa për pagesë situacioni nr. 3 datë 11.07.2018 me vlerë kontrate me tvsh 95,390,574 lekë, shkresa e dorëzimit të situacionit nr. 3 nga mbikqyrësi i punimeve ñA...ò shpk, datë 04.07.2018 nr. Prot 169, fatura tatimore nr. 32 datë 04.07.2018 me vlerë 7,984,578 lekë me tvsh, situacioni pjesorë nr.3 date 04.05.2018-03.07.2018 me vlerë 6,789,916 lekë duke zbriturparadhënie ose 5,292,802 lekë pasi me 06.07.2018 garancia bankare për këtë skadondhe 10% të garanci kontrate ose 1,194,661 lekë ***ndryshe nga specifikmet e kontratës në Kushtet e Përgjithshme të Kontratës 50.1 "Garancia bankare 10% e çmimit të kontratës", në rastin konkret vlera që duhet ti mbahej operatorit është 1,732,832 lekë ose 288,806 lekë më tepër.***

-Formular për urdhër transfertën nga C.... Bank date 07.12.2018 me vlerë 11,340,063 lekë, kërkesa për pagesë situacioni nr. 4 datë 12.12.2018 me vlerë kontrate me tvsh 95,390,574 lekë, shkresa e dorëzimit të situacionit nr. 4 nga mbikqyrësi i punimeve ñA...ò shpk, datë 04.12.2018 nr. Prot 330, fatura tatimore nr. 64 datë 12.11.2018 me vlerë 13,455,865 lekë me tvsh, situacioni pjesorë nr.4 date 20.09.2018-30.10.2018 me vlerë 11,340,063 lekë duke zbritur10% të garanci kontrate ose 2,115,801 lekë duke mbajtur 770,215 lekë më tepër për të sistemuar diferencat negative të krijuara në 3 situacionet e para.

Problematika me mbajtjen e garancisë së punimeve prej 10% ka ardhur dhe nga veprimet mbikqyrësit të punimeve që pas situacionit të parë kanë ndryshuar formatin e situacionit duke e rradhitur zërin "zbritje Garancie 10%" poshtë zërit vlera e punimeve pa tvsh nga zëri Vlera e Punimeve me TVSH, duke krijuar konfuzion në pagesën e kryer. Formati I situacionit është kthyer në gjendjen fillestare në situacionin e 4.

-Formular për urdhër transfertën nga C.... Bank datë 14.02.2019 me vlerë 28,060,380 lekë, kërkesa për pagesë situacioni përfundimtarë datë 13.02.2019 me vlerë kontrate me tvsh 90,846,945 lekë, shkresa e dorëzimit të situacionit përfundimtarë nga mbikqyrësi i punimeve ñA...ò shpk, datë 12.02.2019 nr. Prot 303, fatura tatimore nr. 4 datë 12.02.2019 me vlerë

31,178,200 lekë me tvsh, situacioni përfundimtar datë 31.10.2018-31.12.2018 me vlerë 28,060,380 lekë duke zbritur10% të garanci kontrate ose 3,117,820 lekë.
Më datë 20.12.2018 për këtë kontratë është miratuar dhe urdhër ndryshimi nr. 4 për ndryshimin e volumeve të punimeve nga ku vlera totale e kontratës shkon në 90,846,945 lekë me TVSH dhe datë përfundimi 31.12.2018.
Formular për urdhër transfertën nga C.... Bank datë 03.04.2019 me vlerë 4,542,347 lekë, kërkesa për pagesë pjesës së para të garancisë së mbajtur (5%), shkresa e dorëzimit të ñCertifikatës së marrjes në dorëzim të punimeve, datë 20.02.2019ò.

4. Titulli i Gjetjes: Pasaktësi në mbajtjen e garancisë së punimeve
Situata: Nga auditimi i IPC për secilën urdhër shpenzim në 4 IPC e para u konstatua se mbajtja egarancisë së punimeve prej 10% nuk është kryer konform parashikimeve në kontratë duke sjellë diferenca prej 820,089 lekë të cilat janë sistemuar në IPC e mëvonshme, pavarësisht se përgatitja e situacionit kryhet nga Kontraktori, mbikëqyrësi i punimeve dhe nga Menaxheri i kontratës nga ana e departamentit të financës nuk është trajtuar me vëmendjen e duhur kjo situatë e provokuar nga mbikëqyrësi i punimeve ñT...ò shpk pasi vetëm në kontratat e tij ka ndodhur kjo problematik duke sjellë përdorimin e dy standardeve në mbajtjen e garancisë së punimeve.
Kriteri:*Kushtet e Përgjithshme të Kontratës 50.1 "Garancia bankare 10% e çmimit të kontratës"*i cili është me TVSH.
Ndikimi/Efekti:Përdorimi i diferencës së pa mbajtur të fondeve prej 820,089 lekë të projektit nga kontraktori, duke mos respektuar kushtet e kontratës.
Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Entit Zbatues i Projektit (FSHZH), Menaxherët e kontratave dhe Departamenti Ekonomik në çdo rast të verifikojë detyrimin për pagesë duke respektuar kushtet e kontratës dhe mirëmenaxhuar fondet në dispozicion.

-Kontrata Konsulentit "Bashkia e Beratit dhe Përmetit konceptimi dhe dizenjimi I detajuar për përmirësimin dhe zhvillimin Urban, dhe supervizim:ò
-Formular për urdhër transfertën nga Credins Bank date 27.07.2018 me vlerë 14,818 euro, kërkesa për pagesë situacioni 1 datë 25.07.2018 me vlerë kontrate me tvsh 740,922 euro, shkresa e dorëzimit të situacionit nr. 1 datë 25.07.2018, fatura tatimore nr. 68 datë 24.07.2018 me vlerë 14,818 euro me tvsh.
-Formular për urdhër transfertën nga Credins Bank datë 27.12.2018 me vlerë 148,184 euro, kërkesa për pagesë situacioni 2 datë 26.12.2018 me vlerë kontrate me tvsh 740,922 euro, shkresa e dorzimit të situacionit nr. 2 date 26.12.2018, fatura tatimore nr. 140 datë 26.12.2018 me vlerë 148,184 euro me tvsh.
-Formular për urdhër transfertën nga Credins Bank datë 23.05.2019 me vlerë 37,046 euro , kërkesa për pagesë situacioni 3 datë 20.05.2019 me vlerë kontrate me tvsh 740,922 euro, shkresa e dorëzimit të situacionit nr. 3 datë 14.05.2019, fatura tatimore nr. 39 datë 10.05.2019 me vlerë 37,046 euro me tvsh.
-Formular për urdhër transfertën nga C.... Bank datë 12.07.2019 me vlerë 37,046 euro , kërkesa për pagesë situacioni 3 datë 10.07.2019 me vlerë kontrate me tvsh 740,922 euro, shkresa e

dorëzimit të situacionit nr. 3 datë 10.07.2019, fatura tatimore nr. 67 datë 04.07.2019 me vlerë 37,046 euro me tvsh.
-Formular për urdhër transfertën nga C.... Bank datë24.12.2019 me vlerë 59,273 euro , kërkesa për pagesë situacioni 4 datë 19.12.2019 me vlerë kontrate me tvsh 740,922 euro, shkresa e dorëzimit të situacionit nr. 4/2 date 14.10.2019 prot. 760/2, fatura tatimore nr. 115 datë 14.10.2019 me vlerë 59,273 euro me tvsh.

IV.D. Mbi zbatimin e kritereve dhe procedurave të përcaktuara sipas rastit në marrëveshje me huadhënësin ose legjislacionin shqiptar, për realizimin e prokurimeve për ndërtime, mallra e shërbime deri në lidhjen e kontratës, ku u konstatua*:*

1. Titulli i Gjetjes: Mos reflektim i ndryshimeve në planin e prokurimeve
Situate: Nga auditimi i planit të auditimit u kosntatua se në të nuk janë reflektuar ndryshimet dhe nuk është njoftuar banka për informim në ecurinë e projektit siç parashikohet në udhëzuesin e Bankës Botërore pika 1.25 e seksionit **Rishikimi, asistenca dhe monitorimi nga banka** Huamarrësi do të azhurnojë planet e prokurimit gjatë gjithë kohëzgjatjes së projektit të paktën çdo vit duke përfshirë kontratat e dhëna më parë dhe që do të prokurohen në 12 (dymbëdhjetë) muajt e ardhshëmé
Kriteri: ñLigjin nr.19/2017 ñPër Ratifikimin e Marrëveshjes së Huasë Ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për Financimin e Projektit për Zhvillimin e Integruar Urban dhe të Turizmitò shtojca II seksioni III pika 2, udhëzuesi i Bankës Botërore pika 1.25
Ndikimi/Efekti: Mungesë e informimit për ecurinë e preojektit dhe procedurave të iniciuara për huadhënësin dhe huamarrësin.
Rëndësia: E mesme.
Rekomandimi: Njësia menaxhuese e projektit**,** në të ardhmen të pasqyrojë ecurinë të secilit projekt në zbatim e sipër si dhe të reflektojë ndryshimet e mundshme të projekteve të tjera për pasqyrimin sa mëkorrekte të situatës dhe fazës në të cilën ndodhet ky projekt.

1-Procedura e prokurimit, Rehabilitimi I infrastrukturës dhe restaurimi ikalldrëmeve, në pazarin e Gjirokastrës"
Në datë 17.01.2018 është iniciuar kërkesa për prokurim për punë publike ñRehabilitimi iinfrastrukturës dhe restaurimi i kalldrëmeve në pazarin e Gjirokastrësò nga D. M.dhe konfirmuar nga Z. E. Q., Menaxher i Projektit të Zhvillimit të Integruar Urban dhe Turizmit drejtuar Njësisë Juridike dhe Prokurimit.
Në datë 18.01.2018 me urdhrin nr. 2 drejtori ekzekutiv i institucionit ka nxjerrë urdhrin për përcaktimin e kritereve teknike për procedurën e mësipërme të përbërë nga P. M., D. Th. dhe E. B.me fond limit 143,453,230 lekë.
Në datë 18.01.2018 grupi I krijuar ka paraqitur relacionin me kriteret teknike referuar urdhrit nr. 2 drejtori ekzekutiv I institucionit ka nxjerrë urdhrin e prokurimit për procedurën e mësipërme me fond limit 143,453,230 lekë.
Në datë 18.01.2018 me urdhrin nr. 2/1 drejtori ekzekutiv I institucionit ka nxjerrë urdhrin prokurimin me fond limit 143,453,230 lekë.
Më datë19.01.2018 është publikuar në fletoren zyrtare.

Më datë 19.01.2018 është publikuar në mediat e shkruara.
Më 26.01.2018 janë hartuar dokumentet e tenderit ñRehabilitimi I infrastrukturës dhe restaurimi I kalldrëmeve në pazarin e Gjirokastrësò.
Kanë shprehur interes për këtë procedure 9 kompani.
Në datë 20.02.2018 ka ardhur përgjigjja nëpërmjet postës elektronike No-Objection për procedurën e prokurimit, në të cilën me ndryshimin nr. 1 është modifikuar shtojca 8 pika 2.5 licenca profesionale e shoqërisë nga N.S-16 B në NP7-B- nga përfaqësuesja e Bankës Botërore Znj. P. R. C.në lidhje me procedurën e prokurimit Numër reference AL-ADF-15540-CË-RFB.
Në minutat e hapjes së tenderit me objekt ñRehabilitimi I infrastrukturës dhe restaurimi I kalldrëmeve në pazarin e Gjirokastrësò.

Kompania	Oferta	Siguria e ofertës
JV ñR.ò	142,502,531 ALL	2,960,000 ALL
ñL...ò shpk	145,024,429 ALL	2,960,000 ALL
JV ñT....ò shpk & ñA...ò	151,293,259 ALL	2,960,000 ALL
JV ñS...ò shpk & ñJ.ò shpk & ñA.ò	139,120,623 ALL	2,960,000 ALL

Më 27.04.2018 është hartuar raporti I vlerësimit për procedurën ñRehabilitimi I infrastrukturës dhe restaurimi I kalldrëmeve në pazarin e Gjirokastrësò.
Në komunikimin me postë elektronike datë 02.05.2018 midis E. Q.dhe përfaqësues së Bankës Botërore për dështimin e procedurës, në përgjigje të këtij problemi përfaqësuesja e Bankës Botërore sugjeron reduktimin e stafit kyç të operatorëve ekonomik duke përfshirë vetëm ato që janë të domosdoshëm për detyrat.
Në komunikimin me postë elektronike datë 10.05.2018 A. Z.I bën me dije kompanive pjesëmarrëse që asnjë nga kompanitë nuk I plotëson specifikimet teknike për kualifikim.
Më 15.05.2018 është nxjerrë ftesa për ofertë për rinisjen e procedurës.
Botuar në fletoren zyrtare datë 21.05.2018.
Publikuar në median e shkruar datë 15.05.2018
Publikuar në agjencinë e prokurimit publik datë 04.06.2018.
Më 16.05.2018 janë hartuar dokumentet e tenderit ñRehabilitimi I infrastrukturës dhe restaurimi I kalldrëmeve në pazarin e Gjirokastrësò procedura AL-ADF-62551-CË-RFB.
Kanë shprehur interes për këtë procedurë 7 operatorë ekonomik.
Në minutat e hapjes së tenderit me objekt ñRehabilitimi I infrastrukturës dhe restaurimi I kalldrëmeve në pazarin e Gjirokastrësò nënshkruar nga KVO E. Q., D. M.dhe E. O..

Kompania	Oferta	Siguria e ofertës
JV ñR...ò & ñA.ò shpk	143,648,281 ALL	2,400,000 ALL
JVñL....ò shpk & ñH.ò shpk	137,778,274 ALL	2,400,000 ALL
JV ñS.ò shpk & ñJ.ò shpk & ñE...C.ò	133,005,420 ALL	2,400,000 ALL

Më datë 26.07.2018 pas vlerësimit të ofertave është njoftuar përfaqësuesja e Bankës Botërore për ofertën fituese nga JV ñL...ò shpk & ñH...ò shpk me ofertë 137,778,275 Lekë.
Më datë 16.08.2018 është dërguar Letra e pranimit për operatorin fitues JV ñL. K.ò shpk & ñH.ò shpk me ofertë 137,778,275 Lekë.
Nga auditimi i vlerësimit të ofertave nuk u konstatuan problematika.

2-Procedura e prokurimit, "Rehabilitimi I shkallareve Sarandë"

Në datë 13.07.2017 është iniciuar kërkesa për prokurim për punë publike ñRehabilitimi I shkallareve Sarandëò nga Z. E. Q., Menaxher I Projektit të Zhvillimit të Integruar Urban dhe Turizmit drejtuar Njësisë Juridike dhe Prokurimit.
Më datë 19.07.2017 procedura ADF-15534-CË-RFB është publikuar në faqen zyrtare të FSHZH pë ftesën për ofertë brenda datës 30.08.2017 ora 11:00am.
Më datë 19.07.2017 është publikuar në mediat e shkruara.
Më datë 24.07.2017 është publikuar në fletoren zyrtare.
Në datë 17.07.2017 me urdhrin nr. 12 drejtori ekzekutiv I institucionit ka nxjerrë urdhrin për përcaktimin e kritereve teknike për procedurën e mësipërme të përbërë nga P. M., L.M.dhe E. Z. me fond limit 88,923,157 lekë.
Në datë 19.07.2017 grupi I krijuar ka paraqitur relacionin me kriteret teknike referuar urdhërit nr. 12 drejtori ekzekutiv I institucionit ka nxjerrë urdhrin e prokurimit për procedurën e mësipërme me fond limit 88,923,157 lekë.
Në datë 19.07.2017 me urdhrin nr. 12/1 drejtori ekzekutiv I institucionit ka nxjerrë urdhërin e prokurimit me fond limit 88,923,157 lekë.
Më 26.01.2018 janë hartuar dokumentet e tenderit ñRehabilitimi I shkallareve Sarandëò.
Kanë shprehur interes për këtë procedure 10 kompani.
Nga sqarimet e kërkuara nga kompanitë e interesuara është hartuar amendimi nr. 1 i kontratës në lidhje me mjetet e kërkuara.
Në minutat e hapjes së tenderit me objekt ñRehabilitimi I shkallareve Sarandëò nga komisioni I vlerësimit të ofertave E. Q., D. M. dhe E. O. u renditën firmat pjesëmarrëse.

Kompania	Oferta	Siguria e ofertës
JV ñA.ò e ñGj.ò	103,063,151 ALL	2,000,000 ALL
ñA.ò shpk	95,187,886 ALL	2,000,000 ALL
XH.&M.	98,259,548 ALL	2,000,000 ALL

Më 18.10.2017 është hartuar raporti I vlerësimit për procedurën ñRehabilitimi ishkallareve Sarandëò, ku është vlerësuar me ofertën më të mirë ñA.ò shpk me vlerë 79,323,238 lekë pa TVSH si oferta më e ulët e cila plotëson të gjitha kriteret teknik.
Më 23.10.2017 nga ish drejtori ekzekutiv është hartuar letra e pranimit drejtuar kompanisë ñA...ò shpk si fitues i kontratës AL-ADF-15534-CË-RFB me vlerë 95,390,574 lekë me tvsh.

3-Procedura e prokurimit, Projektim dhe super vizim i kontratës së konsulencës Rehabilitimi i qytetit të Gjirokastrës"

Në datë 07.12.2017 ka ardhur përgjigjja nëpërmjet postës elektronike No-Objection për procedurën e prokurimit nga Banka Botërore.
Më datë 07.12.2017 është hartuar kërkesa për shprehje interesi për shërbimin e konsulencës për procedurën AL-ADF-39736-CS-QCBS.
Në datë 07.12.2017 nga ish-drejtori ekzekutiv i FSHZH Z. B. B. është nxjerrë urdhri i prokurimit nr. 18 për konsulencën ñKonceptim, përmirësim dhe projektim i detajuar për bashkinë Gjirokastërò me fond limit 80,368,335 lek.
Në datë 18.12.2017 është bërë publikimi në fletoren zyrtare buletini nr. 40si dhe në median e shkruar kombëtare datë 19.12.2017. Gjithashtu është publikuar njoftimi faqen zyrtare të FSHZH.

Në datë 26.01.2018 është hartuar raporti i vlerësimit për kompanitë të cilat kanë shprehur interes për pjesëmarrje në procedurë nga komisioni I vlerësimit I përbërë nga Z. E. Q. Menaxher projekti, Z. D. M. Asistent dhe Zj. E. B. Arkitekte. Për 16 kompani që kanë shprehur interes për pjesëmarrje në procedurën e prokurimit është kryer dhe vlerësimi me pikë ku 6 vendet e para i mbajnë kompanitë si më poshtë:

1. JV. I. IGH d.d & U. P. I. of C. (UH) d.o.o &T., bashkëpunim Kroaci-Shqipëri me 97 pikë
2. A. ñA. s.r.lò & IP3 &D&C P.& M. M.& S. B. A. I./A./I. 95.33 pikë
3. JV A. P. spa & 3T. P. spa & C. H.W. B. A. I./S. 94.33 pikë
4. C. A.& F. A.& S. B&L & iC C.& D. S./S./S. 93.00 pikë
5. A. ñA. 4ò & K., bashkëpunim S.-I. me 92.33 pikë
6. A. C. E. sa & L. P. E. C. S. G./S. 90.40 pikë

Në 16.03.2018 janë ftuar 6 kompanitë e përzgjedhura nëpërmjet postës elektronike për të paraqitur ofertën e tyre financiare dhe specifikimet teknike deri në datë 17.04.2018 ora 11.00 am
Më 16.03.2018 janë hartuar specifikimet teknike kerksa për propozim që procedurën AL-ADF-39736-CS-QCBS.
Në datë 13.06.2018 është kryer vlerësimi teknik për çdo kompani të paraqitur në 1 raport.

Kompania	Pikët në raportin teknik
A. ñA. s.r.lò & I.&D&C P.& M. M.& S. B. A.	96.59
JV A. P. spa & 3. P. spa & C. H.W. B.	90.84
JV. I. I. d.d & U. P. I. of C.a (UH) d.o.o &T.,	86.10
C. A.& F. A.& S. B&L & iC C.& D.	78.57
A. C. E. sa & L. P. E. C. S.	72.88

Më pas është dërguar me e-mail njoftimi ndaj kompanive të përzgjedhura se pasi janë klasifikuar për specifikimet teknike mund të paraqesin ofertën e tyre financiare në datë 18.06.2018 në orën 12.00 am
Në datë 18.06.2018 është mbajtur procesverbali për hapjen e propozimeve financiarepër konsulencën ku secila kompani ka paraqitur ofertën e saj pa tvsh si më poshtë:

Kompania	Çmimi pa tvsh
A. ñA. s.r.lò & I.&D&C P.& M. M.& S. B. A.	845,815 euro
JV A. P. spa & 3. P. spa & C. H.W. B.	656,800 euro
JV. I. I. d.d & U. P. I. of C. (UH) d.o.o &T.,	404,206 euro
C. A.& F. A.& S. B&L & iC C.& D.	846,363 euro

Nga vlërësimi I kombinuar tekniko-financiar datë 25.06.2018 është bërë renditja e mëposhtmee pikëve finale:

Kompania	Vlerësimi final I pikëve
JV. I. I. d.d & U. P. I. of C. (UH) d.o.o &T.,	87.4
A. ñA. s.r.lò & I.&D&C P.& M..& S. B. A.	86.82
JV A. P. spa & 3. P. spa & C. H.W. B.	84.97
C. A.& F. A.& S. B&L & iC C.& D.	72.4

Me urdhrin e brendshëm nr 18/1 datë 04.07.2018 të drejtorit ekzekutiv të FSHZH Z. B. B. është urdhëruar fillimi i negocimit për kontratën e konsulencës.

Në datë 18.06.2018 kompania JV. I. I. d.d & U. P. I. of C.a (UH) d.o.o &T., ka dërguar përfaqësuesin e saj për lidhjen e kontratës
Në datë 16.07.2018 është mbajtur Minuta e Negocimit nr 01 mes Klientit dhe Kontraktuesit
Në datë 01.08.2018 Klienti ka dërguar kontratën e bashkëpunimit dhe prokurën e përfaqësimit të shoqërisë Kroate I IGHnga shoqëria shqiptare T shpk.
Pas negocimeve nga ana e JV. I I d.d & U. P. I. of C. (UH) d.o.o &T., është kërkuar ndryshimi I udhëheqësit të projektit.
Me 10.05.2019 nga ana e ish/drejtorit të projektit E. Q. dhe D. M. është konfirmuar zëvendësimi e udhëheqësit të projektit.
Më 13.05.2019 nga drejtori ekzekutiv z.D. A. është kryer amendimi i kontratës për zëvendësimin e udhëheqësit të projektit.
Me shkresën 150/4 datë 15.05.2019 drejtori ekzekutiv 2 dit pas nënshkrimit të amendimit të kontratës ka njoftuar konsulentin për ndërprerjen e kontratës
Më date 23.08.2019 janë zhvilluar minutat e takimit për problematikën e krijuar dhe pas diskutimeve dhe korrespondencave dhe me postë elektronike me mirëkuptim mes palëve kontrata u prish.
Me shkresën 1432 datë 04.10.2019 drejtori ekzekutiv ka njoftuar konsulentinpër përfundimin e kontratës.
-Praktikisht nga lidhje e kontratës Konsulenti sipas planit të punës (TOR pika 62) të hartuar nga njësia e projektit miratuar nga Banka njohur nga konsulenti dhe pranuar nga ky i fundit në momentin e lidhjes së kontratës, e ngarkon me detyrë për përgatitjen e detyrës 1 brenda 30 ditëve se bashku me komentet e bankës.
Pra konsulenti ka për detyrë të respektoj planin e punës dhe afatet përkatëse në vijim të tyre janë dhe parashikimet e tjera në kontratë kushte e përgjithshme **GCpika 19 Përfundimi** ku në pikën **19.1.1** (a)***citohet që kontrata mund të ndërpritet nëse konsulenti dështon në kryerjen e detyrave të tij.***
<u>Pra jemi në kushtet e mos plotësimit të detyrave.</u>
Nga auditimit iprocedurës ajo është konform manualeve tëbankës botërore për konsulentin por zgjatje e saj dhe mos njoftimi në kohë për ndërprerjen e kontratës nisur nga fakti se ajo është lidhur më 30.09.2018 pra konsulenti ka patur afatin e nevojshëm për përgatitjen dhe kryerjen e detyrave sipas TOR termave të references pika 62 Plani I punës ku për detyrën 1 konsulenti ka 1 muaj afat për pregatitje komente dhe miratim.
Në reference të pikave 14 përfundimi I kontratës nënpika **14.1** ku I referohet kushteve të përgjithshme **pika 19** Përfundimi kun ë pikën **19.1.1** (a)citohet që kontrata mund të ndërpritet në konsulenti dështon në kryerjen e detyrave të tij. Sipas **pikës 18 të GCC** kushteve të përgjithshme kontraktori duhe të njoftoj me shkrim konsulentin dhe ti japë 1 muaj kohë për riparimin e problemeve të krijuara.
Pra nga nënshkrimi I kontratës më 20.09.2018 kanë kaluar plot 8 muaj kalendarik dhe nga konsulenti nuk është paraqitur asnjë nga detyrat duke rriskuar realizimin e projektit në kohë dhe shtuar kostot e projektit për FSHZH dhe Shtetin Shqiptar.
Lënia e konsulentit për një kohë kaq të gjatë prej 8 muaj pa bërë njoftimet përkatëse madje 2 ditë para njoftimit për pezullim I pranohet amendimi I kontratës ndaj këtij operatori duke vënë në vështirësi realizimin e plotë të projektit.

Njoftimi me vonesë për ndërprerje kontrate duke mos respektuar kushtet e kontratës ngarkon me përgjegjësi drejtorin e projekti z.A. A. dhe drejtorin ekzekutiv z. D. A..
2 dit pas nënshkrimit të amendimit të kontratës ka njoftuar konsulentin për ndërprerjen e kontratës

2. Titulli i Gjetjes: Vonesa në zbatimin e kontratës
Situate: Nga auditimi i zbatimit të kontratës së konsulentit ñProjektim dhe super vizim I kontratës së konsulencës Rehabilitimi I qytetit të Gjirokastrësò u konstatua se kjo kontratë ka dështuar por njoftimi për prishje kontrate është kryer pas 8 muajsh dhe prishja e kontratës pas 10 muajsh, duke sjellë vonesa në realizimin e procedurës projektim dhe supervizim e më tej dhe zbatimin e projekteve që do miratohen.
Kriteri: Dokumentetstandarde të tenderit Termat e Referencës (TOR) pika 62 Plani I punës ku për detyrën 1 konsulenti ka 1 muaj afat për pregatitje e saj sëbashku me komentet dhe miratimin.
Në reference të pikave 14 përfundimi I kontratës nënpika **14.1** ku I referohet kushteve të përgjithshme **pika 19** Përfundimi ku në pikën **19.1.1** (a)citohet që kontrata mund të ndërpritet nëse ***konsulenti dështon në kryerjen e detyrave të tij***. Sipas **pikes 18 të GCC** kushteve të përgjithshme kontraktori duhet të njoftoj me shkrim konsulentin dhe ti japë 1 muaj kohë për riparimin e problemeve të krijuara.
Ndikimi/Efekti:Vonesë në implementimin e plotë të projektit pasi nëse nuk ecin me fazën e projektimit faza e zbatimit nuk mund të kryhet.
Rëndësia: E mesme.

Rekomandimi: Drejtorii projektit në të ardhmen të informoj për situata të ngjashme huadhënësin për dhënien e një zgjidhje sa më të shpejt në kohë me qëllim eleminimin e vonesave të tjera.

4-Procedura e prokurimit, "Rehabilitimi I shëtitores Sarandë"
Në datë 24.05.2019 është iniciuar kërkesa për prokurim për punë publike ñRehabilitimi I shkallareve Sarandëò nga D. M. nga Z. E. Q., Menaxher I Projektit të Zhvillimit të Integruar Urban dhe Turizmit drejtuar Njësisë Juridike dhe Prokurimit.
Më date 29.05.2019 procedura AL-ADF-15536-CË-RFB është publikuar në faqen zyrtare të FSHZH pë ftesën për ofertë brenda datës 10.07.2019 ora 10:00am.
Me date 29.05.2019 është publikuar në mediat e shkruara.
Në date 27.05.2019 me urdhrin nr. 5 drejtori ekzekutiv I institucionit ka nxjerrë urdhrin për përcaktimin e kritereve teknike për procedure e mësipërme të përbërë nga P. M., D. Th. dhe E. Z. me fond limit 592,120,310 lekë.
Në date 28.05.2019 grupi I krijuar ka paraqitur relacionin me kriteret teknike referuar urdhrit nr. 5 drejtori ekzekutiv I institucionit ka nxjerrë urdhrin e prokurimit për procedure e mësipërme me fond limit 592,120,310 lekë.
Në date 28.05.2019 me urdhrin nr. 5/1 drejtori ekzekutiv I institucionit ka nxjerrë urdhrin prokurimin me fond limit 592,120,310 lekë.
Më 29.05.2018 janë hartuar dokumentet e tenderit ñRehabilitimi I shëtitore Sarandëò.
Kanë shprehur interes për këtë procedure 17 kompani.

Në minutat e hapjes së tenderit me objekt ñRehabilitimi I shëtitores Sarandëò nga komisioni I vlerësimit të ofertave E. Q., D. M. dhe L. M. u renditën firmat pjesëmarrëse.

Kompania	oferta	Siguria e ofertës
ñ ñG.ò shpk	467,518,427 ALL	60,000 euro
ñA.ò shpk	450,481,711 ALL	60,000 euro
ñF.ò shpk	562,548,828 ALL	60,000 euro

Më 07.08.2019 është hartuar raporti I vlerësimit për procedure ñRehabilitimi I shëtitores Sarandëò, ku është vlerësuar me ofertën e vetme të sukseshme në aspktin e plotësimit të specifikimeve teknike operatori ekonimik ñF.ò shpk me vlerë 565,978,563 lekë me TVSH pas korigjimit të gabimeve në kalkulime. Do ofertat e tjera janë skualifkuar për punë të ngjashme në 3 vitet e fundit si dhe për zera punimesh të kyera më pare të cilat sipas raportit të vlerësimit nuk i dispononinn

Më date 07.08.2019 është bërë njoftimi I shpalljes fituesit në faqen zyrtare të FSHZH.

Nga operatori ekonomik A. shpk është depozituar një ankesë nr, 46 prot date 15.08.2019 për vlerësimin e ofertës së tij dhe duke shfaqur kundërshtimet e tij në pretendimet e KVO.

Nga verifikimi I dokumentacionit teknik të operatorit ekonomik A. shpk dhe pretendimeve të tij në ankesë pretendime që në pjesën dërmuese qëndrojnë dhe ndryshojnë rrjedhën e ngjarjeve dhe vlerësimit duke zbutur kostot e kësaj procedure madje duke e bërë dhe me efektive këtë procedure. Nisur nga ofertaofruar nga operatori fitues sipas KVO krahasuar atë me dy ofertat e tjara ajo është dukshëm me e lartë nga ofertat e tjera, por me mangësi në dokumentacionin e ofruar e për rrjedhojë nuk mund të kualifikoheshin.

Parimi I ekonomiciteti për këtë procedure është I pa përfillshim, edhe pse nga ana e shoqërisë ñA.ò shpk e cila ka hartuar dhe ankesë ka patur disa mangësi në Termat e referencës.

Në përgjigje të ankesë nga drejtori ekzekutiv është kthyer përgjigje me shkresën 1211/1 prot date 28.08.2019, nga ku janë rrëzuar pretendimet e ankuesit.

Më 29.08.2019 nga drejtori ekzekutiv është hartuar letra e pranimit drejtuar komoanisë ñF.ò shpk si fitues I kontratës AL-ADF-15536-CË-RFB me vlerë 570,335,643 lekë me tvsh.

5-Procedura e prokurimit, Projektim dhe super vizim i kontratës së konsulencës Rehabilitimi I qyteteve Berat dhe Permet"

Në datë 25.09.2017 është inicuar kërkesa për prokurim për konsulencën ñKonceptim, përmirësim dhe projektim I detajuar për bashkitë Berat dhe Përmetò nga Z. E. Q., Menaxher I Projektit të Zhvillimit të Integruar Urban dhe Turizmit drejtuar Njësisë Juridike dhe Prokurimit.

Në datë 26.09.2017 ka ardhur përgjigja nëpërmjet postës elektronike No-Objection për termat e referencës nga përfaqësuesja e Bankës Botërore Zj. P. R. C. në lidhje me procedurën e prokurimit Numër reference AL-ADF-15555-CS-QCBS

Në datë 05.10.2017 është hartuar shkresa për shprehjen e interesit

Në datë 09.10.2017 është bërë publikimi në fletoren zyrtare buletini nr. 32si dhe në median e shkruar kombëtare datë 05.10.2017. Gjithashtu është publikuar njoftimi në datë 04.10.2017 faqen online të UN Development Business (UNDB).

Në datë 26.09.2017 nga drejtori ekzekutiv i FSHZH Z. B. B. është nxjerrë urdhri i prokurimit nr. 13 për konsulencën ñKonceptim, përmirësim dhe projektim I detajuar për bashkitë Berat dhe Përmetò me fond limit 1,193,253 Euro

Nga data 17.07.2017 deri në datën 26.01.2018 ka komunikim me postë elektronike midis Menaxherit të projektit Z.E. Q. dhe përfaqësueses së Bankës Botërore Zj. P. R. C. në lidhje me përmirësimin e termave të referencës së procedurës së prokurimit për konsulencën ñKonceptim, përmirësim dhe projektim I detajuar për bashkitë Berat dhe Përmetò me numër reference AL-ADF-15555-CS-QCBS

Në datë 26.01.2018 është hartuar raporti i vlerësimit për kompanitë të cilat kanë shprehur interes për pjesëmarrje në procedure nga komisioni I vlerësimit I përbërë nga Z. E. Q. Menaxher projekti, Z. D. M. Asistent dhe Zj. E. B. Arkitekte. Për 29 kompani që kanë shprehur interes për pjesëmarrje në procedurën e prokurimit është kryer dhe vlerësimi me pikë ku 6 vendet e para i mbajnë kompanitë si më poshtë:

1.JV. I. I. d.d & U. P. I. of C. (UH) d.o.o &T., bashkëpunim Kroaci-Shqipëri me 100 pikë
2.A. ñA.ò & K., bashkëpunim Shqipëri-Itali me 98 pikë
3.JV. Th. P.s and A. S.A (TPA) ñ & ñA. ñ ltd & ñE.-Gò ltd, bashkëpunim Greqi-Shqipëri me 97.7 pikë
4.JV. ñA. A. A.ò & ñ M.ò ltd, bashkëpunim Itali-Shqipëri me 97.43 pikë
5.JV. ñ A. V.ò & ñ S. C.ò & ñD. S.ò ltd, bashkëpunim Francë-Shqipëri me 97.4 pikë
6.JV. ñO. P. C.ò s.r.l & ñP.ò s.r.l. & ñI. C. E. (I.)ò Ltd, bashkëpunim Italy-Shqipëri me 94.86 pikë.

Në 31.01.2018 janë ftuar 6 kompanitë e përzgjedhura nëpërmjet postës elektronike për të paraqitur ofertën e tyre financiare dhe specifikimet teknike deri në datë 01.03.2018 ora 11.00 am

Në datë 13.02.2018 dy kompanitë A.dhe A. V. klasifikuar në vendin 2 dhe 5 me pikë kanë dërguar me postë elektronike një sërë pyëtjesh në lidhje me paqartësinë që kanë mbi terma të procedurës së prokurimit, për të cilat Z. A. Z. specialist prokurimi ka kthyer përgjigje dhe ka dërguar email ndaj 6 kompanive të klasifikuara dhe të ftuara për të marrë pjesë dhe për të paraqitur ofertën e tyre.

Në datë 01.03.2018 është mbajtur proces verbali për marrjen në dorëzim të propozimeve financiare dhe teknike nga 6 kompanitë e përzgjedhura.

Në datë 30.04.2018 është kryer vlerësimi teknik për cdo kompani të paraqitur në 1 raport.

Kompania	Pikët në raportin teknik
JV. I. I. d.d & U. P. I. of C. (UH) d.o.o &T.,	88.91
A.ñA.ò & K.	94.28
JV. Th. P. and A. S.A (TPA) ñ & ñA. ñ ltd & ñE.ò ltd	86.10
JV. ñA. A. A.ò & ñ M.ò ltd	83.12
JV. ñ A. V.ò & ñ S.C.ò & ñD. S.ò ltd	75.47
JV. ñO. P. C.ò s.r.l & ñP.ò s.r.l. & ñI. C. E. (ICE)ò Ltd	83.16

Më pas është dërguar me e-mail njoftimi ndaj kompanive të përzgjedhura se pasi janë klasifikuar për specifikimet teknike mund të paraqesin ofertën e tyre financiare në datë 04.05.2018 në orën 11.00 am

Kompanitë e kualifikuara në shortlist kanë dërguar përfaqësuesit e tyre për të paraqitur ofertën ekonomike në datë 03-04.05.2018. Në datë 04.05.2018 është mbajtur procesverbali për hapjen e

propozimeve financiarepër konsulencën ku secila kompani ka paraqitur ofertën e saj pa tvsh si më poshtë

Kompania	Shuma e ofruar pa TVSH
JV. I. I. d.d & U. P. I. of C. (UH) d.o.o &T.,	766,380 Euro
A. ñA.ò & K.	950,435 Euro
JV. Th. P. and A. S.A (TPA) ñ & ñA. ñ ltd & ñE.ò ltd	906,425 USD 400,200 USD
JV. ñA. A. A.ò & ñ M.ò ltd	958,333Euro
JV. ñ A. V.ò & ñ S. C.ò & ñD. S.ò ltd	986,286.57 Euro
JV. ñO. P. C.ò s.r.l & ñP.ò s.r.l. & ñI. C. E. (ICE)ò Ltd	541,050 Euro 619,100 Euro

Nga vlërësimi I kombinuar tekniko-financiar datë 08.05.2018 është bërë renditja e mëposhtmee pikëve finale:

Kompania	Pikët finale
A. ñA.ò & K.	91.55
JV. I. I. d.d & U. P. I. of C. (UH) d.o.o &T.,	91.13
JV. Th. P. and A. S.A (TPA) ñ & ñA. ñ ltd & ñE.ò ltd	83.15
JV. ñO. P. C.ò s.r.l & ñP.ò s.r.l. & ñI. C. E. (ICE)ò Ltd	79.74
JV. ñA. A. A.ò & ñ M.ò ltd	82.49
JV. ñ A. V.ò & ñ S. C.ò & ñD. S.ò ltd	75.90

Në datë 09.05.2018 është njoftuar fituesi për vendin e parë dhe ftohet për të lidhur kontratën në datë 14.05.2018 ora 13.00
Me urdhrin e brendshëm nr 13/1 datë 09.05.2018 të drejtorit ekzekutiv të FSHZH Z. B. B. është urdhëruar fillimi I negocimit për kontratën e konsulencës
Në datë 14.05.2018 kompania A.& K. Srl ka dërguar përfaqësuesin e saj për lidhjen e kontratës
Në datë 15.05.2018 është mbajtur Minuta e Negociimit nr 01mes Klientit dhe Kontraktuesit
Në datë 16.05.2015 Klienti ka dërguar kontratën e bashkëpunimit dhe prokurën e përfaqësimit të shoqërisë italiane K. Srl nga shoqëria shqiptare A.
Në datë 25.05.2018 është lidhur kontrata me fituesin
-Nga auditimi i dosjes teknike te operatorit ekonomik JV "A.& K. Srl" u konstatua se:
për sa i përketanëtareve të stafit pozicioni K-4 Arkitekt peisazhi konstatohet se per stafin e Kompanisë JV Kroato/Shqiptare nga KVO shprehet ñNuk ka pershkrim të punës së kryer apo drejtuar nga ekspertiò në shikojmë Cv e ekspertit pershkruhet shumë mirë cka ka bër madje përshkrimi është tejt i ngjashëm me ofertuesin fitues: psh: ñ*Landscape design and imputs*ò fituesi dhe ñ*Main detailed landscape design*ò.Në vlerësim ofertuesi i renditur i dyti cilësohet si me dobësi në përshkrimin e punës ndërkohë që për fituesin KVO nuk ka shprehur dobësi.
-Gjithashtu per dy key - staf të kerkuar dhe të paraqitur nga K. nuk ka të paraqitur ndonjë marveshje mes palëve nisur nga fakti se që janë ekspert jo të kompanisë K. por bashkëpunojnë mes tyre.

3.Në përgjigje të observacionit të datës 19.08.2020 protokolluar në KLSH me nr. 325/7 datë 20.08.2020 , për raportin e auditimit, në lidhje me zbatimin e kritereve dhe procedurave të përcaktuara sipas rastit në marrëveshje me huadhënësin ose ligjvënësin shqiptar, për realizimin e prokurimeve për ndërtime, mallra e shërbime deri në lidhjen e kontratës, ju sqarojmë si më poshtë vijon

Ne lidhje me gjetjen 8, të Projekt raportit-Së pari, nuk keni sjellë asnjë dokumentacion justifikues bashkangjkangjitur, si emailet apo komunikimet mes palëve për të justifikuar vonesat e konsulentit.

-Së dyti, koha e lënë në dispozicion të konsulentit deri në prishjen e kontrtatës e cila ka ndodhur më 23.08.2019 (pas 10 muajsh) për ndreqjen e gabime është tejet e gjatë komunikimin apo diskutimet në VCmund ti kishit iniciuar dhe më parë në këto afati Termat e referencës plani i punës për ju nuk vlen fare.

*-Së treti, në paragrafin 9 të faqes 3shpreheni se kjo marrëveshje e huasë do të prokurohen në përputhje me kërkesat e vendosura ose që i referohen seksionit I dhe VI të udhëzuesimeve të konsulencës... pra sic e citoni dhe vet këto procedura i nënshtrohen Udhëzuesit të bankës botrore ku në pikë 2.3 Termat e referencës (TOR) shprehet se "Huamarrësi do të jetë përgjegjës për përgatitjen e TOR...*Në termat e referencës do të renditen shërbimet dhe sondazhet e nevojshme për të kryer detyrën e ngarkuar dhe rezultatet e pritura (për shembull, raportet, të dhënat, hartat, anketat, etj.). pra termat e references janë thelbësore në procedura për tu respektuar dhe nga konsulenti kun ë rastin konkret *pika 62 e TOR "Plani I punës" ku për detyrën 1* ***konsulenti ka 1 muaj afat për përgatitje komente dhe miratim,*** *në rastin konkret nuk është zbatuar madje as për 8 muaj ky task apo detyrë nuk është realizuar.*

Pika E: Hartimi, zbatimi i kontratave deri në marrjen në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve dhe zbatimit i kontratave të punëve publike, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e punimeve.

Në zbatim të Projektit të Auditimit, pika E: E.1 dhe E.2, mbi zbatimin e kontratave për punime civile, mallra e shërbime, në Fondin Shqiptar të Zhvillimit (në vijim, ñFSHZHò, u analizuan regjistrat e investimeve të kontratave për punë publike, të përfunduara dhe atyre në proçes për periudhën e auditimit.

Sa më sipër, për periudhën e auditimit nga fillimi i projektit 2017 dhe deri 19.06.2020, nga audituesit e KLSH-së u përzgjodhën për tôu audituar investimet për 5(pesë) kontrata zbatimi pasqyruar në tabelën nr.1, në shumën 681,307,993 lekë me TVSH, respektivisht:

- për vitin 2017, 1 (një) kontratë me vlerë 90,846,945 lekë me TVSH.
- për vitin 2018, 3(tre) kontrata me vlerë 290,500,345 lekë me TVSH.
- për vitin 2019, një kontratë në proces pune, me vlerë 299,960,703 lekë me TVSH.

Tabela nr.1.

Nr	Objekti	Kontraktori	Vlera e kontratës lekë me TVSH
1	2	3	5
	Viti 2017 (Punë publike)		
1	Saranda Staircase Rehabilitation Project	A. SHPK	90,846,945
	Viti 2018 (punë publike)		

1	Rehabilitation of Cobblestone Road ñMihal Komnenoò to Berat Castle	S. SHPK	148,120,404
2	Bazaar cobble stone roads rehabilitation, to Gjirokastër Castle	JV L. K.& H. SHPK	137,778,274
3	Street lighting ï Permet	JV H.&B. SHPK	4,601,667
	Viti 2019		
1	Rehabilitim i rrugës së automjeteve ñMozak Topiaò në kalanë e Beratit	E. SHPK	299,960,703
	Shuma në lekë me TVSH		**681,307,993**

Mangësitë e konstatuara nga auditimi i këtyre procedurave paraqitet si vijon:

1. Zbatimi i punimeve të ndërtimit për kontratën "<u>Rehabilitim i shkallareve të Sarandës</u>" në Bashkinë Sarandë.

<u>Zbatimi i punimeve.</u>

-Punimet për objektin e mësipërmkanë filluar me datë 17.01.2018 dhe kanë përfunduar me datë 29.12.2018.

Projekt-preventivi ka ndryshuar, si vijon:

- Urdhër ndryshimi Nr. 1, datë 27.06.2018, me objekt: Shtyrjen e afatit të punimeve pas propozimit të kontraktorit e Bashkisë Sarandë dhe të paraqitur nga supervizori për problematikat e hasura gjatë zbatimit të punimeve. Bazuar në pikat 27.1 dhe 27.2 të KPK, përfundimi i punimeve shtyhet me 153 ditë kalendarike dhe data e përfundimit të punimeve nga 30.06.2018 do të bëhet 30.11.2018.
- Urdhër ndryshimi Nr. 2, datë 30.06.2018 me objekt: Mbi ndryshimet në volumet e punimeve sipas propozimeve të kontraktorit e Bashkisë Sarandë dhe të paraqitura nga supevizori për përmirësime në sasi dhe cilësi të projekt-preventivit të miratuar pas ballafaqimit me terrenin si dhe për miratimin e çmimeve të zërave të rinj të punimeve. Vlera e kontratës pas rishikimit të preventivit është 95,390,370.34 lekë me TVSH.
- Urdhër ndryshimi Nr. 3, datë 23.11.2018 me objekt: Mbi shtyrjen e afatit të punimeve pas propozimit të kontraktorit dhe të paraqitur nga supervizori për problematikat e hasura gjatë zbatimit të punimeve. Bazuar në pikat 27.1 dhe 27.2 të KPK, përfundimi i punimeve shtyhet me 30 ditë kalendarike dhe data e përfundimit të punimeve nga 30.11.2018 do të bëhet 30.12.2018.
- Urdhër ndryshimi Nr. 4, datë 20.12.2018 me objekt: Mbi ndryshimet në volumet e punimeve sipas propozimeve të kontraktorit e Bashkisë Sarandë dhe të paraqitura nga supevizori pas ballafaqimit me volumet faktike të kryera si dhe për miratimin e çmimeve të zërave të rinj të punimeve. Vlera e kontratës pas rishikimit të preventivit nr. 1, është 90,846,945.29 lekë me TVSH., duke mos përfshirë volumet e fondit rezervë.

Në zbatim të projektit të auditimit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë (tabela nr. 2): Projekt i zbatimit, preventivit bazë dhe i ndryshuar me VO Nr.1, VO Nr.2, VO Nr.3 dhe VO Nr.4, Situacionet pjesore dhe Situacioni përfundimtar, Libreza e masave, Ditarit të punimeve, grafiku i punimeve, etj.

13. Zbatimi i Kontratës së Punimeve "Rehabilitim i shkallareve të Sarandës ".		
14.Lidhja e kontratës Ref. No. AL-ADF-15534-CW-RFB, datë 15.12.2017	**15.Vlera e kontratës:** Kontrata bazë; **95,187,882** lekë me tvsh OE fitues ñA.ò SHPK	**16.Likuiduar:** -Paradhënie, dhjetor, në shumën 9,539,057.43 lekë me TVSH - IPC1, mars 2018, në shumën 11,881,370.45

		lekë me TVSH -IPC2, 21.03.2018-03.05.2018 në shumën 14,151,462.97 lekë me TVSH -IPC3, 04.05.2018-03.07.2018 në shumën 6,789,916.01 lekë me TVSH -IPC4, 20.09.2018-30.10.2018, në shumën 11,757,108.22 lekë. - IPC5, 30.10.2018-31.12.2018, në shumën 28,060,380.21 lekë me TVSH.
17- Situacioni Përfundimtar: Situacioni perfundimtar me vlerë 90,846,945.29 lekë me TVSH.	**18.Afati i kontratës në ditë:** Fillimi punimeve: 17.01.2018 Perfundimi punimeve: 29.12.2018 (neni 53.1 i kontratës, lëshohet çertifikatë e përfundimit të punimeve).	**19. Zgjatja e kontratës:** - 135 dite sipas V.O nr.1 - 030 ditë sipas V.O n.3
20. Mbikëqyrësi i punimeve Znj. E. Ç.	Licenca nr. MK.**1476/8**	Kontrata nr. AL-ADF-37532-CS-CQS, datë 20.12.2017.
21. Kolaudatori i punimeve -	Licenca Nr: -	Kontrata me nr. - prot., datë ----
22.Akt Kolaudimi Datë -------	**23.Akt i marrjes në dorëzi:** Datë: 22.02.2019 (certifikate e marrjes në dorëzim paraprake)	

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

Lidhur me rekomandimin nr. 10 dhe nr. 11 të bërë nga KLSh në projekt raportin e auditimit, nga FSHZH janë paraqitur observacionet: nr. 690/16, datë 06.07.2020 të mbikëqyrësit të punimeve OE ñA.& E. E.ò SHPK përfaqësuar nga Znj. E. Ç., mbi Akt-Konstatimin Nr. 3, datë 30.06.2020, të mbajtur nga grupi i auditimit të KLSH-së, si dhe observacioni me nr. 1841 prot, datë 18.08.2020 (protokolluar në FSHZH) nga shoqëria ñA.ò shpk protokolluar në KLSH (nr. Prot. 325/6, datë 06.08.2020 dhe nr. Prot. 325/7, datë 19.08.2020). Në zbatim në nenit 32, të Rregullores së Procedurave të Auditimit në Kontrollin e Lartë të Shtetit (miratuar me vendim të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit Nr. 107, datë 08.08.2017 ñ*Për miratimin e rregullores së procedurave të auditimit në kontrollin e lartë të shtetit*ò observacionet u trajtuan si vijon:

a-Argumente dhe komente nga subjekti i audituar u trajtua si vijon:

Observacioni i paraqitur nga Mbikëqyrësi i punimeve si dhe nga sipërmarrësi i punimeve shoqëria ñA.ò shpk është i njëjti observacion i paraqitur me datë 06.07.2020 me pretendimin për:

I- Diferenca në volume për punime ndërtimi.

1. zëri i punimeve ñGërmim shkëmbiò është bërë sipas projektit, por pas diskutimeve në objekt u vendos se nga ana estetike puseta të bëhej me llamarinë zingate.

2. zëri i punimeve ñshtresë betoni C 7/10ò, është realizuar për mbulimin e tubae PE të sistemit të vaditjes, e cila lidh pusetën kryesore të shpërndarjes me shkallaret, e cila shtrihet përgjatë bulevardit kryesor.

3. për zërin ñshtresë betoni C 20/25ò, konstatimi i grupit të auditimit qëndron, por duke parë se puseta prej betoni nuk qëndronte në harmoni me punët e tjera i kërkuam sipërmarrësit ta zëvendësonte me pusetë llamarine, e cila të jetë funksionale dhe praktike.

II. Mbi realizimin e Manualeve të Operimit dhe Mirëmbajtjes.

Shoqëria ñA.ò shpk nëpërmjet shkresës nr. Prot. 181, datë 18.08.2020, drejtuar FSHZH me lëndë ñManuali Përdorimi dhe Mirëmbajtjeò verteton hartimin dhe dërgimin e këtij manuali në subjektin FSHZH.

b-Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSh-së:
Grupi i auditimit pasi e lexoi me kujdes, nuk merr në konsideratë argumentet e pasqyruara në observacionin e mbikëqyrësit dhe të zbatuesit të punimeve me argumentet si vijon:
- ju pranoni faktin se keni zëvendësuar pusetën e betonit me pusetë me llamarinë, dhe për rrjedhojë nuk janë realizuar zërat e punimeve që i përkasin kësaj pusete.
- realizimi i pusetës me llamarinë është bërë në kundërshtim me kushtet e kontratës dhe madje nuk është trajtuar në asnjë urdhër ndryshimi, pra kemi të bëjmë me kryerje punime ndërtimi të pa miratuara nga mbikëqyrësi dhe AK dhe siç shpreheni nuk e keni miratuar si zë të ri.
- nga vështrimi në pusetën me llamarinë, nuk rezulton që tubat PE të jenë lidhur përgjatë kanalit që ju pretendoni se është mbuluar me beton C 7/10.
Sa më sipër trajtuar, punimet e kryera për zërat:
- ñGërmim shkëmbiò
- ñshtresë betoni C 7/10ò
- ñshtresë betoni C 20/25ò
nuk janë realizuar sipas projektit të zbatimit dhe nuk janë trajtuar me urdhër ndryshimi VO. Edhe pse kjo problematikë është sqaruar në përgjigjen e observacionit për akt konstatimin, përsëri Ju, nuk keni paraqitur argumente bindëse me VO. (Sa më sipër ngarkon me përgjegjësi, sipërmarrësin e punimeve, mbikëqyrësin e punimeve dhe AK për certifikimin e punimeve dhe likuidim të punimeve të pa miratuara me VO nga Autoriteti Kontraktor).

2. **Zbatimi i punimeve të ndërtimit për kontratën "<u>Rehabilitimi i rrugës hyrëse "Mihal Komneno" për në Kala dhe "Tabja"</u> në Bashkinë Berat.**

<u>Kontratat (Sipërmarrje dhe mbikëqyrjes së punimeve).</u>
Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës për punë publike me kod identifikimi: Nr. AL-ADF-28554-CE-RFB, datë 19.01.2018 të lidhur mes FSHZH, të përfaqësuar nga Titullari Z. B. B. dhe Operatorit Ekonomik (OE) ñS.ò SHPK, me licencë NZ. 3091/17 dhe drejtues ligjor Z. L. S.. Vlera e kontratës është 148,120,404 lekë me TVSH.
Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata me kod identifikimi: Nr. AL-ADF-37871-CS-CQS, datë 22.12.2017, ndërmjet Autoritetit Kontraktor, HSHZH, përfaqësuar nga Z. B. B. dhe shoqërisë ñT.ò SHPK përfaqësuar nga Znj. D. Q..
<u>Zbatimi i punimeve.</u>
Punimet për objektin e mësipërm, punimetkanë filluar me datë 12.03.2018 dhe kanë përfunduar me datë 27.11.2018.
Projekt preventivi ka pësuar ndryshimet si vijon:
<u>Urdhër ndryshimi Nr. 1</u>, datë 06.06.2018, me objekt: Mbi ndryshimet në volumet e punimeve, si rezultat i ndryshimeve të bëra për permirësimin e treguesve teknikë të objektit, në bazë të kerkesës së Kontraktorit, kërkesës së DRKK Berat si dhe Relacionit Teknik të supervizorit të punimeve. Mbas ndryshimeve në volumet e punimeve, vlera e kontratës ngelet e njëjtë 148,120,404 lekë me TVSH dhe, data e përfundimit të punimeve ngelet e pa ndryshuar 03.10.2018.
<u>Urdhër ndryshimi Nr. 2</u>, datë 28.09.2018, me objekt: Mbi ndryshimet në volumet e punimeve, si rezultat i ndryshimeve të bëra për permirësimin e treguesve teknikë të objektit, në bazë të kerkesës së Kontraktorit, kërkesës së DRKK Berat, kerkesës së Bashkisë Berat, UKT Berat si dhe Relacionit Teknik të supervizorit të punimeve. Mbas ndryshimeve në volumet e punimeve,

vlera e kontratës ngelet e njëjtë 148,120,404 lekë me TVSH dhe, data e përfundimit të punimeve ngelet e pa ndryshuar 03.10.2018.

Në zbatim të projektit të auditimit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë: Dokumentacioni teknik i zbatimit: Projekt i zbatimit, preventivit bazë dhe të ndryshuar, Situacionet pjesore dhe Situacioni përfundimtar, 4 urdhër ndryshimet, Libreza e masave, Ditarit të punimeve, grafiku i punimeve, etj.

13. Zbatimi i Kontratës së Punimeve Rehabilitimi i rrugës hyrëse "Mihal Komneno" për në Kala dhe "Tabja ".		
14.Lidhja e kontratës Ref. No. AL-ADF-15534-CW-RFB, datë 15.12.2017	**15.Vlera e kontratës:** Kontrata bazë; **95,187,882** lekë me tvsh OE fitues ñS.ò SHPK	**16.Likuiduar:** -Paradhënie, dhjetor, në shumën 9,539,057.43 lekë me TVSH - IPC1, mars 2018, në shumën 11,881,370.45 lekë me TVSH -IPC2, 21.03.2018-03.05.2018 në shumën 14,151,462.97 lekë me TVSH -IPC3, 04.05.2018-03.07.2018 në shumën 6,789,916.01 lekë me TVSH -IPC4, 20.09.2018-30.10.2018, në shumën 11,757,108.22 lekë. - IPC5, 30.10.2018-31.12.2018, në shumën 28,060,380.21 lekë me TVSH.
17- Situacioni Përfundimtar: Situacioni perfundimtar me vlerë 90,846,945.29 lekë me TVSH.	**18.Afati i kontratës në ditë:** Fillimi punimeve: 17.01.2018 Perfundimi punimeve: 29.12.2018 (neni 53.1 i kontratës, lëshohet çertifikatë e përfundimit të punimeve).	**19. Zgjatja e kontratës:** - 135 dite sipas V.O nr.1 - 030 ditë sipas V.O n.3
20. Mbikëqyrësi i punimeve Znj. E. Ç.	Licenca nr. MK.**1476/8**	Kontrata nr. AL-ADF-37532-CS-CQS, datë 20.12.2017.
21. Kolaudatori i punimeve -	Licenca Nr: -	Kontrata me nr. - prot., datë ----
22.Akt Kolaudimi Datë -------	**23.Akt i marrjes në dorëzi:** Datë: 22.02.2019 (certifikate e marrjes në dorëzim paraprake)	

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

Pika Panoramike Jugore e Kalasë së Beratit, Tabja.

Zëri i punimeve: 4.2.18. F.V Teleskop tek "Tabja".

Nga auditimi në objekt, u konstatua se teleskopi nuk ishte vendosur fare në kullën e vrojtimit të kalasë ñTabjaò. Sipas projekt-preventivit, dhe në zbatim të kushteve të kontratës së sipërmarrjes dhe specifikimeve teknike, duhej të ishte vendosur *Teleskopi* në kullën e vrojtimit të kalasë ñTabjaò.

Mos vendosja e teleskopit, ka shkaktuar:

- Mungesën e të ardhurave dytësore që i shkojnë shtetit nga ky shërbim
- Mos dhënie aksesi për vizitorët për të vrojtuar peisazhin e bukur që ofron qyteti i Beratit nga Kalaja ñTabjaò.

Pas vënies në dijeni të mbikëqyrësin e punimeve, mbi problematikën e konstatuar, sipërmarrësi i punimeve ka realizuar vendosjen e kësaj pajisje ñTeleskopò dhe kjo vertetohet me procesverbalin e mbajtur me datë 22/06/2020 (pra 8 ditë para përfundimit të auditimit). Proces-verbali është nënshkruar për Sipërmarrësin ñS.ò SHPK nga Z. E. K.; për Supervizorin nga Ing. A. B. dhe Znj. D. Q.; për ñDRKKò Berat nga Ing. E. Z. dhe për ñFSHZHò nga z. E. Z..

Megjithë se procesverbali është shoqëruar me fotografi, grupit të auditimit, nuk iû dha mundësia të shikonte anën funksionale si dhe specifikimet teknike të Teleskopit. KLSH, në vazhdim të auditimit të projektit ñZhvillimi i Integruar Urban dhe Turizmiò do tû lërë detyrë grupit të auditimit të ardhshëm, që verifikojë anën fuksionale si dhe specifikimet teknike të Teleskopit.

Shqyrtimi dhe vlerësimi i observacionit nr. 1767 prot, datë 07.08.2020 të shoqërisë ñS.ò shpk, përfaqësuar nga z. L. S., mbi projektraportin, në zbatim në nenit 32, të Rregullores së Procedurave të Auditimit në Kontrollin e Lartë të Shtetit (miratuar me vendim të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit Nr. 107, datë 08.08.2017 ñ*Për miratimin e rregullores së procedurave të auditimit në kontrollin e lartë të shtetit*ò është trajtuar si vijon:

a-Argumente dhe komente nga subjekti i audituar u trajtua si vijon:

Shoqëria ñS.ò shpk në cilësinë e sipërmarrësit të punimeve pretendon se, ka hartuar dhe dorëzuar në FSHZH Manualin e Mirëmbajtjes dhe Operimit, nzbatim të kontratës me nr. Al-ADF-28554-CE-RFB, datë 19.01.2018, referuar pikës KPK 56.1.

b-Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSh-së:

Shoqëria ñS.ò shpk nëpërmjet shkresës nr. Prot. 1767 prot, datë 06.08.2020, drejtuar FSHZH me lëndë ñDorëzim i Manualit të Mirëmbajtjes dhe Operimitò dhe manualit bashkëngjitur kësaj shkrese, verteton hartimin dhe dërgimin e këtij manuali në subjektin FSHZH. Lidhur me Manualin e Operimit dhe Mirëmbajtjes, grupi i auditimit merr në konsideratë observacionin dhe zbret shumën 2,962,408 lekë si penalitet sepse bashkëlidhur është paraqitur Manuali i Operimit dhe Mirëmbajtjes.

3. Zbatimi i punimeve të ndërtimit për kontratën "<u>Rehabilitimi i infrastrukturës dhe restaurimi i kalldrëmeve, në pazarin e Gjirokastrës</u>" në Bashkinë Gjirokastër.

<u>Kontratat (Sipërmarrje dhe mbikëqyrjes së punimeve).</u>

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës për punë publike me kod identifikimi: Nr. AL-ADF-62551-CW-RFB, datë 12.09.2018 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor, FSHZH, të përfaqësuar nga Titullari Z. B. B. dhe Bashkimit të Operatorëve Ekonomik (BOE) ñL. K.ò SHPK & ñH.ò SHPK, përfaqësuar nga OE ñL. K.ò SHPK me administrator Z. F. Sh.. Vlera e kontratës është 137,778,274.73 lekë me TVSH.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata me kod identifikimi: Nr. AL-ADF-37532-CS-CQS, datë 20.12.2017, ndërmjet Autoritetit Kontraktor, Fondit Shqiptar të Zhvillimit, përfaqësuar nga Z. B. B. dhe shoqërisë ñA.&E. E.ò SHPK përfaqësuar nga Znj. E. Ç..

<u>Zbatimi i punimeve.</u>

Punimet për nënobjektin e mësipërm, kanë filluar me datë 24.09.2018 dhe kanë përfunduar me datë 24.09.2019.

Projekt preventivi ka pësuar këto ndryshime:

<u>Urdhër ndryshimi Nr. 1</u>, datë 12.07.2019, me objekt: Mbi ndryshimet në volumet e punimeve, sipas propozimeve të Kontraktorit dhe diskutimeve me IMK të Paraqitura nga supervizori për përmirësime në sasi dhe cilësi të projekt-preventivit të miratuar, pas ballafaqimit me terrenin si dhe për miratimin e çmimeve të zërave të rinj të punimeve.

Mbas ndryshimeve në volumet e punimeve, vlera e kontratës ngelet 114,739,852.98 lekë pa TVSH, pra 1,298402.95 lekë pa TVSH më pak dhe, afati i përfundimit të punimeve ngelet i pa ndryshuar 12 muaj.

Urdhër ndryshimi Nr. 2, datë 19.08.2019, me objekt: Mbi ndryshimet në volumet e punimeve, sipas propozimeve të Bashkisë Gjirokastër dhe Kontraktorit për përmirësimin e funksionalitetit të objektit pas përfundimit të tij, mbi ndryshimet në sasi të volumeve në përfundim të punimeve, si dhe për miratimin e çmimeve të zërave të rinj të punimeve.

Mbas ndryshimeve në volumet e punimeve, vlera e kontratës ngelet 114,812,027.87 lekë pa TVSH, pra (ï 3,201.07 lekë) më pak dhe, afati i përfundimit të punimeve ngelet i pa ndryshuar 12 muaj.

Në zbatim të projektit të auditimit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë: Projekt i zbatimit, preventivit bazë dhe të ndryshuar 2(dy) herë me VO Nr. 1, datë 12.07.2019 dhe VO Nr. 2, datë 19.08.2019, Situacionet pjesore dhe Situacioni përfundimtar, Libreza e masave, Ditarit të punimeve, grafiku i punimeve, etj.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

13. Zbatimi i Kontratës së Punimeve "Rehabilitimi i infrastrukturës dhe restaurimi i kalldrëmeve, në pazarin e Gjirokastrës ".		
14.Lidhja e kontratës Ref. No. AL-ADF-15534-CW-RFB, datë 12.09.2018	**15.Vlera e kontratës:** Kontrata bazë; 137,778,274.73 lekë me tvsh OE fitues ñL. K.ò SHPK & ñH.ò SHPK	**16.Likuiduar:** - IPC1 në shumën 27,813,065.95 lekë me TVSH -IPC2 në shumën 27,935,980.97 lekë me TVSH -IPC3 në shumën 31,501,949.66 lekë me TVSH -IPC4 në shumën 17,235,508.09 lekë. -Sit përfundimtar në shumë 33,287,928.77 lekë me TVSH
17- Situacioni Përfundimtar: Situacioni perfundimtar me vlerë 137,774,433.44 lekë me TVSH.	**18.Afati i kontratës në ditë:** Fillimi punimeve: 24.09.2018 Perfundimi punimeve: 24.09.2019 sipas completion certificate.	**19. Zgjatja e kontratës:** Nuk ka
20. Mbikëqyrësi i punimeve Znj. E. Ç.	Licenca nr. MK.**1476/8**	Kontrata Nr. Ref. No. Al-ADF-37532-CS-CQS., datë 12/12/2017
21. Kolaudatori i punimeve -	Licenca Nr: -	Kontrata me nr. - prot., datë ----
22.Akt Kolaudimi Datë	**23.Akt i marrjes në dorëzi:** Datë: 07.02.2020 (certifikate e marrjes në dorëzim e përkohshme)	

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet këto problematika:

Gjetje nr. 1

Titulli i gjetjes nr. 2: Miratim i lejes së ndërtimit pa kryer Oponencën teknike për vlerë të preventivuar mbi 100 milionë lekë, nga Bashkia Gjirokastër.

Nga auditimi i dokumentacionit mbi dhënien e Lejës së Ndërtimit konstatohet se përfituesi i investimit, Bashkia Gjirokastër, nuk ka kryer oponencën teknike për projektin e zbatimit për nënobjektin ñ*Rehabilitimi i infrastrukturës dhe restaurimi i kalldrëmeve, në pazarin e Gjirokastrës*ò. Ky veprim është në kundërshtim me Ligjin Nr. 8402, datë 10.09.1998 ñPër Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimiò, i ndryshuar, neni 6, ku përcakton se:ñ*Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve do të bëhet për të gjitha llojet e ndërtimeve, me vlerë të preventuar së paku 100 milionë lekë, nga institutet shtetërore ose ente të*

*tjera, të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimeve*ò, me Urdhrin e Ministrit Nr. 197, datë 09.10.2014 ñPër miratimin e kushteve të përgjithshme të marrëveshjes për kryerjen e oponencës teknike për projektet e veprave të ndërtimitò.

Situata: Nga auditimi i dokumentacionit mbi lejen e ndërtimit, u konstatua se:
-Bashkia Gjirokastër, ka lëshuar leje ndërtimi pa kryer më parë oponencën teknike për nënprojektin ñ*Rehabilitimi i infrastrukturës dhe restaurimi i kalldrëmeve, në pazarin e Gjirokastrës*ò.

Kriteri: Moskryerja e oponencës teknike, është në kundërshtim me:
Ligjin Nr. 8402, datë 10.09.1998 ñPër Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimiò, i ndryshuar, neni 6, ku përcakton se:ñ*Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve do të bëhet për të gjitha llojet e ndërtimeve, me vlerë të preventuar së paku 100 milionë lekë, nga institutet shtetërore ose ente të tjera, të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimeve*ò, me Urdhrin e Ministrit Nr. 197, datë 09.10.2014 ñPër miratimin e kushteve të përgjithshme të marrëveshjes për kryerjen e oponencës teknike për projektet e veprave të ndërtimitò.

Impakti: Si pasojë e moskryerjes së oponencës teknike, projekti i zbatimit ka pësuar disa ndryshime.

Shkaku: Neglizhencë nga ana e Ish Kryetarit të Bashkisë Gjirokastër.

Rëndësia: *I lartë*

Për këtë rekomandojmë: Fondi Shqiptar i Zhvillimit, të merrë masa që për nënprojektet në vazhdim të ñProjektit për Integrimin Urban dhe Zhvillimin e Turizmitò tõ kërkojë Bashkive përfituese të investimeve, të kryejnë Oponencën Teknike, me qëllim përmirësimin dhe arritjen e garancisë së Projekteve të Zbatimit, për të siguruar cilësinë, qëndrueshmërinë, anën funksionale dhe jetëgjatësinë e tyre, në përputhje me Kushtet Teknike të Projektimit dhe Kushtet Teknike të Zbatimit.

4. Zbatimi i punimeve të ndërtimit për kontratën "Rikonstruksioni dhe zgjerimi i rrugës "Muzak Topia" segmenti nga rrethrotullimi te ish rezervat e shtetit deri tek lapidari në kala" në Bashkinë Berat.

Mbi zbatimin e kontratave (Sipërmarrje dhe mbikëqyrjes dhe grafikut të punimeve).
Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës për punë publike me kod identifikimi: Nr. AL-ADF-15545-CW-RFB, datë 14.11.2018 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor, Fondit Shqiptar i Zhvillimit (FSHZH), të përfaqësuar nga Titullari Z. B. B. dhe Operatorit Ekonomik (OE) ñE. H.ò SHPK, me drejtues ligjor Z. I. R.. Vlera e kontratës është 299,960,703 lekë me TVSH.
Për zbatimin e nënprojektit ñRikonstruksioni dhe zgjerimi i rrugës ñMuzak Topiaò segmenti nga rrethrotullimi te ish rezervat e shtetit deri tek lapidari në kalaò është kryer Amendim Nr.1 i kontratës për punë publike me kod identifikimi: Nr. AL-ADF-15545-CW-RFB, datë 24.12.2019 dhe nr. 1909 prot, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor, Fondit Shqiptar i Zhvillimit (FSHZH), të përfaqësuar nga Titullari Z. D. A. dhe Operatorit Ekonomik (OE) ñE. H.ò SHPK, me administrator Z. I. R..
Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata me kod identifikimi: Nr. AL-ADF-37871-CS-CQS, datë 22.12.2017 ndërmjet Autoritetit Kontraktor, Fondit Shqiptar të Zhvillimit, përfaqësuar nga Z. B. B. dhe shoqërisë ñT.ò SHPK përfaqësuar nga Znj. D. Q.
Zbatimi i punimeve.

Punimet e ndërtimit për objektin *"Rikonstruksioni dhe zgjerimi i rrugës "Muzak Topia" segmenti nga rrethrotullimi te ish rezervat e shtetit deri tek lapidari në kala",* kanë filluar me datë 30.12.2019 dhe deri në momentin e auditimit në terren, me datë 15.06.2020, janë realizuar në vlerën 22,794,810 lekë me TVSH ose në masën 7.59 %, dhe disbursimi është bërë vetëm për situacionin pjesor nr. 1 në vlerën 12,354,898 lekë me TVSH, ku është mbajtur 10% garanci punimesh.
Në zbatim të projektit të auditimit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë: Dokumentacioni teknik i zbatimit: Projekt i zbatimit, preventivit bazë, Situacionet pjesore nr. 1, Libreza e masave për situacionin e parë, Ditari i punimeve, grafiku i punimeve, si dhe dokumente që lidhen me pasqyrimin e punime të realizuara por të padisbursuara, etj.
Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

13. Zbatimi i Kontratës së Punimeve "Rikonstruksioni dhe zgjerimi i rrugës "Muzak Topia" segmenti nga rrethrotullimi te ish rezervat e shtetit deri tek lapidari në kala ".		
14.Lidhja e kontratës Ref. No. AL-ADF-15545-CW-RFB, datë 14.11.2018	**15.Vlera e kontratës:** Kontrata bazë; **299,960,703** lekë me tvsh OE fitues ñE.ò SHPK	**16.Likuiduar:** - IPC1, prill 2020, në shumën 11,119,408.25 lekë me TVSH
17- Situacioni Përfundimtar: Punimet janë proces e sipër.	**18.Afati i kontratës në ditë:** Fillimi punimeve: 30.12.2019 Përfundimi i punimeve: _____	**19. Zgjatja e kontratës:** 12 muaj
20. Mbikëqyrësi i punimeve Znj. D. Q	Licenca nr. MK.----	Kontrata nr. Al-ADF-37871-CS-CQS prot, datë 22/12/2017

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar u konstatuan këto problematika:

<u>Gjetje nr.1.</u>

<u>Titulli i gjetjes</u>: Mos hartim i dokumentacionit mbi urdhër ndryshimin për disa zëra punimesh, për objektin "Rikonstruksioni dhe zgjerimi i rrugës "Muzak Topia" segmenti nga rrethrotullimi te ish rezervat e shtetit deri tek lapidari në kala" nga OE fitues "E. H." SHPK.

Nga auditimi i dokumentacionit teknik për zbatimin e punimeve në objekt të kontratën bazë, me objekt ñRikonstruksioni dhe zgjerimi i rrugës ñMuzak Topiaò segmenti nga rrethrotullimi te ish rezervat e shtetit deri tek lapidari në kalaò u konstatua se:
- Në dosje nuk ndodhet dokumentacioni mbi urdhër ndryshimin (VO) për disa zëra punimesh dhe, konkretisht: F.V. Bordura betoni (20 x 35) cm; Struktura monolite betoni (mure betoni shtesë kufizuar me varrezat) dhe Linja e K.U.Z.
- Në projektin e zbatimit aktual të miratuar nga AK, nga FSHZH nuk janë merrë në konsideratë propozimet e bëra nga Instituti i Ndërtimit, për Oponencën Teknike, kjo tepër e domosdoshme sepse: në disa pjesë, rruga është me qëndrueshmëri të dobët.
- Referuar Projektit Teknik për të dy segmentet e rrugës, planimetria nuk është e plotësuar me parametrat gjeometrik rrugorë (gjerësi rruge, gjerësi trotuari dhe gjerësi bankine).
Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve me Nr. Ref. No. AL- ADF-62551-CW-RFB, datë 12.09.2018, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor FSHZH dhe Operatorit Ekonomikë (OE) ñE. H.ò SHPK.

Gjetje nr. 1

Titulli i gjetjes: Shtyrje e afatit të përfundimit të punimeve të ndërtimit, nga dhënja e pjesshme e *lejes së infrastrukturës*, për objektin "Rikonstruksioni dhe zgjerimi i rrugës "Muzak Topia" segmenti nga rrethrotullimi te ish rezervat e shtetit deri tek lapidari në kala" nga mos shpronsimi i pronarëve.

Nga auditimi i dokumentacionit teknik për kontratën bazë, me objekt ñRikonstruksioni dhe zgjerimi i rrugës ñMuzak Topiaò segmenti nga rrethrotullimi te ish rezervat e shtetit deri tek lapidari në kalaò konstatohet se *Leja e Infrastrukturës* me nr. 6268, datë 20.12.2019, lëshuar nga Bashkia Berat për nënobjektin ñRikonstruksioni dhe zgjerimi i rrugës ñMuzak Topiaò segmenti nga rrethrotullimi te ish rezervat e shtetit deri tek lapidari në kalaò Berat, në kuadër të projektit për Integrimin Urban dhe Zhvillimin e Turizmit, hua nga IBRD: Nr. 8656-Alb) është lëshuar në mënyrë të pjesshme për segmentin: ñSegmenti nga rrethrrotullimi te ish rezervat e shtetit deri tek Kisha e Shën Iliasò për shkak të problematikave mbi shpronësimet e pronarëve të ligjshëm të cilët preken nga zbatimi i kontratës. Mos lëshimi i lejes së infrastrukturës, për të gjithë objektin ka diktuar shtyrjen e afatit të punimeve me 12 muaj, ngadalësimin e punimeve dhe aktualisht po bëhet pengesë për ecurinë e punimeve të ndërtimit për pjesën në vazhdim, deri tek Lapidari në Kala. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve me Nr. Ref. No. AL- ADF-62551-CW-RFB, datë 12.09.2018, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor FSHZH dhe Operatorit Ekonomikë (OE) ñE....ò SHPK.

Situata: Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, i situacionit nr.1, projektit dhe preventivit bazë, u konstatua se, ecuria e punimeve të ndërtimit është e ngadaltë referuar grafikut të punimeve, për shkak të mos dhënies së lejes së infrastrukturës për të gjithë objektin.

Kriteri: Kryerje e punimeve të zërave të punimeve jo në përputhje me grafikun e punimeve, për shkak të mosshpronësimeve, është jo në përputhshmëri me, kontratës për punë publike Nr. Ref. No. AL- ADF-62551-CW-RFB, datë 12.09.2018.

Impakti: Si pasojë e mos dhënies së plotë të lejes së infrastrukturës, është shkaktuar zgjatje e përfundimit të punimeve dhe rritje të çmimit të kontratës dhe mos realizim i objektivave të ñProjektit për Integrimin Urban dhe Zhvillimin e Turizmit, hua nga IBRD: Nr. 8656-Albò.

Shkaku: Neglizhencë dhe mos rakordim ndërmjet Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe Bashkisë Berat, si përfituese e këtij investimi.

Rëndësia: *I lartë*

Për këtë rekomandojmë: FSHZH në cilësinë e Autoriteti Kontraktor, në bashkëpunim me Bashkinë Berat si përfituese direkte e këtij investimi, të intensifikojnë veprimet për të mundësuar shpronsimin e pronarëve të ligjshëm të cilët u cënohet prona private për shkak të zbatimit të punimeve të kontratës ñRikonstruksioni dhe zgjerimi i rrugës ñMuzak Topiaò segmenti nga rrethrotullimi te ish rezervat e shtetit deri tek lapidari në kalaò dhe të kryejnë dhënien e lejes së infrastrukturës për të gjithë objektin, për të mundësuar përfundimin e punimeve të kontratës në përputhje me kushtet e lejes së infrastrukturës dhe grafikut të punimeve.

Për *veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:*(*Znj. D. Q., në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve; Z. A. A., në cilësinë e Drejtorit të Implementimit të Projektit).*

-Procedura e prokurimit, "Ndricimi I rrugës Hyrëse Përmet"

Në datë 18.06.2018 është inicuar kërkesa për prokurim për punë publike ñNdriçmi I rrugëve hyrëse Përmetò nga nga Z. E. Q., Menaxher I Projektit të Zhvillimit të Integruar Urban dhe Turizmit drejtuar Njësisë Juridike dhe Prokurimit.

Në date 18.08.2018 me urdhërin nr. 9 drejtori ekzekutiv I institucionit ka nxjerrë urdhërin prokurimin me fond limit 6,905,000 lekë me tvsh për procedure me object ñNdriçmi I rrugëve hyrëse Përmetò.

Më date 19.06.2018 për procedure me nr. AL-ADF-63100-CË-RFQ është hartuar ftesa për ofertë sëbashku me specifikimet teknike ku me date 26.06.2018 është afati I fundit për paraqitjen e ofertave.

Më date 18.06.2018 është hartuar procesverbali për kompanitë e ftuara të marrin pjesë në proceduren e prokurimit si më poshtë:

1. ñV...ò shpk
2. ñE...ò shpk
3. ñH....ò shpk

Më date 26.06.2018 është hartuar procesverbali me çmimet e ofruara nga operatorët që shpreheën interes si mëposhtë:

Kompania	Çmimi me Tvsh
ñV..ò shpk	4,678,186 Lekë
ñE...ò shpk	4,677,707 lekë
ñH...ò shpk	4,645,570 lekë

Më date 4.07.2018 është hartuar raporti i vlerësimit ku janë renditur sipas ofertave më të ulët dhe vlerësuar si fitues |H...shpk & B... shpk me ofertë 4,645,570 lekë.

Më date 16.07.2018 është lidhur kontrata mes palëve.

-Mbi auditimin e zbatimit të punimeve për objektin ñ***Ndriçimi i rrugës hyrëse Permet*****",** rezultoi:

- Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës për punë publike me kod identifikimi: Nr. AL-ADF-63100-CË-RFQ, datë 16.07.2018 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor, Fondit Shqiptar i Zhvillimit (FSHZH), të përfaqësuar nga Titullari Z. B.B dhe bashkimit të Operatorëve Ekonomik (OE) JV ñH...B...ò SHPK, përfaqësuar nga A.H. Vlera e kontratës është 4,645,570 lekë me TVSH.
- Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata me kod identifikimi: Nr. AL-ADF-37871-CS-CQS, datë 22.12.2017 ndërmjet Autoritetit Kontraktor, Fondit Shqiptar të Zhvillimit, përfaqësuar nga Z. B.B dhe shoqërisë ñT....ò SHPK përfaqësuar nga Zj. D.Q.

Nga auditimi dhe shqyrtimi i dokumentacionit teknik të zbatimit dhe mbikëqyrjes së punimeve të ndërtimit, të administruara në dosjen teknike, rezulton se është dhënë një urdhër ndryshim si vijon:

Më datë 15.08.2018 është bërë kërkesa nga kontraktori për shtyrje afati punimesh me 1 muaj për shkak të vonesave në furnizim me llampat led nga importi.

- Urdhër ndryshimi Nr. 1, datë 15.08.2018, me objekt: Mbi zgjatjen e afatit të përfundimit të punimeve nga 30 ditë në 60, pasi porosia per llampat led ka patur vonesa si rezultat edhe i pushimeve verore të kompanisë prodhuese, data e perfundimit të punimeve 17.09.2018

Nga auditimi në terren dhe verifikimi Punimet janë kryer konform specifikimeve të kerkuara.

Shqyrtimi dhe vlerësimi i observacionit nr. 690/17, datë 06.07.2020 të mbikëqyrësit të punimeve OE ñT....ò SHPK përfaqësuar nga Znj. D.Q dhe të Z, A.A në cilësinë e Drejtorit të PIUT; Z. E. Zj, në cilësinë e menaxherit të Kontratës, mbi Akt-Verifikimin Nr. 1, datë 30.06.2020, të mbajtur nga grupi i auditimit të KLSH-së, në zbatim në nenit 32, të Rregullores së Procedurave të Auditimit në Kontrollin e Lartë të Shtetit (miratuar me vendim të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit Nr. 107, datë 08.08.2017 ñ*Për miratimin e rregullores së procedurave të auditimit në kontrollin e lartë të shtetit*ò është trajtuar si vijon:

a-Argumente dhe komente nga subjekti i audituar u trajtua si vijon:

Në konstatimin e bërë në faqen 4, pika 3, shpjegojmë se procedra e plotë për (VO) ka shkuar te AK FSHZH me datë 03.07.2020 me shkresën nr. 319 prot, datë 03.07.2020. kjo vërtetohet edhe me e-mail datë 17.06.2020 dërguar nga përfaqësues të investitorit për të marrë parasysh gjatë përgatitjes së VO nr. 1 kërkesat e Bashkisë Berat nr. 2465/1, datë 02.06.2020....

b-Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSh-së:

Materialet e dërguara nga mbikëqyrësi i punimeve, pasqyrojnë punën e bërë nga sipërmarrësi dhe supervizori në zbatim të kushteve të kontratës dhe udhëzimit nr. 2, datë 13.05.2005, nga njëra anë dhe neglizhencen dhe mosmarrjen në konsideratë të AK për përpiluar VO. Nr.1.

KLSH, rekomandon që AK të vazhdojë punën për hartimin e urdhër ndryshimit nr.1 dhe gjithashtu të bashkëpunojë me Bashkinë Berat për të mundësuar shpronsimin e pronarëve të ligjshëm të cilët u cënohet prona private për shkak të zbatimit të punimeve të kontratës ñRikonstruksioni dhe zgjerimi i rrugës ñMuzak Topiaò segmenti nga rrethrotullimi te ish rezervat e shtetit deri tek lapidari në kalaò dhe të kryejnë dhënien e lejes së infrastrukturës për të gjithë objektin, për të mundësuar përfundimin e punimeve të kontratës në përputhje me kushtet e lejes së infrastrukturës dhe grafikut të punimeve.

Observacioni nuk merret në konsideratë, sepse vazhdimi i punimeve për zëra jashtë preventivit, dhe pa u miratuar me VO, është në kundërshtim me kushtet e kontratës së sipërmarrjes.

<u>Pika F: "Mbi administrimin e veprave ndërtimore të përfunduara, të Programit të Auditimit në Fondin Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH).</u>

Në zbatim të pikës F: F.1 dhe F.2, mbi administrimin e veprave ndërtimore të përfunduara, të Programit të Auditimit në Fondin Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH), nga audituesit e KLSH-së u krye auditimi mbi administrimin e veprave të dorëzuara për projektin ñZhvillim i Integruar Urban e Turistik në Shqipëriò rezultoi si vijon:

Projektit ñZhvillimi i Integruar Urban e Turistik në Shqipëriò financohet përmes Marrëveshjes së Huasë (të datës 13.12.2016) nënshkruar mes IBRD (World Bank Group) dhe Qeverisë Shqipërisë.

Marrëveshja e huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisëdhe Bankës Ndëkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për financimin e projektit për zhvillimin e integruar urban dhe të turizmit, është Ratifikuar, me Ligjin Nr. 19/2017.

Banka bie dakord që tâi japë Huamarrësit, me kushtet dhe afatet që parashikohen apo përmenden në këtë marrëveshje, shumën prej 63,800,000 Euro, për të dhënë asistencë në financimin e projektit, ku tarifa ñFillim-mbarimò që paguan Huamarrësi është e barabartë me një të katërtën e një përqind (0.25%) të shumës së huas.

Për kryerjen e kësaj procedure, FSHZH ka nënshkruar marrëveshjet e investimit, funksionimit dhe mirëmbajtjes me Njësitë Qendrore Vendore përfituese Sarandë, Berat, Gjirokastër dhe Përmet, me qëllim për të siguruar angazhimin e tyre në gjithë procesin dhe për të garantuar qëndrueshmërinë e investimit.

Procedurat e marrjes në dorëzim të një nënprojekti të përfunduar, fillon pasi nga ana e supervizorit të punimeve lëshohet një certifikatë e përkohshme e marrjes në dorëzim të punimeve dhe që nga ky moment vepra konsiderohet nën periudhën e garancisë 1 (një vjecare). Pas përfundimit të periudhës së garancisë, bëhet dorëzimi final i investimit, në bazë të certifikatës së marrjes përfundimtare në dorëzim të punimeve nga të gjitha palët.

Nga auditimi i kryer rezultoi se, nga 6 (gjashtë) kontrata të zbatimit të projektit për punime civile për periudhën në auditim, kanë përfunduar zbatimin e punimeve 4 (katër) kontrata për punë publike, në masën 100% (Tabela nr.a), nga ku:

- Kontrata me nr. Reference AL-ADF-28554-CW-RFB me vlerë të realizuar në fakt në shumën 148,120,404 lekë me TVSH, ka përfunduar periudhën e garancisë së punimeve.
- Kontrata me nr. Reference AL-ADF-63100-CW-RFQ me vlerë të realizuar në fakt në shumën 4,601,667 lekë me TVSH, ka përfunduar periudhën e garancisë së punimeve.
- Kontrata me nr. Reference AL-ADF-15534-CW-RFB me vlerë të realizuar në fakt në shumën 90,846,945 lekë me TVSH, ka përfunduar punimet e ndërtimit në masën 100 %, por investimi është në periudhën e garancisë së punimeve.
- Kontrata me nr. Reference AL-ADF-62551-CW-RFB me vlerë të realizuar në fakt në shumën 137,774,433 lekë me TVSH, ka përfunduar punimet e ndërtimit në masën 100 %, por investimi është në periudhën e garancisë së punimeve.
- Kontrata me nr. Reference AL-ADF-15545-CW-RFB me vlerë të kontratës 299,960,703 lekë me TVSH, punimet e ndëtimit deri në momentin e auditimit nga KLSH, janë realizuar në masën 18 %. Punimet e ndërtimit janë proçes e sipër pune.
- Kontrata me nr. Reference AL-ADF-15536-CW-RFB me vlerë të kontratës 570,335,643 lekë me TVSH, punimet e ndëtimit deri në momentin e auditimit nga grupi i auditimit të KLSH-së, janë realizuar në masën 7 %. Punimet e ndërtimit janë proçes e sipër pune.

Tabela nr. a

Bashkia	Nënprojekti	Vlera e realizuar në Lek (me TVSH)	Data e përfundimit të punimeve	Data e dorëzimit të përkohshëm	Data e dorëzimit përfundimt-ar të punimeve
Sarandë	Ndërtimi i shkallareve Sarandë	90,846,945	29.12.2018	22.02.2019	-
Berat	Rehabilitimi i rrugës së kalldremtë në kalanë e Beratit	148,120,404	03.10.2018	08.11.2018	-
Gjirokastër	Rehabilitimi i rrugës së kalldremtë në qafën e pazarit	137,774,433	24.09.2019	07.02.2020	-
Përmet	Ndriçimi i rrugës hyrëse të Përmetit	4,601,667	03.11.2015	17.10.2018	21.10.2019
Berat	Rikonstruksioni dhe zgjerimi i rrugës ñMuzak Topiaò segmenti nga rrethrotullimi te	299,960,703	Në proces pune	-	-

	ish rezervat e shtetit deri tek lapidari në kala				

Lista e nënprojekteve të dorëzuara deri më 19.06.2020

- Nga auditimi mbi administrimin e nënprojektit ñNdërtimi i shkallareve në Sarandëò, me vlerë të realizuar në fakt 90,846,945 lekë me TVSH me operator ekonomik fitues ñA....ò SHPK, rezultoi se: punimet e ndërtimit kanë përfunduar më datë 29.09.2018 dhe bazuar në Marrëveshjen e Investimit të lidhur më datë 16.08.2017, ndërmjet FSHZH, përfaqësuar nga Drejtori Ekzekutiv Z. B.B dhe Bashkisë Sarandë, përfaqësuar nga Znj. F.K, për financimin e objektit ñRehabilitimi i Shkallareve të Sarandësò, është lëshuar Çertifikata e Marrjes në Dorëzim të Punimeve (e përkohshme) më 29.12.2018. Me përfundimin e periudhës së garancisë prej 365 ditë nga data e përfundimit të punimeve dhe aktualisht deri në momentin e auditimit nga KLSh, nuk lëshuar Çertifikatë Përfundimtare e Marrjes në Dorëzim të Punimeve nga Bashkia Sarandë.
- Nga auditimi mbi administrimin e nënprojektit ñ*Rehabilitimi i rrugës hyrëse Mihal Komneno për në Kala dhe Tabja*ò, me vlerë të realizuar në fakt 148,120,404 lekë me TVSH me operator ekonomik fitues ñS...ò SHPK, rezultoi se: punimet e ndërtimit kanë përfunduar më datë 03.10.2018 dhe bazuar në Marrëveshjen e Investimit të lidhur më datë 10.07.2017, ndërmjet FSHZH, përfaqësuar nga Drejtori Ekzekutiv Z. B.B dhe Bashkisë Berat, përfaqësuar nga Z. P.S, për financimin e objektit ñRehabilitimi i rrugës hyrëse Mihal Komneno për në Kala dhe Tabjaò, është lëshuar Çertifikata e Marrjes në Dorëzim të Punimeve (e përkohshme) më 08.11.2018. Me përfundimin e periudhës së garancisë prej 365 ditë nga data e përfundimit të punimeve dhe aktualisht deri në momentin e auditimit nga KLSH, nuk lëshuar Çertifikatë Përfundimtare e Marrjes në Dorëzim të Punimeve nga Bashkia Berat.
- Nga auditimi mbi administrimin e nënprojektit ñ*Rehabilitimi i infrastrukturës dhe restaurimi i kalldrëmeve, në pazarin e Gjirokastrës*ò, me vlerë të realizuar në fakt 137,778,274.73 lekë me TVSH me fitues Bashkimin e Operatorëve Ekonomik (BOE) ñL.Kò SHPK & ñHò SHPK, me përfaqësues ñL.Kò SHPK, rezultoi se: punimet e ndërtimit kanë përfunduar më datë 24.09.2019 dhe bazuar në Marrëveshjen e Investimit të lidhur më datë 30.03.2018, ndërmjet FSHZH dhe Bashkisë Gjirokastër, përfaqësuar nga Znj. Z.R, për financimin e objektit ñ*Rehabilitimi i infrastrukturës dhe restaurimi i kalldrëmeve, në pazarin e Gjirokastrës*ò, është lëshuar Çertifikata e Marrjes në Dorëzim të Punimeve (e përkohshme) më 24.09.2019. Objekti është në periudhë garancie për defektet e punimeve.
- Nga auditimi rezultoi se, për nënprojektin ñNdriçimi i rrugës hyrëse të Përmetitò, me vlerë të realizuar nëfakt 4,601,667 lekë me TVSH me operator ekonomik fitues JV ñHò SHPK & ñBò SHPK, punimet e ndërtimit kanë përfunduar më datë 29.09.2018 dhe bazuar në Marrëveshjen e Investimit të lidhur më datë 25.06.2018 me NjQV Përmet, është lëshuar Çertifikata e Marrjes në Dorëzim të Punimeve (e përkohshme) më 17.10.2018. Me përfundimin e periudhës së garancisë prej 365 ditë nga data e përfundimit të punimeve, është lëshuar dhe Çertifikata Përfundimtare e Marrjes në Dorëzim të Punimeve nga Bashkia Përmet, më datë 21.10.2019.

Titulli i gjetjes: Mos dorëzim në mënyrë përfundimtare të nënprojekteve të përfunduara si dhe mos funksionim i marrëveshjeve të mirëmbajtjes së investimeve ndërmjet FSHZH dhe Bashkive për objektet përkatëse.

Nga auditimi i dokumentacionit teknik mbi administrimin e veprave të përfunduara u konstatua se:
- Për nënobjektin: ñNdërtimi i shkallareve në Sarandëò nga FSHZH dhe Bashkia Sarandë, nuk ka filluar procedura e marrjes në dorëzim përfundimtar të investimit edhe pse ka përfunduar periudha e garancisë, edhe pse FSHZH me shkresën me nr. 141 prot, datë 20.01.2020 ka njoftuar Titullarin e Bashkisë Sarandë për marrjen përfundimtare në dorëzim të nënobjektit.
- Për nënobjektet: ñNdërtimi i shkallareve në Sarandëò; ñRehabilitimi i rrugës hyrëse Mihal Komneno për në Kala dhe Tabjaò; ñRehabilitimi i infrastrukturës dhe restaurimi i kalldrëmeve, në pazarin e Gjirokastrësò; ñNdriçimi i rrugës hyrëse të Përmetitò nga Bashkitë përkatëse si përfituese të këtyre investimeve, aktualisht, nuk ka filluar procedura e mirëmbajtjes së investimeve, sipas një plani të detajuar mirëmbajtje që buron nga ***Manualet e Operimit dhe Mirëmbajtjes*** *(të cilat aktualisht, pas rekomandimit të KLSh, janë realizuar zyrtarisht në protokollin e FSHZH, për dy nënobjekte)*. Aktualisht konstatohet se nuk kanë gjetur zbatim, objektivat dhe nuk është arritur qëllimi i parashikuar në Marrëveshjet e Funksionimit dhe të Mirëmbajtjes midis FSHZH dhe Bashkive Berat, Sarandë, Gjirokastër.
Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratat e sipërmarrjes së punimeve, me Marrëveshjet e Investimit si dhe Marrëveshjet e Mirëmbajtjes, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor FSHZH dhe Bashkive Berat, Sarandë, Gjirokastër.

Situata: Nga auditimi i dokumentacionit mbi administrimin e nënobjekteve, rezulton se ky objekt nuk është dorëzuar në mënyrë përfundimtare dhe aktualisht nuk ka fillimi i mirëmbajtjes së investimeve.
Kriteri: me Marrëveshjet e Investimit si dhe Marrëveshjet e Mirëmbajtjes, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor FSHZH dhe Bashkive Berat, Sarandë, Gjirokastër.
Impakti: Si pasojë e mos fillimit të mirëmbajtjes së këtyre investimeve, ka filluar të vërehen disa dëmtime dhe problematika në veprat e realizuara.
Shkaku: Mos rakordim dhe bashkëpunim ndërmjet Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe Bashkive Berat, Sarandë, Gjirokastër. Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: Z. D.A, në cilësinë e Drejtorit Ekzekutiv të FSHZH.
Rëndësia: *I lartë*
Për këtë rekomandojmë: FSHZH në cilësinë e Autoriteti Kontraktor, në vazhdimësi të bashkëpunojë me Bashkitë Sarandë, Berat, Gjirokastër, për të intensifikuar veprimet për të mundësuar marrjen në dorëzim përfundimtar të investimeve respektive si dhe të zbatojnë kërkesat e Marrëveshjes së Investimit dhe të Mirëmbajtjes për fillimin e menjëhershëm të procesit të Operimit dhe të Mirëmbajtjes në zbatim të një Plani dhe grafiku të detajuar, për të mundësuar rritjen e anës funksionale në përputhje me objektivat dhe kushtet e marrëveshje të nënshkruara.

Për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit t^y v^y n^y n^y dispozicion rezulton se nga ana e Njësisë së Zbatimit të Projektit nuk jan^y kryer raportimet periodike n^y Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe mbledhje e Komitetit Drejtues të Projektit, veprime këto n^y kundërshtim me përcaktimet e marrëveshjes Ligjin nr.19/2017 ñPër Ratifikimin e Marrëveshjes së Huasë Ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për Financimin e Projektit për Zhvillimin e Integruar Urban dhe të Turizmitò. (*Trajtuar më hollësisht në faqet 9-17të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1. Rekomandimi: Njësia e Menaxhimit të Projektit të marrë masa për përmbushjen e detyrimeve dhe respektimin e përcaktimeve të parashikuara në marrëveshje për sa i përket raportimeve kjo në frymën e mirë menaxhimit dhe mbarëvajtjes së projektit.

Në Vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se enti zbatues i projektit (FSHZH) nuk ka respektuar frekuencën e auditimeve të parashikuara në ñLigjin nr.19/2017 ñPër Ratifikimin e Marrëveshjes së Huasë Ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për Financimin e Projektit për Zhvillimin e Integruar Urban dhe të Turizmitò. (*Trajtuar më hollësisht në faqet 9-17të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1. Rekomandimi: Entit Zbatues i Projektit (FSHZH), të marrë masa që të përgatisë, dhe t'i dorëzojë Bankës jo më vonë se 45 ditë pas mbarimit të çdo tremujori kalendarik, raporte të ndërmjetme financiare të paaudituara për Projektin që përmbledhin tremujorin, në formë dhe me përmbajtje të pranueshme për Bankënò, për ecurinë e këtij projekti i cili ka rëndësi të veçantë për turizmin në zonat ku aplikohet.

Në Vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i realizimit të objektivave dhe komponentëve të projektit u konstatua se: realizmi i projektit sipas zërave të marrëveshjes paraqitet në nivelet e 26% praktikisht shumë të ulëta krahasuar me afatin e përfundimit të projektit i cili ka kaluar ¾ e tij. Edhe pse në këto kushte nisur nga zgjatjet dhe kalimi i më shumë se ¾ e kohës së projektit ecuria e tij është në nivelet e 26% tregues i mos përfundimit në afat, kjo e mbështetur dhe në realizmin e kostove operative që paraqiten në nivelet e 75%. E gjithë kjo situatë krijon mund^y sin^y për rritjen e kostove operative të tij nisur nga ecuria e dobët në kategoritë e tjera të financuara. (*Trajtuar më hollësisht në faqet 17-20 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1. Rekomandimi: Njësia e menaxhimit të projekti, Fondi Shqiptar i Zhvillimit të marrin masat për përfundimin sa më shpejt të fazës së projektimit me qëllim respektimin e afateve dhe

realizimin e procedurave për punë civile në cilësi dhe afat, si dhe monitorimin dhe ndjekjen në vijimësi të çdo kontrate në proces për shmangien e pengesave dhe tejkalimit të afateve.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Enti i zbatimit të projektit nuk ka krijuar të plotë njësinë e menaxhimit të projektit, prame 11 punonjës, kjo sipas specifikave të miratuara në ñLigjin nr.19/2017 ñPër Ratifikimin e Marrëveshjes së Huasë Ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për Financimin e Projektit për Zhvillimin e Integruar Urban dhe të Turizmitò shojca 2 pika 2, si dhe organigramat e funksionimit të projektit të konfirmuara nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe Banka Botërore, si më poshtë: menaxher projekti, një arkitekt, një inxhinier, një specialist për administrimin financiar , një specialist prokurimi, një specialist për angazhimin qytetar, një specialist mjedisi dhe një specialist për problemet sociale. (*Trajtuar më hollësisht në faqet 9-17të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1. Rekomandimi: Entit Zbatues i Projektit (FSHZH), të marrë masa në krijimin e strukturës së plotë të njësisë së projektit, me qëllim implementimin në kohë dhe cilësi të këtij projektit si dhe për realizimin e objektivave dhe shmangien e shtyrjes së afatit për arritjen e efiçencës së parashikuar.

Menjëherë

5.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i planit të prokurimeve u konstatua se në të nuk janë reflektuar ndryshimet dhe nuk është njoftuar banka për informim ecurinë e projekti siç parashikohet në ñLigjin nr.19/2017 ñPër Ratifikimin e Marrëveshjes së Huasë Ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për Financimin e Projektit për Zhvillimin e Integruar Urban dhe të Turizmitò shtojca II seksioni III pika 2, Udhëzuesi i Bankës Botërore pika 1.25. (*Trajtuar më hollësisht në faqet 29-39të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1. Rekomandimi: Njësia menaxhuese e projektit,në të ardhmen të pasqyrojë ecurinë e secilit projekt në zbatim e sipër si dhe të reflektojë ndryshimet e mundshme të projekteve të tjera për pasqyrimin sa më korrekt të situatës dhe fazës në të cilën ndodhet ky projekt.

Në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i IPC u konstatua se në 6 raste të shpërndara në dy kontrata hartimi i situacionit pjesor nga Kontraktori, miratuar nga mbikëqyrësi dhe menaxheri i kontratës si dhe mbajtja e garancisë së punimeve prej 10% të situacionit pa TVSH nga departamenti i financës është kryer në shkelje të kushteve të përgjithshme të kontratës pika 50.1 ***"Garancia bankare 10% e çmimit të kontratës"*** i cili është me TVSH, situatë e sistemuar në IPC e fundit. (*Trajtuar më hollësisht në faqet 20-29 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

6.1. Rekomandimi: Entit Zbatues i Projektit (FSHZH), Menaxherët e kontratave dhe Departamenti Ekonomik në çdo rast të verifikoj detyrimin për pagesë duke respektuar kushtet e kontratës dhe mirmenaxhuar fondet në dispozicion.

Në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pagesave dhe disbursimeve në zbatim të marrëveshjes u konstatua se për të gjithë vlerën e padisbursuar për huamarrësin për çdo vit aplikohet tarifa e angazhimit e barabartë me një të katërtën e një përqind (0.25%) në vit të shumës së pa tërhequr. Nga aplikimi i tarifës së angazhimit dhe disbursimet në nivelet kaq të ulëta huamarrësi detyrohet të paguaj një shumë të përafërt me 519,689 euro nëse kjo tarifë do aplikohej nga huadhënësi. Disbursimi në nivele të ulëta e ekspozon huamarrësin p^{y}r pagesat të tarifave të angazhimit tejet të larta krahasuar me ato që mund të aplikohen nëse kemi një ecuri normale në disbursimeve, veprim ky në kundërshtim meñLigjin nr.19/2017 ñPër Ratifikimin e Marrëveshjes së Huasë Ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për Financimin e Projektit për Zhvillimin e Integruar Urban dhe të Turizmitò neni II pika 2.04. (*Trajtuar më hollësisht në faqet 20-29 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

7.1. Rekomandimi: Zbatues i Projektit (FSHZH), të marrë masa të menjëhershme për ecurinë në fazat e projektimit dhe zbatimit të projektit në përfundimin e procedurave të prokurimit dhe realizimin e punimeve të ndërtimit me qëllim respektimin e afateve dhe kosatove të miratuara.

Menjëher

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratës së konsulentit ñProjektim dhe supervizim i kontratës së konsulencës Rehabilitimi i qytetit të Gjirokastrësò u konstatua se kjo kontratë ka dështuar por njoftimi për prishje kontrate është kryer pas 8 muajsh dhe prishja e kontratës pas 10 muajsh, duke sjellë vonesa në realizimin e procedurës projektim dhe supervizim. Mos realizimi i kësaj kontrate ka sjell^{y} dhe shtyrjen e afateve n^{y} zbatimin e projekteve që do miratohen. Veprime këto në kundërshtim me Termat e Referencës (TOR) pika 62 Plani I punës ku për detyrën 1 konsulenti ka 1 muaj afat për përgatitje e saj së bashku me komentet dhe miratimin, pika 14 përfundimi i kontratës nënpika **14.1** ku i referohet kushteve të përgjithshme **pika 19.1.1** kontrata mund të ndërpritet nëse ***konsulenti dështon në kryerjen e detyrave të tij***. Sipas **pikës 18 të GCC** kushteve të përgjithshme kontraktori duhet të njoftoj me shkrim konsulentin dhe ti japë 1 muaj kohë për riparimin e problemeve të krijuara. (*Trajtuar më hollësisht në faqet 29-39 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

7.1. Rekomandimi*: Drejtorii projektit në të ardhmen të informoj për situata të ngjashme huadhënësin për dhënien e një zgjidhje sa më të shpejt në kohë me qëllim eleminimin e vonesave të tjera.*

Në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit teknik për zbatimin e punimeve në objekt të kontratën bazë, me objekt ñRikonstruksioni dhe zgjerimi i rrugës ñMuzak Topiaò segmenti nga rreth rrotullimi te ish rezervat e shtetit deri tek lapidari në kalaò u konstatua se:
- Në dosje nuk ndodhet dokumentacioni mbi urdhër ndryshimin (VO) për disa zëra punimesh dhe konkretisht: F.V. Bordura betoni (20 x 35) cm; Struktura monolite betoni (mure betoni shtesë kufizuar me varrezat) dhe Linja e K.U.Z.

- Në projektin e zbatimit aktual të miratuar nga AK, nga FSHZH nuk janë marrë në konsideratë propozimet e bëra nga Instituti i Ndërtimit, për Oponencën Teknike, kjo tepër e domosdoshme sepse: në disa pjesë, rruga është me qëndrueshmëri të dobët.
- Referuar Projektit Teknik për të dy segmentet e rrugës, planimetria nuk është e plotësuar me parametrat gjeometrik rrugorë (gjerësi rruge, gjerësi trotuari dhe gjerësi bankine).

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve me Nr. Ref. No. AL- ADF-62551-CW-RFB, datë 12.09.2018, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor FSHZH dhe Operatorit Ekonomikë (OE) ñE...ò SHPK. (*Trajtuar më hollësisht në faqet 36-51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

8.1. Rekomandim: Autoriteti Kontraktor FSHZH, nisur nga fakti që punimet e ndërtimit të kontratës ñRikonstruksioni dhe zgjerimi i rrugës ñMuzak Topiaò segmenti nga rrethrotullimi te ish rezervat e shtetit deri tek lapidari në kalaò janë në proces pune, të marrë masa dhe të fillojë procedurën mbi ndryshimet në volumet e punimeve të ndërtimit sipas propozimeve të kontraktorit e mbikëqyrësit dhe të bëjë miratimin me urdhër ndryshimi (V.O.) me qëllim përmirësimin në sasi dhe cilësi të projekt-preventivit të miratuar pas ballafaqimit me terrenin si dhe për miratimin e çmimeve të zërave të rinj të punimeve (nëse do jetë e nevojshme), duke rishikuar vlerën e kontratës pas rishikimit të preventivit.

Menjëherë

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit teknik për kontratën bazë, me objekt ñRikonstruksioni dhe zgjerimi i rrugës ñMuzak Topiaò segmenti nga rreth rrotullimi te ish rezervat e shtetit deri tek lapidari në kalaò konstatohet se Leja e Infrastrukturës me nr. 6268, datë 20.12.2019, lëshuar nga Bashkia Berat për nënobjektin ñRikonstruksioni dhe zgjerimi i rrugës ñMuzak Topiaò segmenti nga rreth rrotullimi te ish rezervat e shtetit deri tek lapidari në kalaò Berat, në kuadër të projektit për Integrimin Urban dhe Zhvillimin e Turizmit, hua nga IBRD: Nr. 8656-Alb) është lëshuar në mënyrë të pjesshme për segmentin: ñSegmenti nga rrethrotullimi te ish rezervat e shtetit deri tek Kisha e Shën Iliasò për shkak të problematikave mbi shpronësimet e pronarëve të ligjshëm të cilët preken nga zbatimi i kontratës. Mos lëshimi i lejes së infrastrukturës, për të gjithë objektin ka ndikuar në shtyrjen e afatit të punimeve me 12 muaj, ngadalësimin e punimeve dhe aktualisht po bëhet pengesë për ecurinë e punimeve të ndërtimit për pjesën në vazhdim, deri tek Lapidari në Kala. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve me Nr. Ref. No. AL- ADF-62551-CW-RFB, datë 12.09.2018, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor FSHZH dhe Operatorit Ekonomikë (OE) ñE....ò SHPK. (*Trajtuar më hollësisht në faqet 36-51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

9.1. Rekomandim:FSHZH në cilësinë e Autoriteti Kontraktor, në bashkëpunim me Bashkinë Berat si përfituese direkte e këtij investimi, të intensifikojnë veprimet për të mundësuar shpronsimin e pronarëve të ligjshëm të cilët u cënohet prona private për shkak të zbatimit të punimeve të kontratës ñRikonstruksioni dhe zgjerimi i rrugës ñMuzak Topiaò segmenti nga rrethrotullimi te ish rezervat e shtetit deri tek lapidari në kalaò dhe të realizohet dhënia e lejes së infrastrukturës për të gjithë objektin, për të mundësuar përfundimin e punimeve të kontratës në përputhje me kushtet e lejes së infrastrukturës dhe grafikut të punimeve.

Menjëherë

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit teknik mbi administrimin e veprave të përfunduara u konstatua se:

- Për nënobjektin: ñNdërtimi i shkallareve në Sarandëò nga FSHZH të bashkëpunojë me Bashkinë Sarandë, për të finalizuar marrjen në dorëzim përfundimtar të investimit edhe pse ka përfunduar periudha e garancisë dhe pse AK me shkresën me nr. 141 prot, datë 20.01.2020 ka njoftuar Titullarin e Bashkisë Sarandë për marrjen përfundimtare në dorëzim të nënobjektit.
- Për nënobjektet: ñNdërtimi i shkallareve në Sarandëò; ñRehabilitimi i rrugës hyrëse Mihal Komneno për në Kala dhe Tabjaò; ñRehabilitimi i infrastrukturës dhe restaurimi i kalldrëmeve, në pazarin e Gjirokastrësò nga Bashkitë përkatëse si përfituese të këtyre investimeve, aktualisht, nuk ka filluar procedura e mirëmbajtjes së investimeve, sipas një plani të detajuar mirëmbajtjeje që buron nga Manualet e Operimit dhe Mirëmbajtjes (të cilat aktualisht nuk janë realizuar dhe nuk janë dorëzuar zyrtarisht në protokollin e FSHZH). Aktualisht konstatohet se nuk kanë gjetur zbatim, objektivat dhe nuk është arritur qëllimi i parashikuar në Marrëveshjet e Funksionimit dhe të Mirëmbajtjes midis FSHZH dhe Bashkive Berat, Sarandë dhe Gjirokastër.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratat e sipërmarrjes së punimeve, me Marrëveshjet e Investimit si dhe Marrëveshjet e Mirëmbajtjes, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor FSHZH dhe Bashkive Berat, Sarandë dhe Gjirokastër. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 36-51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

10.1. Rekomandim:FSHZH në cilësinë e Autoriteti Kontraktor, në vazhdimësi të bashkëpunojë me Bashkitë Sarandë, Berat dhe Gjirokastër, për të intensifikuar veprimet për të mundësuar marrjen në dorëzim përfundimtar të investimeve respektive si dhe të zbatojnë kërkesat e Marrëveshjes së Investimit dhe të Mirëmbajtjes për fillimin e menjëhershëm të procesit të Operimit dhe të Mirëmbajtjes në zbatim të një Plani dhe grafiku të detajuar, për të mundësuar rritjen e anës funksionale në përputhje me objektivat dhe kushtet e marrëveshjeve të nënshkruara.

Menjëherë

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit mbi dhënien e Lejes së Ndërtimit konstatohet se përfituesi i investimit, Bashkia Gjirokastër, nuk ka kryer oponencën teknike për projektin e zbatimit për nënobjektin ñ*Rehabilitimi i infrastrukturës dhe restaurimi i kalldrëmeve, në pazarin e Gjirokastrës*ò. Ky veprim është në kundërshtim me Ligjin Nr. 8402, datë 10.09.1998 ñPër Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimiò, i ndryshuar, neni 6, ku përcakton se: ñ*Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve do të bëhet për të gjitha llojet e ndërtimeve, me vlerë të preventivuar së paku 100 milionë lekë, nga institutet shtetërore ose ente të tjera, të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimeve*ò, me Urdhrin e Ministrit Nr. 197, datë 09.10.2014 ñPër miratimin e kushteve të përgjithshme të marrëveshjes për kryerjen e oponencës teknike për projektet e veprave të ndërtimitò. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 36-51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

11.1. Rekomandim: Fondi Shqiptar i Zhvillimit, të marrëmasa që për nënprojektet në vazhdim të ñProjektit për Integrimin Urban dhe Zhvillimin e Turizmitò tôi kërkojnë Bashkive përfituese të investimeve, të kryejnë Oponencën Teknike, me qëllim përmirësimin dhe arritjen e garancisë së Projekteve të Zbatimit, për të siguruar cilësinë, qëndrueshmërinë, anën funksionale dhe jetëgjatësinë e tyre, në përputhje me Kushtet Teknike të Projektimit dhe Kushtet Teknike të Zbatimit.

Menjëherë

C. MASA DISIPLINORE

Ne lidhje me mangësitë e konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, grupi i auditimit konsideron se gjetjet nuk janë materiale dhe nuk justifikojnë dhënien e rekomandimeve për fillimin e masave disiplinore për stafin e Njësisë së Zbatimit të Projektit.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja.

D. SHËNIME
Ny lidhje me pikyn **E.** të programit të auditimit ñMbi zbatimin e kontratave pyr punime civile, mallra e shërbimeò mbi të cilat nuk jemi shprehur ny kyty vendim pyr shkak të ecurisy syulyt ty kontratave të zbatimit, do të auditohen ny auditimin e radhys.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

1. S.H
2. J.ZH

Drejtori i Departamentit

R.XH

V. ANEKSE

1. Shkurtime

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
FSHZH	Fondi Shqiptar i Zhvillimit
BB	Banka Botrore
SHPK	Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar
TVSH	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar
KVO	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
NJMP (PMU)	Njësia e Prokurimit
AK	Autorieteti Kontraktor
DST	Dokumentet Standarde të Tenderit
IPC	Certifikatë e nërmjetme pagese
TOR	Termat e references
GCC	Kushtet e përgjithshme të Kontratës
SCC	Kushtet e veçanta të Kontratës